# Rruga e Arbërit






**Market KEN**

*Laprakë, Tiranë*
*Tel: +355 4 22 50 480*
*Cel. 068 20 36 394*



www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 11 (115). NËNTOR 2015. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.


AKTUALITET

## Mjekë nga SHBA, vizita falas për fëmijët në Dibër

NGA **BUJAR KAROSHI** - FAQE 12

AKTUALITET

## Mati është zvogëluar shumë

NGA **HAMDI HYSUKA** - FAQE 4

HISTORI

## Beteja e Lumës - "Kaçaniku i dytë"

NGA **BEQIR SHEHU** - FAQE 21

OPINIONE

## Dibra ka nevojë për të rinjtë

NGA **EDISON BALLA** - FAQE 10

## Rruga e Arbrit nuk është "firmë kineze"

NGA **DIONIS XHAFA** - FAQE 11

Kryeministri Edi Rama takon kryeministrin kinez Li Keqiang:

# Shpresojmë që të nisë sa më parë ndërtimi i Rrugës së Arbrit

**Zyra e Kryeministrit Edi Rama konfirmon se gjatë bisedimeve me kryeministrin e Kinës është diskutuar për finalizimin negociatave. Ora News zbulon koston e projektit: 36 miliardë lekë - rreth 260 milionë euro. Brenda dhjetorit pritet që marrëveshja të miratohet në Këshillin e Ministrave. Më pas, sipas ligjit të miratuar në prill, Kuvendi miraton marrëveshjen dhe i hapet rruga nisjes së punimeve.**

FAQE 2-3

vendlindja

## Tërnova, kjo magji malli e bjeshkëve



Rrugës duke u ngjitur nga Fushë Bulqizë, përmes një shtegu gjarpërues, shfaqet përnjëherë, përmbas shpinës së malit, një pamje që të magjeps me mistikën e vet. Në këtë tatëpjetë që shigjeton përmes shtegut që ka arritur të çajë shpatullat shkëmbore të malit, ku në të majtë ngrihet maja e Kozjakut dhe në anën e djathtë, lartësitë e Liqenit të Zi, është e pamundur mos me e pranuar një gjendje hutimi që të pushton, një tronditje e brendshme që të përkund si gjethe. Udhëtimi nëpër re i shpatit, rreket me ngjasuar me një udhëtimi si nëpër ëndrra.

NGA **HALIL TEODORI** - FAQE 13

portret

## Qamil Lata, njeriu që bazon suksesin në punë dhe humanizëm



## Skavica në shitje. Kush do ta marrë, Kina apo Turqia?

Geri Selenica, drejtor ekzekutiv në Qendrën Shqiptare për Studime Strategjike:
Për hidrocentralet e Skavicës dhe Vjosës, qeveria dëshiron që t'i japë me koncesion te disa firma të vogla turke, ndërkohë që injoron propozimet nga firma gjigante kineze".
"Skavica duhet të mbetet në pronë të KESH, që të jetë rezervuari më i madh ujor i Shqipërisë (tre herë më i madh se Fierza) dhe të bëjë gjithë optimizimin e Kaskadës së Drinit, duke rritur 20% efektivitetin energjetik të saj.
Një nga firmat kineze i ofroi qeverisë shqiptare një kredi të butë 30-vjeçare, me 2% interes në vit dhe me 7 vjet grace period (faljeje), aq sa zyrtarët më të lartë të qeverisë nuk arrinin dot t'ju besonin veshëve.
Qeveria nuk ka bërë asnjë konsultim me popullsinë e Dibrës për këtë projekt.

FAQE 2



Duhet të ketë të paktën 300 vjet, apo shtatë breza, qëkurse familja e Lateve zbriti nga fshati Letaj i Hasit të Thatë. Një pjesë në Mustafe, një pjesë në Dibër të Madhe, e një pjesë tjetër në Staravec, pak përmbi qytetin e Peshkopisë. Në shkrimin tonë, ne po flasim për këtë degëzim të fundit, për Qamil Latën, fëmijët, vëllezërit, kushërinjtë e të afërm të tij.

NGA **OSMAN XHILI** - FAQE 5


KNAUF Bashkëpunon me komunitetin

www.knauf.al



cyan magenta yelloë black 1

**Geri Selenica, drejtor ekzekutiv në Qendrën Shqiptare për Studime Strategjike:
Për hidrocentralet e Skavicës dhe Vjosës, qeveria dëshiron që t'i japë me koncesion te disa firma të vogla turke, ndërkohë që injoron propozimet nga firma gjigante kineze".**



Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 11 (115). 1 - 30 Nëntor 2015

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

**GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.**

**JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".**

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:
Sashenka NDREKA
Hysen LIKDISHA
Abdurahim ASHIKU

Kontribuan për këtë numër:
Halil TEDORI
Agron TUFA
Hysen UKA
Osman XHILI
Atli DEMA
Lutfi TURKESHI
Edison BALLA
Sefulla KATA
Dionis XHAFA
Samet ZAGRADI
Mehdi DEMA
Zabit LLESHI
Gjergji MIMA
Hajri MANDRI
Përparim LUCA
Beqir SINA
Naim PLAKU
Beqir SHEHU
Fatmir ZHUZHI
Jahe Delia SELMANI

Fotoreporter: Fehmi Lleshi

Arkivi i gazetës është ME pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

# Skavica në shitje. Kush do ta marrë, Kina apo Turqia?

Kryeministri Rama në Kinë mund të ketë zhvilluar bisedime edhe për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës. Megjithëse zyrtarisht nuk bëhet e ditur, në prapaskenë mund të ketë ndodhur. Një gjë e tillë aludohet edhe nga revista Monitor, e cila në një rubrikë speciale të botuar në fillim të nëntorit, i kushtonte një vëmendje të posaçme investimeve kineze në Ballkan, veçmas në Shqipëri.

"Projektet në energjetikë janë me leverdi, thotë për Montir Geri Selenica, drejtor ekzekutiv në Qendrën Shqiptare për Studime Strategjike, pasi energjia është një mall që shitet kollaj. Konkretisht ka pasur interes për hidrocentralin e Skavicës, hidrocentralet e Vjosës, rinovimin total të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe Albpetrol-in. Kompanitë kineze që kanë paraqitur interes për këtë sektor janë më të mëdhatë në botë, si PowerChina, GeZhouBa , Norinco , China State Grid etj.".



Selenica kundërshton veprimet e qeverisë shqiptare për të negociuar për Skavicën me një firmë turke. Sipas tij, është në interes të qeverisë shqiptare dhe popullit shqiptar që Skavica të mos jepet me koncension, por të ndërtohet dhe të jetë një pronë e shtetit dhe popullit shqiptar.

"Qeveria shqiptare ende nuk e ka të qartë se ç'duhet të bëjë me secilin nga projektet dhe me sektorin në përgjithësi, shkruan ai në intervistën për Monitor. P.sh., rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike ka nevojë për një rinovim total se është mbi 50 vjet i amortizuar, dhe qeveria në vend ta bëjë këtë nga A tek ZH, merret vetëm me ndërhyrje kozmetike, duke vendosur disa Smart Meters gjermane!!! Ose për hidrocentralet e Skavicës dhe Vjosës, qeveria dëshiron që t'i japë me koncesion te disa firma të vogla turke, ndërkohë që injoron propozimet nga firma gjigante kineze".

Ai sqaron propozimet kineze në këtë drejtim, duke i vënë theksin sidomos në lidhje me ndërtimin e HEC të Skavicës.

"Skavica, duhet të mbetet në pronë të KESH, që të jetë rezervuari më i madh ujor i Shqipërisë (tre herë më i madh se Fierza) dhe të bëjë gjithë optimizimin e Kaskadës së Drinit, duke rritur 20% efektivitetin energjetik të saj. Madje një nga firmat kineze i ofroi qeverisë shqiptare një kredi të butë 30-vjeçare, me 2% interes në vit dhe me 7 vjet grace period (faljeje), aq sa zyrtarët më të lartë të qeverisë nuk arrinin dot t'ju besonin veshëve. Dhënia me koncesion është krejtësisht në dëm të Shqipërisë. Lexuesi duhet të dijë që HEC Skavicën kanë dështuar ta marrin me koncesion firmat më të mëdha në Europë, si ENEL, EVN, RWE, etj., pikërisht për këtë arsye. Dhe nuk mendoj kurrë që një firmë hotelesh nga Turqia do të arrijë ta ndërtojë. Pa llogaritur që qeveria nuk ka bërë asnjë konsultim me popullsinë e Dibrës për këtë projekt. Ose qeveria nuk i kthen fare përgjigje PowerChina (ka 53% të tregut botëror të hidroenergjisë) për propozimin e saj për ndërtimin e gjithë kaskadës së Vjosës, që përfshin një zgjidhje të integruar dhe me Greqinë. Ndërkohë jep me koncesion HEC Poçem te një firmë turke që merret me tregtim makinerish ndërtimi!!!"

- "Skavica duhet të mbetet në pronë të KESH, që të jetë rezervuari më i madh ujor i Shqipërisë (tre herë më i madh se Fierza) dhe të bëjë gjithë optimizimin e Kaskadës së Drinit, duke rritur 20% efektivitetin energjetik të saj.
- Një nga firmat kineze i ofroi qeverisë shqiptare një kredi të butë 30-vjeçare, me 2% interes në vit dhe me 7 vjet grace period (faljeje), aq sa zyrtarët më të lartë të qeverisë nuk arrinin dot t'ju besonin veshëve.
- Dhënia me koncesion është krejtësisht në dëm të Shqipërisë. Lexuesi duhet të dijë që HEC Skavicën kanë dështuar ta marrin me koncesion firmat më të mëdha në Europë, si ENEL, EVN, RWE, etj., pikërisht për këtë arsye. Dhe nuk mendoj kurrë që një firmë hotelesh nga Turqia do të arrijë ta ndërtojë.
- Qeveria nuk ka bërë asnjë konsultim me popullsinë e Dibrës për këtë projekt.

Sipas Selenicës, refuzimi i ofertave të tilla ka vetëm një shpjegim: qeveria shqiptare, mbase për arsye "gjeostrategjike", nuk dëshiron futjen e investimeve kineze në energjetikë. Unë besoj që kjo është një dritëshkurtësi e kushtueshme, pasi PowerChina që ofroi të ndërtonte HEC-et e Skavicës e Vjosës, firmosi muajin e shkuar në prezencë të presidentit kinez Xi Jinping dhe të kryeministrit David Cameron ndërtimin e një centrali atomik në Angli prej 13 miliardë paund.

Shkurt, thekson Selenica për Monitor, në hidroenergji Kina ka interesim shumë të madh me propozime që arrijnë në total mbi 3 miliardë euro, por Shqipëria ia ka mbyllur portën dhe këtë e them me përgjegjësi të plotë, pasi jam në brendësi të çdo projekti. Dhe nuk ka zyrtar të shtetit shqiptar që të mund të më dalë para dhe të më argumentojë të kundërtën.

Gjatë vizitës së Ramës në kuadrin e Samitit të 4-t të Kinës me vendet e Europës Lindore dhe Juglindore, zyra e kryeministrit, duke iu referuar bisedimeve me homologun kinez, thekson interesin dypalësh për investime kineze në infrastrukturë, porte, parqe industriale, bujqësi e turizëm. Ndërsa investimet në energjetikë nuk janë përmendur fare. Të paktën, sipas njoftimit zyrtar.

Zyra e Kryeministrit Edi Rama konfirmon se gjatë bisedimeve me kryeministrin e Kinës është diskutuar për finalizimin negociatave. Ora News zbulon koston e projektit: 36 miliardë lekë - rreth 260 milionë euro. Brenda dhjetorit pritet që marrëveshja të miratohet në Këshillin e Ministrave. Më pas, sipas ligjit të miratuar në prill, Kuvendi miraton marrëveshjen dhe i hapet rruga nisjes së punimeve.

Nga **BUJAR KAROSHI**

Nga Kina vijnë lajme për Rrugën e Arbrit, ndërsa në Shqipëri gjithçka është në heshtje. Ndërsa lajmet optimiste nga Lindja e Largët thonë se është biseduar për detajet e fundit mes dy kryeministrave, Rama dhe Li Keqiang, në Shqipëri asnjë nga ministritë e përfshira në negociata nuk bën asgjë transparente për publikun.

"Një tjetër moment i bashkëbisedimit ishte finalizimi i negociatave për të filluar punimet në rrugën e Arbrit", - thotë zyra e Kryeministrit të Shqipërisë në një njoftim për publikun mbi vizitën e Kryeministrit në kuadrin e Samitit Ekonomik Kinë-Europa Qendrore dhe Lindore.

Radioja e Jashtme e Kinës citon kryeministrin kinez Li Keqiang të ketë thënë në bisedimet me kryeministrin shqiptar se "Shpresojmë që të nisë sa më parë ndërtimi i rrugës së Arbrit, të shtohen bashkëpunimet në fushën e financës, minierave dhe bujqësisë".


Këto deklarata mediat në Shqipëri i përkthyen si finalizim të marrëveshjes, pavarësisht faktit se kjo nuk bëhet e ditur zyrtarisht. Televizioni "Ora News" e lidh këtë firmosje edhe me pengesat që mund të kenë ardhur si rezultat i ndërhyrjeve të Bankës Botërore.

"Nga Kina kryeministri Edi Rama njoftoi finalizimin e marrëveshjes me kompaninë kineze "China State Construction" për vijimin e punimeve në Rrugën e Arbrit. Kompania kineze ka fituar të drejtën e ndërtimit të 26.94 kilometrave në Rrugën e Arbrit nga 65 km që është gjithsej. Pavarësisht se marrëveshja me kompaninë kineze është miratuar në parlament, diskutimet ishin bllokuar për shkak të kërkesës së kompanisë drejtuar Bankës Botërore për rishikim të fondeve si pasojë e terrenit të vështirë. Por marrëveshja e arritur në Kinë i jep fund këtij ngërçi", - citon burimet e veta televizioni më 26 nëntor. Madje, Ora News ka arritur të sjellë edhe detajet e kostos së ndërtimit të këtij segmenti, që vlerësohet rreth 36 miliard lekë - rreth 260 milionë euro.

## NEGOCIATAT LARG SYRIT TË PUBLIKUT

Në fillim të nëntorit, ministri i Transporteve Edmond Haxhinasto, gjatë një vizite në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit rrugor, pyetjes së gazetarëve në lidhje me ecurinë e negociatave me "China State Construksion" thekson se "për sa i takon Rrugës së Arbrit, është bërë një ligj, i cili ka përcaktuar një procedurë të veçantë për trajtimin e kësaj vepre. Grupi i punës është ngritur që para dy muajsh. Ka pritur dhe konsulencën ndërkombëtare të domosdoshme për këto lloj kontratash, për kompleksitetin dhe rëndësinë që ato kanë. Besoj që me përfundimin e procesit të përzgjedhjes së konsulencës, që u bë para pak ditësh, grupi i punës do të rizgjidhet për të vlerësuar edhe ai me transparencë të plotë dhe gjithashtu nëse kjo ofertë e kompanisë kineze ka interes publik. Me

# Li Keqiang: **Shpresojmë që të nisë** sa më parë **ndërtimi i Rrugës së Arbrit**



*Në foto: Kryeministri kinez Li Keqiang dhe ai shqiptar Edi Rama gjatë takimit në Pekin, në kuadrin e samitit të 4-t mes Kinës dhe 16 vendeve të Europës Qendrore e Lindore (Foto:albanian.cri.cn). Në sfond: Një segment i Rrugës së Arbërit në luginën e Planit të Bardhë, nëntor 2015.*

të përfunduar vlerësimin grupi i punës, edhe atë vlerësim do t'jua vëmë në dispozicion që ta studioni, ta shikoni, gërmë më gërmë".

Ndërkohë që ministri flet për transparencë, asgjë nuk bëhet e ditur për ecurinë e negociatave.

Në lidhje me detajet e financimit të dhënat priten të bëhen publike shumë shpejt. Deri më tani, askush nga qeveria nuk ka dhënë detaje në lidhje me tërheqjen e "Exim Bank" nga financimi. Një marrëveshje mes qeverisë shqiptare dhe firmës ndërtuese mund t'i kenë dhënë zgjidhje problemit të financimit, njëra prej të cilave është ndërtimi i rrugës në bazë të një marrëdhënie partneritet publik-privat ose financimi i plotë nga qeveria shqiptare.

Kosto e këtij projekti ishte parashikuar rreth 300 milionë euro para se koalicioni i majtë të vinte në pushtet. Ndërsa më pas, kur kompania kineze ka filluar negociatat, është folur për një kosto të ndërtimit të rrugës në pjesën e mbetur prej afro 27 km, prej 200 milionë eurosh. Kjo shifër, herë është ulur dhe herë është ngritur sipas orekseve të ditës të debatit politik. Ndërsa Ora News thekson se kosto finale do të jetë 36 miliardë lekë, afërsisht 260 milionë euro. Njëra nga arsyet që këto negociata kanë qenë të vështira është trafiku  i parashikuar në këtë aks, i cili nuk e "justifikon" investimin. Në rastin e ndërtimit të rrugës me koncension, burime pranë qeverisë thonë se kompania kineze ka kërkuar një taksë prej 5 eurosh për makinë, ndërsa qeveria ka kërkuar që taksa të mos kalojë 1 euro për 10 km rrugë, çka do të thotë që taksa e kalimit për makinat e vogla nuk duhet të jetë më shumë se 3 euro.

### ÇFARË THOTË LIGJI?

Marrëveshja me firmën kineze po negociohet në bazë të një ligji të miratuar posaçërisht nga Parlamenti shqiptar në 16 prill 2015. Ligji, i cili është miratuar në heshtje nga Presidenti i Republikës, pra nuk e ka marrë firmën e kreut të shtetit, përcakton afatet kohore që duhen për negocimin e marrëveshjes.

Sipas ligjit të botuar në Fletoren Zyrtare, "procedura e negocimit për lidhjen e kontratës ndiqet nga Komisioni i Negocimit të Kontratës, kryesuar nga Ministria e Transportit dhe In¬frastrukturës dhe me anëtarë, përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmar¬rjes, Ministrisë së Drejtësisë dhe Avokaturës së Shtetit". (Neni 2)

"Projekt-kontrata, e shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave, brenda një afati prej 60 ditësh nga nisja e negociatave, i dërgohet për nënshkrim Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes" (Neni 2).

"Nënshkrimi i kontratës, thuhet në nenin 3 të ligjit, bëhet nga Ministri i Transportit dhe In-frastrukturës, Ministri i Financave dhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes pas dorëzimit të projekt-kontratës dhe relacionit përmbyllës të negociatave nga komisioni negociues. Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Ministri i Financave dhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes mund t'i kërkojnë komisionit negociues rishikimin e projekt-kon¬tratës" Ndërkohë, "Komisioni i Negocimit të Kontratës duhet të rinegociojë dhe t'u paraqesë për nënshkrim ministrave projekt-kontratën,shoqëruar me relacionin përmbyllës të negoci¬atave brenda afatit kohor prej 30 ditësh, duke filluar nga data e kthimit".

### AVOKATURA E SHTETIT PUBLIKON KËRKESËN PËR TË GJETUR ZYRË KONSULENCE, POR NUK BËN PUBLIK FITUESIN

Më 8 tetor 2015, Avokatura e Shtetit shpalli një ftesë për negociatë për të gjetur një zyrë konsulence, e cila do të shqyrtonte marrëveshjen. Zyra e përzgjedhur kishte për detyrë të studiojë në tërësi propozimin e paraqitur, korrespondencën dhe çdo dokument tjetër në lidhje me propozimin dhe projekt-kontratën. Ajo duhet të bëjë vlerësimin e situatës ekzistuese, të përgatitë strategjinë për negocimin e propozimit të paraqitur dhe lidhjes së kontratës me objekt ndërtimin. Gjithashtu, Zyra e Konsulencës duhet të sigurojë ekspertizën e kërkuar ligjore dhe financiare për zhvillimin e procesit të negocimit të propozimit të paraqitur dhe lidhjes së kontratës, të asistojë Komisionin e Negocimit të Kontratës në zhvillimin e procesit të negocimit të propozimit të paraqitur dhe lidhjes së kontratës brenda afateve të caktuara, në mënyrën më optimale të mundshme, duke përfshirë por pa u kufizuar sigurimin e ekspertizës ligjore dh financiare, pjesëmarrjen në takime siç mund të rezultojë e domosdoshme si edhe kryerjen e çdo veprimi tjetër me qëllim realizimin me sukses të negocimit të propozimit të paraqitur dhe lidhjes së kontratës, të bëjë vlerësimin dhe interpretimin e ligjit shqiptar si ligj i zbatueshëm i kontratës, në bashkëpunim me palën tjetër të procesit të negocimit, të kërkojë të gjitha autorizimet apo akt-përfaqësimet e nevojshme për realizimin e asistencës që kërkohet.

Avokatura e Shtetit i ka pritur ofertat deri më datë 15 tetor, por nuk ka bërë asnjë njoftim të mëvonshëm për shpalljen e fituesit. Një email i dërguar Avokaturë së Shtetit për të marrë më shumë informacion mbi fituesin ka mbetur pa përgjigje.

Sipas ligjit të miratuar në Prill, kur marrëveshja të nënshkruhet mes palëve, ajo do t'i dërgohet për miratim Këshillit të Ministrave, brenda afatit kohor prej 10 ditësh nga data e nënshkrimit nga tre ministrat. Më pas, kontrata do të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe data e hyrjes në fuqi të kontratës do të konsiderohet data e hyrjes në fuqi të ligjit pas miratimit nga Kuvendi.

Nëse lajmet që vijnë nga Kina  do të jenë të vërteta, nënshkrimi i marrëveshjes mund të jetë një lajm i mirë për Vitin e Ri për banorët e qarkut të Dibrës dhe shqiptarët matanë kufirit. Ndryshe, qeveria duhet të përballet me pakënaqësitë në rritje që vijnë si rezultat i mosmbajtjes së premtimeve.

### PARTITË POLITIKE DHE SHOQËRIA CIVILE

Ndërsa nga Kina vijnë lajme optimiste dhe nga burime zyrtare ka mungesë informacioni, kjo hapësirë po shfrytëzohet nga partitë politike në opozitë për të fituar mbështetje politike.

Në fillim të nëntorit në Maqellarë u zhvillua një protestë e udhëhequr nga Kreshnik Spahiu, kryetari i Aleancës Kuq e Zi, i cili theksoi se "Rruga e Arbërit nuk i bie nga Kina. Të arrestohen gjithë ministrat për shpërdorim të parave dhe pezullimit të punimeve të saj". Më herët protesta ishte njoftuar si një organizim i shoqërisë civile dhe qytetarët u çuditën kur në krye të saj panë liderin e Aleancës Kuq e Zi.

Gëzim Alpion, nismëtari i peticionit online për Rrugën e Arbrit, tha për gazetën se gjithkush ka të drejtë të ngrejë zërin brenda normave të demokracisë. Megjithatë, shtoi ai, mënyra se si u organizua kjo protestë të bën të mendosh se partitë, edhe këtë radhë e disa më herret, disa më vonë, me sa duket po mendojnë se si të "mjelin" Dibrën për interesat e tyre kur të vijnë zgjedhjet e 2017-tës. Në këto lloj protestash të kalkuluara për përfitime personale dhe partiake i trajtojmë me neveri. Siç e kemi bërë të qartë që në fillim, ne si intelektualë nuk merremi me protesta rrugësh. Ne kemi qenë dhe jemi për dialog konstruktiv me qeverinë. Rama dhe të besuarit e tij në Dibër, që megjithëse nuk dinë asgjë të saktë se çfarë po bëhet konkretisht për këtë vepër, vazhdojnë të përsërisin si papagallë thërrime informacioni që dëgjojnë kafeneve. Rama dhe dibranët me ofiqe do të detyrohet të shpjegojnë një ditë se përse trembet nga ne që ndryshojmë kryekëput nga rivalet e tyre politike, të cilët e kanë mendjen tek protesta rrugësh për të rrëzuar qeverinë. Alpion gjithashtu tha se mbështetësit e peticionit janë duke pritur që qeveria të bëjë hapat e duhura në drejtim të kësaj çështje dhe të mbajë kështu premtimet që u kanë dhënë dibranëve dhe shqiptarëve gjatë fushatës elektorale. Alpion tha se janë duke pritur rezultatet që do të dalin nga bisedimet me palën kineze dhe në rast se ato do të dështojnë, ai dhe mbështetësit e peticionit do të gjejnë mënyra të reja reagimi. Reagimi ynë nga janari i 2016-tës, tha Alpion, po qe se kjo qeveri, si të tjerat para saj nuk e mban premtimin për rrugën, do t'i djegë këtij Kryeministri që flet vend e pa vend për rolin e shoqërisë civile në takimet në Kinë dhe Vjenë, por nuk ka kortezinë të bisedojë me shoqërinë civile në Shqipëri, shumë më tepër se protestat e rrugëve.

* * *

Pavarësisht se si do të shkojnë negociatat, debati për rrugën do të vazhdojë. Për sa kohë që partitë politike e shikojnë këtë çështje më shumë për të thithur vota sesa për fitimet ekonomike që do t'i vijnë vendit, kështu do të ndodhë. Koha për ndërtimin e Rrugës së Arbrit ka kaluar, ndaj çdo ditë që vonohet, është me kosto të mëdha për ekonominë shqiptare, shoqërinë dhe shqiptarët në Ballkan.

Rruga e Arbërit nr. 115

Qindra matjanë kanë marrë e marrin rrugët e mundimshme të emigracionit, nga sytë-këmbët, siç i thonë... Minierat heshtin... ndërsa në fshatra shumica e tokave kanë mbetur djerrë.

aktualitet

# Mati është zvogëluar shumë

*Nga* **HAMDI HYSUKA**

Dikur, në kohën e qeverisjes me sistem njëpartiak, Mati i jepte Republikës 22% të të ardhurave kombëtare. Arritjen e demokracisë edhe matjanët, si gjithë shqiptarët, e pritën me shpresa të mëdha, por çuditërisht u zhgënjyen. E rëndë ta thuash, por është e vërtetë, se dora e shtetit këtu është minimizuar, qoftë dhe për jetesë minimale në qytet e fshatra. Asnjë investim serioz për Matin nuk është regjistruar. Lista e papunësisë është e gjatë. Qindra matjanë kanë marrë e marrin rrugët e mundimshme të emigracionit, nga sytë-këmbët, siç i thonë... Minierat heshtin, uzina e ferrokromit mezi merr frymë, ndërsa në fshatra shumica e tokave kanë mbetur djerrë. Në interes të qytetarëve asgjë e re s'është ndërtuar nga shteti, përjashtuar pak ndërtime private, të cilat duken sikur qytetin e rinojnë.

Vallë kështu do të mbetet Mati!? Vështirë të parashikosh se çdo të ndodhë me këtë trevë, e cila, po të verë dorë shteti, mund të marrë fytyrë tjetër. Prandaj nga shteti priten shumë investime, sepse sot për sot është në udhëkryq.

Shpopullimi i zonave rurale të Matit vazhdon thuajse me të njëjtat ritme, si ato të viteve të para të tranzicionit. Kjo ka çuar në uljen e ndjeshme të numrit të popullsisë në fshatrat malore. Me gjithë lindshmërinë jo të lartë, popullsia e Matit sot është mbi 62000 banorë, nga 82855 që ishte para mëse 20 vitesh. Mbipopullimi i fshatrave gjatë sistemit të kaluar, falimentimi i industrisë minerare në këto vite dhe tensionet e shumta sociale detyruan një numër të madh banorësh që të largohen nga vatrat e tyre në drejtim të zonave fushore, por dhe jashtë vendit, sidomos në Angli, Itali e Gjermani, deri në Amerikë e Kanada. Largimi nga fshati ka bërë që popullsia e fshatrave Macukull, Gjoçaj, Lami i Madh, Derjan, Shëlli, Vinjall, Xibër, Gurra, Guri i Bardhë, Frankth e disa të tjera të Klosit të ulet nën 50%, në krahasim me 25 vite të shkuara. Kështu, në kërkim të një jete e pune më të mirë, afërsisht 8000 banorë të Matit janë larguar në drejtim të zonave fushore, konkretisht drejt Tiranës, Durrësit, Lezhës e qyteteve të tjera, të cilët janë zëvendësuar kryesisht me familje të ardhura nga fshatrat. Shqetësues është fakti se në masë të madhe janë larguar inteligjenca. Sidomos në arsim, shëndetësi e profesione të tjera ndjehet mungesa e kuadrove.

Për këtë lëvizje demografike shifrat flasin vetë. Shtesa natyrore në vitin 1990 ishte 2314 banorë, vdekshmëria 410. Janë bërë 705 martesa, ndërsa lindshmëria për 100 banorë në vitin 1990 ka qënë 28.1, që do të thotë shumë e lartë me koeficentin e llogaritur nga komuniteti europian, që e kishte 1.2 për 100 banorë. Vdekshmëria ka qënë 5.1



**Për 15 vitet e ardhshme, deri në vitin 2030, strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm të Burrelit tani për tani është në letër. Që nga dita e hartimit të këtij plani, thuhet se ndryshimet dhe investimet do të jenë të orientuara, sipas qëllimeve strategjike. Që Plani Strategjik në këtë bashki të realizohet mbi baza solide, është miratuar nga 81 përfaqësues të komunitetit dhe institucioneve, bashkë me rekomandimet e biznesit burrelas, si dhe frymëzime nga eksperienca të shumë bashkive të ndryshme.**

Në vitin 2000 lindshmëria natyrale ishte gjithsej 1206 fëmijë. Pra, kishte një ulje të lindjeve, por dhe të vdekjeve, që llogariten në 281 raste. Po në këtë vit numri i fëmijëve në fshatra ishte 11869, kurse në qytete 4744. Mosshfrytëzimi i tokës bujqësore, rënia e perspektivës për arsismimin e fëmijëve, papunësia e lartë dhe të tjera arsye si këto, janë shkaqe që fenomeni i shpërnguljes së banorëve të duket diçka si normale. Po a është normal ritmi i kësaj lëvizjeje? Pushtetarët duhet të mendojnë!

* * *

Mati është vend i kulturës, traditës dhe vlerave të mëdha historike. Në të gjitha kohërat është populluar. Ka një perimetër kufitar 172 km dhe sipërfaqe territoriale 102800 ha, të organizuar në 76 fshatra dhe dy bashki. Me gjithë lëvizjet e mëdha demografike të pas viteve '90, përsëri mbi 20000 banorë jetojnë në fshatra, të lidhur ngushtë me punën dhe prodhimin bujqësor. Por, pas ndarjes së re administrative, në njësitë e qeverisjes vendore Burrel e Klos fenomeni i ndryshimit të strukturës së popullsisë është i pranishëm.

Siç thamë, Burreli qytet, përbëhet nga një pjesë e madhe prej të ardhurish nga zonat rurale. Nuk është thjeshtë qendër administrative si dikur, por e gjithë zonës rurale të Matit, për arsye të lidhjes tradicionale të periferisë me qendrën, konkretisht me bashkinë e re Mat. Dhe arsyet janë disa, sidomos lidhjet familjare tradicionale, arsimimi i shumicës së intelektualëve të zonës në shkollat e qytetit, shërbimi spitalor i centralizuar në qytetin e Burrelit, shërbimi postar, sidomos në kushtet e një emigracioni masiv të kësaj zone, aspiratat për një punësim duke përfshirë të gjitha mundësitë që afron qyteti.

**Mbipopullimi i fshatrave gjatë sistemit të kaluar, falimentimi i industrisë minerare në këto vite dhe tensionet e shumta sociale detyruan një numër të madh banorësh që të largohen nga vatrat e tyre në drejtim të zonave fushore, por dhe jashtë vendit, sidomos në Angli, Itali e Gjermani, deri në Amerikë e Kanada.**

Për 15 vitet e ardhshme, deri në vitin 2030, strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm të Burrelit tani për tani është në letër. Që nga dita e hartimit të këtij plani, thuhet se ndryshimet dhe investimet do të jenë të orientuara, sipas qëllimeve strategjike. Që Plani Strategjik në këtë bashki të realizohet mbi baza solide, është miratuar nga 81 përfaqësues të komunitetit dhe institucioneve, bashkë me rekomandimet e biznesit burrelas, si dhe frymëzime nga eksperienca të shumë bashkive të ndryshme.

Po çfarë kërkohet sot për sot?

Burreli të jetë qendër urbane funksionale, që të garantojë lidhjen automobilistike me të gjithë zonat, njësi të reja administrative. Përmirësimi i infrastrukturës brenda qytetit të shikohet në funksion të një shërbimi të dyfishtë, të lidhjes së qytetit me zonat rurale rreth tij, të arrihet përpunimi i produkteve blegtorale e bujqësore të zonës si dhe grumbullimi i tyre, zgjerimi i tregjeve ekzistuese dhe ndërtimi i tregjeve të reja, nxitja e biznesit të artizanatit, që burrelasit e kanë patur në traditë. Duke bashkëpunuar me bashkinë e Klosit dhe njësitë administrative përreth qytetit të Burrelit, të kujdesemi për shfrytëzimin e resurseve dhe potencialeve të klimës, tokës, blegtorisë, pyjeve, jo vetëm në luginën e Matit, por në të gjithë trevën, duke punuar për nxitjen e zhvillimit të tërë zonës përreth qytetit. Vetëm zhvillimi ekonomik dhe punësimi garantojnë e realizojnë mbrojtjen sociale të të gjithë popullsisë, nëpërmjet krijimit të mundësive financiare. Dhe kjo realizohet nëpërmjet uljes së taksave dhe nxitjes së bashkëpunimit me biznesin, me qëllim që ai të grumbullojë sa më shumë mjete financiare, me të cilat të zgjerojë aktivitetin e biznesit të tij. Nga drejtuesit e kulturës e të artit ruajtja dhe pasurimi i vlerave të kulturës, traditës e historisë duhet të jenë objekte pune të vazhdueshme për të vendosur në vendin e vet dinjitetin e qytetarit matjan.

# *Promovohet antologjia poetike matjane*

*Nga* **ILMI DERVISHI**

Në Shtëpinë e Kulturës Burrel promovimi i librit Antologjia e poezisë matjane: "Udhëtarë me pranverën". Mori pjesë deputeti i zonës Bedri Hoxha, kryetari dhe nënkryetari i Bashkisë Mat Nezir Rizvani dhe Rustem Nuzi, poetët e shkrimtarët e dëgjuar Namik Selmani, Vasil Prenci, Behar Gjoka, Gjok Dabaj, Fato Malo, Kujtim Stana, Lindita Doda, Adile Baleta, kulturologu Mevlud Buci, botuesi i gazetës "Mati" Qemal Ceni, i Revistës "Emathja" Artan Kurti, poeti Veteran Koli Ndreka, Adivie Hoxha, anëtari i LSHA të Shqipërisë Basir Bushkashi dhe Faik Xhani, studiuesi i mirënjohur Sefer Duka dhe një sërë poetësh e krijuesish matjanë e nga qytetet e tjera të Shqipërisë. Studiuesi dhe krijuesi Behar Gjoka, ishte moderatori i këtij takimi.

Aktiviteti kaloi mirë dhe bukur. Por ajo që më bëri përshtypje dhe dua ta theksoj me forcë që interesimi i drejtuesve të Bashkisë Mat e Klos. Ata dhanë shkëndinë e parë për një kujdes e vlerësim të krijuesve në përgjithësi dhe veçanërisht për poetët matjanë. Bashkia Mat bëri sponsorizimin e librit Antologjia e poezise matjane "Udhëtarë me pranverën" si dhe bëri gjithë organizimin e kësaj veprimtarie. Në këtë tubim promovimi përshëndeti edhe kryetari i Bashkisë Mat z. Nezir Rizvani, i cili veç falënderimit e urimit të autorit Hamdi Hysuka dhe pjesëmarrësve në hartimin e kësaj antologjie theksoj: "Ne shpenzojmë aq para sa s'mbetet asgjë për t'u parë e përshëndetur, kurse kjo e sotmja u bë më shumë pak para dhe mbetet një vepër me shumë vlera për Matin e matjanët. Prandaj krijuesit poetë e shkrimtarë, piktorë e skulptorë do të jenë gjithnjë e më shumë në vëmendjen tonë. Ne do të bëjmë të gjithë përpjekjet për të mbështetur aktivitetin mbarëkombëtar "Sofra Budi" apo si do që do të vendosim ta quajmë në tetorin e çdo viti si dhe do të përpiqemi seriozisht për sponsorizimin e veprave me vlerë si kjo e anatologjisë matjane.

Një risi në Antologjinë poetike është se nga 96 autor pjesëmarrës 22 janë autorë femra. Në podium ngrihet e përshëndet e lexon poezinë e tij poeti Kurt Kola, e më pas lexohet dhe një poezi e poetit Hysni Milloshi. Poezia s'ka ngjyrë, poezia është shpirti poetik. Poetja Lindita Doda pas përshëndetjes së saj lexon një poezi të Fatmir Alimanit, pjesëmarrës në antologji por që nuk ishte në sallë.Poetja Adivie Hoxha, ardhur posaçërisht nga Durrësi, ashtu në Karrocën e invalidit, përshëndeti dhe entuzmoi sallën me poezinë e saj,

Ishte një bashkëpunim i rrallë midis bashkive të vendit tonë, por poezia dha shembullin me të mirë duke mbledhur pa dallime partiake të gjithë poetët që nga poeti i parë i poezisë shqipe Pjeter Budi, Kurt Kola e deri te më e reja, Elisabeta Kurti.

U recituan poezi nga antologjia, u kënduan këngë nga këngëtari i dëgjuar Shpëtim Farrici, autorin Hamdi Hysuka, për poetin e dëgjuar Vasil Prençi, Sami Milloshi, Riza Doda, Fatmir Alimani, Basir Bushkashin, Koli Ndrekën, Namik Selmanin, Xhavit Gasa, Qemal Cenin, Fatmir Gjestilën. Për ish-plejadën e atyre mësuesve që përgatiten dhjetëra poete të rinj si Bashkim Papadhimo, Behar Sinani, Drita Doçi, Hysnie Dervishi, Xhuma Çupa e në veçanti Basir Bushkashi që mbolli farën e poezisë në Mat, për prozatorin Gjok Dabai, Çezar Rica, Adivie Hoxha, Mevlud Bucin, Lindita Doden, Foto Malen. Një kujtim i bukur për të ndjerët Isuf Meta, Hysni Milloshi, Simon Kaca, Ymer Toci etj. Promovimi i Antologjisë poetike matjane ishte një aktivitet që i hapi rrugën aktiviteteve të tjera, me njohje e bashkëpunim mes krijuesve matjanë kudo që ndodhen. Gjithashtu më të pranishmit u shtrua edhe një drekë punë e sponsorizuar nga Bashkia Klos me kryetar z. Basir Cupa.

portret

Nga frutikultura te blegtoria, nga zdrukthëtaria në turizëm, nga qytetar i lirë në njëri të angazhuar: shembull për komunitetin i një njeriu dhe familjeje

# **Qamil Lata**, njeriu që bazon suksesin në punë dhe humanizëm



*Nga* **OSMAN XHILI**

Duhet të ketë të paktën 300 vjet, apo shtatë breza, qëkurse familja e Lateve zbriti nga fshati Letaj i Hasit të Thatë. Një pjesë në Mustafe, një pjesë në Dibër të Madhe, e një pjesë tjetër në Staravec, pak përmbi qytetin e Peshkopisë. Në shkrimin tonë, ne po flasim për këtë degëzim të fundit, për Qamil Latën, fëmijët, vëllezërit, kushërinjtë e të afërm të tij.

Të parët e tyre u morën me bujqësi e blegtori, duke shfrytëzuar më së miri resurset e fshatit që e zgjodhën për të qëndruar përgjithmonë. Ndoshta, ata nuk qenë pronarë të mëdhenj, por ishin pasionantë, meraklinj, siç shprehet Qamili.

Përveç grurit, misrit, jonxhës e kulturave të tjera, Latet e parë mbollën dhe një bahçe për tu pasur zili, me të gjitha llojet e pemëve. Mollët e tyre ishin shumë të larta, me një kurorë të jashtëzakonshme, me një diametër të trungut mbi një metër. Një pemë e tillë prodhonte deri në 15 kuintalë dhe e gjitha kjo, pa asnjë lloj spërkatje. Hanin lopët mollët e rëna deri në vjeshtën e vonë, hanin fëmijët pa kursim dhe dimrit frutat me një aromë teje të veçantë, shërbeheshin pasdarkeve për mysafirët. Servireshin dhe arra, gështenja, ftonj, të gjitha këto, prodhime të shijshme e cilësore. Bahçe të tilla kishin dhe Ramadan Kurti, Dilaver Ramku dhe ndonjë tjetër, por të gjitha u dëmtuan në kohën e kooperativave bujqësore, në mënyrë të pariparueshme.

### RIKTHIM NË TRADITË

Rrodhën vite te tjerë në demokracinë e brishtë shqiptare, kur frymëzimi dhe zhgënjimi shpesh ndërronin vendet, si batica me zbaticën. Qamili kishte energji jo të vogla fizike, intelektuale e shpirtërore. Të gjitha këto duheshin kombinuar në një formulë të saktë, për të prodhuar një rezultat sa më maksimal. Filluan hapat e parë me pemëtore, duke mbjellë 14 dynymë mollë dhe gati tre hektarë qershi. I mbolli dhe për nostalgji të bahçes së parë, por dhe për të testuar veten në tregun shqiptar, që po i hapte portat me shumë vështirësi. Rezultatet tek molla nuk ishin dhe aq të lakmuara, kurse qershia rezultoi më produktive. Varietetet, fidanët, preparatet kimike, përbërja e tokës, ofertat e tregut apo faktorë të tjerë, të njohur e të panjohur, mund të kishin ndikimet e tyre negative.

Qamili dëshiron të ketë arrën të pranishme në pronën e tij, në pemëtoren e tij. Kujton arrën e dikurshme kokërrmadhe e me lëvozhgë të hollë e synon ta rikthejë. Tashmë, ai ka të mbjellë rreth 130 rrënjë nëpër mezhda, nëpër zabele, për ta trefishuar këtë numër shumë shpejt në të ardhmen.



*Qamil Lata, djathtas dhe ferma e tij me drurin Paulonia*

### NË KËRKIM TË TË RESË

Por, Qamili e njerëzit e tij , janë vazhdimisht në kërkim e në eksperimentim . Kishte kohë që një bimë – pemë, Paulonia, po i tërhiqte vëmendjen, me vlerat që ajo paraqiste. Këtë vit, Qamili mbolli më shumë se një hektarë me këtë bimë të re për bujqësinë shqiptare. Fidanët i mori në Serbi, së bashku me instruksionet e duhura. Fillimi duket premtues. Fidanët dhe pse janë vetëm disa mujorë, kanë rreth tre metër lartësi. Në pranverë do të këputen në 10 centimetër lartësi, për të fuqizuar sistemin rrënjor, e më pas do të duhen tre vite të tjerë, deri në kohën e prerjes për shfrytëzim. Nëse punët shkojnë mbarë, në pranverën që vjen, do të mbillen dhe tre hektarë të tjerë, pa prekur tokën e bukës, por duke shfrytëzuar zabelet, që ai ka në pronësi. Qamili ka mundësi të blejë çdo ditë,dy apo tre pagure qumësht për nevojat e familjes, por preferon më mirë të ketë qumështin e lopës së tij, sërish si nostalgji e amanet i të parëve. Dhjetë kokë të imta, që ai mbarështon, e bëjnë më të plotë panoramën. Ai do të donte që tufën ta kishte më të madhe, që dhjetës së paku ti vinte një zero nga pas,pra me 100 krerë, me kusht që të gjente një bari të mirë për t'u kujdesur për tufën.

### ZDRUKTHËTARIA, NJË TRADITË FAMILJARE

Veç të tjerash, Qamili pati dhe një tjetër pasion të hershëm, zdrukthëtarinë. Dajat e tij te fisi Maha në Limjan, ishin të përmendur në këtë drejtim, ashtu siç kishin qenë gjyshërit, të ardhur nga Stambolli. Që herët ata kishin furnizuar Dibrën me dërrasë për dyer, djepa, çekmexhe e për plot pajisje të tjera. Qamili nuk bëri, e nuk pati ndonjë kualifikim të veçantë, por diku gjeni i dajallarëve e gjyshërve, zgjoi një dëshirë për t'u marrë me këtë art të bukur e të vjetër, sa dhe vetë njerëzimi.

Pasioni u kthye në biznes dhe pas viteve nëntëdhjetë, ai filloi të zgjerojë aktivitetin akoma më shumë. Bashkë me të, tani punojnë vëllai i tij, Shaqiri, kushëriri i tij, Rifani, si dhe dy djemtë Pajtimi e Ylberi. Ky grup pune shtohet dhe me pesë ose dhjetë punëtorë të tjerë sezonalë, duke u bërë kështu një firmë serioze, kompetitive dhe me pretendime në të ardhmen. Ata prodhojnë dyer dhe shkallë shumë të bukura që kërkohen jo vetëm në Dibër, por dhe më gjerë. Lënda e parë, dërrasa, është shumë e rëndësishme për Qamilin, ndaj ai e zgjedh me kujdes duke e marrë furnizimin deri në Sllloveni apo Kroaci . Firma e tij ka një gatër të fuqishëm për të çarë trupat, një kamion me vinç, magazinë e reparte pune të kompletuara. Por në të ardhmen mendojnë të hyjnë dhe te mobiliet, dhomat e gjumit, kundrabufetë e shumë lloje të tjera cilësore, me kusht që tregu të jetë më i garantuar e me rregulla më të qarta loje. Qamili është bërë një mjeshtër e njohës i të gjithë llojeve të drurit. Ka konsideratë dhe për drurin e plepit, të cilin e vlerëson si elastik për çatitë dhe i paprekshëm nga parazitë të ndryshëm. Por vëmendja e tij është kthyer nga druri i Paulonias. Kjo është një ndër arsyet që ai ka filluar ta kultivojë, e më pas ta përpunojë atë, duke shpresuar që ta prodhojë vetë lëndën e parë për aktivitetin e tij.

### NJË BURIM TERMAL QË TË FTON PËR INVESTIME

Fare pak poshtë fshatit të tij, Staravecit, ndodhen llixhat e famshme të Peshkopisë . Por duket se Zoti është treguar shumë bujar me këtë njeri, duke i dhuruar një tjetër pasuri kolosale. Atje ku kufizohen llixhat me zabelet e tij, poshtë fshatit, ndodhet një burim i ri ujërash termale, të cilin, Qamili mendon ta shfrytëzojë në të ardhmen. Ky burim është i ri dhe i vjetër në të njëjtën kohë. Fshatarët e njohin këtë vend me termin "Banjat e zgjebes". Këtu janë kuruar njerëz me sëmundje të ndryshme lëkure, këtu janë kuruar dhen, dhi, mushka e kuaj me zgjebe dhe rezultatet kanë qenë fantastike. Veç ujit të bekuar,vetë burimi prodhon një botë, një baltë shëruese që po ta lyesh kokën me të pastron zbokthin apo lufton ekzema të ndryshme. Qamili kujton se si një ditë, një miku i tij kishte kruarje të forta në bark. Përpiqej të mos u binte në sy të shokëve, por kjo ishte e pamundur. Në dorë kishte një recetë ilaçesh, që ia kishte dhënë mjeku i lëkurës pas vizitës së bërë.

- Grise, - i thotë Qamili, se do të shëroj unë. Hyp në makinë! Miku i tij habitet, por nuk kundërshton. Shkojnë me makinë tek gropa me ujëra termale, në livadhet e Qamilit dhe aty i sëmuri me një ekzemë të fuqishme bën një dush. Të nesërmen binte shi, por i sëmuri, me çadër në dorë bën sërish dush. Rituali përsëritet për katër ditë rresht e të pestën ai takon sërish Qamilin.

- Shiko këtu! - i thotë, duke i shtruar barkun, pa u vënë re nga të tjerët. Qamili vërtet habitet nga ajo që kishte ndodhur dhe pse priste njëfarë ndryshimi. Lëkura me flluska dhe e pezmatuar, para ca ditësh, tani ishte krejt normale dhe pa asnjë shenjë. Por Qamili dëshiron ta disiplinojë punën në këtë drejtim e të mos ia lerë spontanitetit. Ai ka gërmuar me kujdes me fadromë, dhe hurdha e dikurshme në sipërfaqe, është ulur dhjetë metra më poshtë. E kundërta ndodhi me temperaturën e ujit,nga 26 gradë që ishte në sipërfaqe, u rrit me 12 gradë, duke shkuar ne 38. Me sa duket aty është dhe bazamenti pasi janë gjetur gurë të një vaske të vjetër, që dëshmon se uji aty është përdorur që në kohëra të hershme.

Megjithatë,Qamili i bëri analizat e ujit në Itali, dhe mjekët të surprizuar i thanë se shfrytëzimi i ujit duhet të fillonte sa më parë,qoftë dhe me çadra të thjeshta. Burimi i ujit termal këtu është 2,8 litra në sekondë, që mund të shtohet akoma. Specialistët e konvertojnë këtë shifër me 500 veta që mund të pushojnë e të kurohen në një sezon 10 – 15 ditor,dhe kjo nuk është pak. Duhen investime, duhet një hotel, duhet një infrastrukturë e Qamili ka filluar të mendojë për këtë seriozisht.

### NË POLITIKË ME QËLLIME HUMANE

Sa shumë gjëra ka për të shkruar për këtë njeri të mirë,për këtë familje jo vetëm punëtore, por dhe intelektuale, besimtare e shumë humane. Të flasësh për vëllezërit Garipin e Bexhetin me shkolla të larta e me rezultate të shkëlqyera,dy djemtë intelektualë dhe pse punojnë në zdrukthëtari, për nuset e tyre mësuese dhe intelektuale apo babanë e tij Fadilin, kryetarin e parë të kooperativës në vitin 1957. Nuk po e hapim këtu kapitullin e politikës,ku Qamili konkurroi në zgjedhjet e fundit vendore, nën siglën e P.D.I.U.-së. Ndonëse, për herë të parë dhe pa struktura partie, rezultati qe tejet surprizues: 2873 vota, tre këshilltarë për në bashki, si dhe pozicioni i sekretarit të qarkut. Qamili është i pakënaqur nga politikat e deritanishme, ndaj dëshiron t'i shërojë njerëzit me ujin e tij termal, por dhe me politika të drejta humane. Hapësirat e një shkrimi janë tepër të vogla për njerëz si Qamil Lata e ndoshta do të duhet shkruar një libër për ta pasqyruar më në detaje punën e veprën e tij të madhe.





Rruga e Arbërit nr. 115

Nga cikli "Në Rodos mes dibranësh e rrëfenjave për vendlindjen":
Lindosi i Rodosit dhe...Hurdhë Muhurri i Dibrës...!!!

emigracion

# **Malli** i Njazi Zebit që **se shuan deti...**

*Nga* **ABDURAHIM ASHIKU**




**...Njazi Zebi lindi në Ushtelencë në vitin 1953. Shtatëvjeçaren e mbaroi në Brezhdan kurse gjimnazin në Peshkopi në një udhëtim rreth një orë në këmbë. Tre vjet studime në Shkodër do t'i jepnin titullin mësues i kimisë dhe biologjisë.**

**Gjashtë vite në Hurdhë të Muhurrit, me nxënës nga Hurdhë Muhurri, Shqathi e Bulaçi do t'i jepnin kuptim të veçantë jetës...**

Lindosi është një vend i bukur, një vend ku nuk mund të mos udhëtosh drejt tij, të rrokësh me sy gjirin e bukur e të ngjitesh si në Leqet e Valit të Martaneshit apo Leqet e Hotit, zigzagëve...

E ndërsa ngjiteshim me hapa të lodhshëm Njaziu ma mori kujtesën për ta përcjellë të përpjetës plot dredha të Hurdhë Muhurrit...

Një ngjitje me kokën pas...

Një mall që nuk e shuan as deti që tash rrethon nga të gjitha anët ishullin e jetës së tij larg Ushtelencës ku lindi, e larg e larg vendeve ku punoi me përkushtim...

Moshatarët e tij në vite e në profesionin e bukur të mësuesit do të "derdhin një pikë loti adhurimi" ndërsa të rinjtë, ata që nuk e jetuan atë kohë të madhe kur njerëzit ishin më të përkushtuar se kurrë për t'u çuar dritën e diturisë fëmijëve edhe në zonat më të thella malore, jo vetëm për t'u mësuar fëmijëve ABC-në por edhe shkencat bashkëkohore në shkolla të mesme, mbase nuk do ta besojnë, mbase do ta besojnë dhe do të tundin kokën e drejtojnë trupin në shenjë respekti...

...Njazi Zebi lindi në Ushtelencë në vitin 1953. Shtatëvjeçaren e mbaroi në Brezhdan kurse gjimnazin në Peshkopi në një udhëtim rreth një orë në këmbë. Tre vjet studime në Shkodër do t'i jepnin titullin mësues i kimisë dhe biologjisë.

Në shtator të vitit 1975 pas "fushores" nga Ushtelenca në Muhurr mori të përpjetën plot zigzage për në Hurdhë të Muhurrit, fshati që ulur mbi një brezare të natyrës merr i pari rreze mëngjesore dielli në tërë luginën e Drinit të Zi.

Gjashtë vite në Hurdhë të Muhurrit, me nxënës nga Hurdhë Muhurri, Shqathi e Bulaçi do t'i jepnin kuptim të veçantë jetës...

E pyes në se ka pirë ujë me grusht në Krue të Zi...

E pyeta se kam edhe unë mall për ato vende, jo thjesht ujin e Kroit në grusht por për gjithçka që lidhet me ato njerëz e male. Edhe unë atyre anëve e kam filluar për herë të parë punën, agronom në lokalitetin e Muhurrit në pranverë të vitit 1960, ku çdo toponim are, kodre e mali qe bërë pjesë e paharruar e jetës e ma shton mallin kur dikush i përmend.

Pyetja ime e zgjoi më tej kujtimesh...

Jo vetëm kam pi ujë në Krue të Zi, më tha, por përpara se të shkoj mësues, në fëmijëri, me një kalë të vogël jam ngjit shpateve të malit të Runjës për të bërë dru zjarri. (Brezhdani dhe Ushtelenca drutë e zjarrit për dimër i merrnin në pyjet e Runjës.)

Pastaj e njoha mirë atë vend që nga Bulaçi, në Qafë të Palpuce e deri në Qafë të Shtrigave, kam kaluar çdo behar sepse kam qenë mësues edhe i punës, edhe i ekonomisë shtëpiake, kështu që me nxënësit bënim edhe praktikën në terren.

Shkolla e Hurdhë Muhurrit mbulonte tre fshatra: Hurdhë Muhurr, Shqath dhe Bulaç. Kishte rreth 110 nxënës. Fillorja ishte me klasa kolektive, vetëm me një mësues kurse Shqathi dhe Bulaçi kishin nga dy mësues, të parë e të tretë dhe të dytë e të katërt. Kishte edhe një edukatore kopshti që do të bëhej bashkëshortja ime e ardhshme.

Në Hurdhë Muhurr pata fatin të takoj njerëz të cilët kishin mundësi të më japin këshilla. Është një zonë malore ku ata fise Deva, Hoxha, Prençi, Çiku, Rama...28 shtëpi. Pata nderin të njoh Hysen Devën. Pata nderin të njoh Mexhit Prençin, Nazif Prençin, Daut Çikun, Njazi Ramën, ShefkiDevën, Sinan Devën...

Në takimin e parë, ditën e parë isha i veshur me një këmishë me lule si student i viteve 1972-1975. Këmisha ishte një kadife me një lule me formën e kërmillit, me jaka të gjata, me një palë sandale që mi kishte dhënë një bashkëstudent grek nga origjina. Unë me ato sandale, me atë këmishë, shkova në punë.

Takimi i parë ishte me Nazif Prençin.

Më pyeti:

"Oj b... ku shkon?"

Unë u preka kur më tha atë fjalë. Mirëpo në malësi përdorej dhe përdoret për fëmijët e vegjël. Mbasi e mësova nuk mu duk ofenduese, përkundrazi, përkëdhelëse.

Më tha:

"Qenke bërë me djersë. Vishu si për këtu"..

I ndërrova sepse e pashë se me sandale nuk shkohej.

Ftesa e parë si mësues jabanxhi, megjithëse unë dibran isha, mu bë nga Daut Çiku. Oda e miqve në katin e dytë kishte jo ma pak se pesëmbëdhjetë burra. Ndër ta XhetanPrençi, jetë të gjatë pastë më tha:

"Or djalë nga je ti?"

"Nga Ushtelenca, i them."

"I kujt je?"

"I Dullë Zebit."

"Dëgjo or bir. Në qoftë se do të thërrasin edhe herë të tjera këta fshatarët e mi për darkë duhet të kesh një brisk që mos pritesh, të kesh një pasqyrë ta shohësh veten sabah e aksham, të kesh një rrip të shtrëngosh gojën bashkë me mullën."

Nuk e mora vesh se çfarë më tha por në vijim i rashë paksa në të:

"Or bir! Me mbarue shkollën bëhet sebep ndonjë mik e të çon në shkollë të lartë. Por edhe me kalue shkollën nuk është problem se gjendët ndonjë mik e një pesë ta ve. Shih me mixhën, puno këtu por punën bëje vetë se sun vije miku të ta bëjë."

E mbaj mend dhe vërtet u përpoqa ta bëj punën dhe këshillën e atij plaku pa shkollë e mbajta jo vetëm atje ku isha por edhe këtu ku jam. Nga ai vend kujtoj Hysen Devën që bëri që ditën e martesës time me bijën e Muhurrit që njoha në atë shkollë, të mblidhen e të vijnë jo ma pak se 30 burra e të më sjellin një viç pesha e therur e të cilit ishte 62 kile. Ma ka sjellë Hysen Deva rahmet i gjetët shpirti.

Një natë për darkë u thotë fëmijëve Hyseni: "Shkoni e merreni mësuesin dhe i thoni se më ka ardhë një mik por merre vorbën e groshës së më duhet mue këtu."

Ai kishte vorbë groshe që ishte kos sepse kishte një thupër me tre vesha breu që e shtypte groshën. Ai e tha me qëllim që mue të më marrë ke shtëpia që të mos më vijë turp. U thashë merrnia vorbën e groshës dhe shkoni. Fëmijët më thanë "Na ha qeni i Shefkiut or mësues". Qeni i Shefkiut rrinte tek Hyseni, nuk i hante fëmijët. Edhe fëmijët i kishte mësuar ai burrë që të mos i ikin ftesës time për të vajtë tek shtëpia por të këmbëngulin.




Shkova. Ishte ajo natë kur rahmete gjetët, baba i Haxhi Manit vdiq... Nata ma e egër që kam kaluar në Hurdhë Muhurr. Nuk më la që unë të flejë në ata batanije. Unë fleja bashkë me fëmijët. Në njërin krah ishte Hyseni, katër fëmijë ishin në mes, në krah tjetër isha unë, në odën e madhe ku kam shumë kujtime në atë Kepin e Bracës.

Shpesh herë për të më mbajtë mua më thoshte merre kalin shko në Fushë Pejk e të na biesh dë kashtna që unë të vonohesha e të rrija aty.

Këta ishin Hurdhë Muhërrasit.

Një natë e kalova tek Tahir Mani, në Shqath. Shkulëm patate atje sipër. Na çoi fjalë me Haxhiun. Shko e u thuaj mësuesve të vijnë teposhtë. Nuk na la të iknim. Nuk na la se atë e merrte malli për të bërë muhabet.

Ne mësues ishim, ishim si kalamaj, ishim fëmijë. Unë e Sinan Rama ishim. Nuk mund ti përgjigjeshim atij niveli të alegorisë dibrane. Ai kalonte me ne dhe sa ta shihte se nuk i përshtateshim muhabetit thoshte "A ta ndërrojmë pllakën?".

Ky Tahir Mani, kur nuk u fut në kooperativë, me ardhjen e Haxhi Lleshit në Muhurr, i tha "Or Haxhi Lleshi! Unë dhentë e dhitë i kam ruejtë për partinë tande. Tashti hyj në kooperativë. Eja merri njëqind berra sa kam. Se e shihte se ka shkon uji dhe në cilin mulli duhej me bluajtë.

Kam pas fatin të kem në atë shkollë mësuesin e mësuesve, atë që më bëri të jem mësues, Xhemal Berishën. Kam pas edhe mësues të tjerë si Lavdrim Shehin, Petrit Zilin, mësues të mirë që kanë bërë emër në arsimin e rrethit të Dibrës. U përpoqa të jem edhe unë me ta, të ngjitem asaj plejade dhe jam i nderuar, krenar, jam i kënaqur, i kujtoj me nostalgji. E megjithatë përpiqesha të shkoj të takohem edhe kur u largova për Lunarë.

...Atëherë kalojmë nga Hurdhë Muhurri, hedhim mbi fytyrë një grusht ujë në Kroin e Zi, kalojmë rrugës këmbësore nëpër një pyll unikal thanash, ndalemi e pimë një kafe tek kulla e Buce dhe ndalemi atje ku mblidhe ujëra e i japin rrugë Murrës ujëkristal...

*(Vijon)*

# Anekdota e muajit

Ishin dy shokë të ngushtë. Njëri nga Dibra dhe tjetri nga jugu i Shqipërisë.

Ky nga Dibra i mburrej shokut:

- Or taj, a e din mër se çish asht Dibra! Dibra asht qendra e Shqipnajs, or taj!

- Ngadalë, ngadalë... përpiqej shoku i vet t'ia ulte turrin.

- Ngjo ktu, Dibra asht e para në histori, e para në bujqësi, e para në shkencë. Kudo si t'shkojsh, ni dibran t'del përpara. Edhe n'polici, edhe n'shtet!

- Ngadalë, ngadalë, i thoshte shoku i vet, mos u mburr kaq shumë, se nuk është krejt ashtu!

- Po, or tej! Shajf k'tu: Skënderbeu a ishte prej Dibre?

- Po, prej Dibre ishte.

- Migjeni ishte prej Dibre?

- Po, edhe ky prej Dibre ishte.

- Shafj k'tu edhe Enveri gruen prej Dibre e kishte, ene Nan Tereza dibrane ishte.... dhe filloi t'i numëronte njëri pas tjetrit personalitete të mëdha botërore si të kishin origjinën dibrane.

Një moment gjirokastriti ngriti dorën dhe i tha:

- Avash tani, se e teprove. Na e bëre Dibrën qendrën e botës...

- Po, or taj, çataj n'Dibër ka fillue tu u zanë dinjaja. Se ene Eva dhe Adami prej Dibre kan qanë!

- Tani e teprove, i thotë shoku...

- Jo vallahi, s'jam tue e teprue hiq. Kur najsi bota, Eva ene Ademi a kafshuen ni mollë?

- Po, e kafshuan!

- E shef pra, prej Dibre janë se veç n'Dibër bahen mollat!...

*(Rishkruar sipas një versioni treguar nga L.Çika)*




**Një projekt për rindërtimin e varrezave në Dibër të Madhe ka hapur një debat të madh publik në lidhje me atë nëse këto varre janë të asaj periudhe apo janë varre të dibranëve. Debati vazhdon ende, ndërsa financuesit e ndryshuan titullin e projektit nga "Varre osmane" në "Varre të periudhës osmane". Pavarësisht kësaj, debati vazhdon ende dhe një panoramë në lidhje me këtë do t'ju raportojmë numrin e ardhshëm.**

# Ç'kemi asaj Dibre!

*Nga* **BUJAR KAROSHI**

Thashë ta mbyllja njëherë rubrikën, se si shumë e zgjatëm. Por të le qeveria ta mbyllësh. Ajo e kishte një Shkëlqim, që i jepte një shkëlqim gjithë qeverisë, por, ngaqë ikën dy vjet dhe shkëlqimi po binte, i dha impulse të reja duke futur një yll... Kështu që me Yllin brenda, qeveria do ndriçojë më shumë dhe më ngrohtë...

Meqë jemi në qeveri, Kryeministri ishte në Kinë, dhe, siç dihet, sa herë takohet me kinezët, lajm kryesor në Facebook ka për Rrugën e Arbërit. Shpresojmë që këtë herë ta ketë seriozisht... Ta japë si të dojë: n'daç me pagesë, n'daç ta paguajë nga buxheti, veç t'i japë zgjidhje, se po mërzitet populli...

Në fakt, para popullit është mërzit Kreshniku, që edhe ai, si të tjerë politikanë para tij, duan t'i fitojnë pak vota nga prej tij. Por popullit i ka ardhur në majë të hundës, sa në vend të votave, ka bërë gati hurin...

Dhe hurin duket se e kanë bërë gati të parët socialistët e Matit: iu ankuan dy ministrave se qeveria nuk i ka punët mirë me punësimet. "Mos flisni për dështimet, të flasim për sukseset", thanë ministrat, dhe u nxehën socialistët e prishën takimet... Kështu thonë që ka ndodhur edhe në Bulqizë, ndërsa nga Dibra lajmet nuk kanë ardhur akoma...

Prodhimet e vjeshtës u mblodhën. Janë futur në hambarë mollët, ftonjtë, patatet, fasulet... Dhe në mos gjetshin treg gjatë dimrit, në pranverë do ta gjejmë përroin më të afërt...

Në parlament po diskutohet buxheti dhe te ky buxhet qenkan parashikuar ca rrugë fshatrash në Bulqizë e Dibër. Dhe ca copë deputetësh qenkan ankuar: pse ndërtohen rrugët e Bulqizës dhe nuk marrin fonde Tirana e Fieri... Sa mirë që kujtohen deputetët për Bulqizën: veç së prapthi. Kur vjen puna për të ndërtuar, kërkojnë t'ia heqin, kur vjen puna për ta vjedhur, nuk e hapin gojën fare...

Andej nga Dibra e Madhe kanë filluar të trazojnë varret. Ca thonë po i rregullojmë e ca të tjerë po i prishim. Disa thonë që janë varre osmane e ca të tjerë të periudhës osmane. Ca thonë janë varre dibranësh e ca të tjerë të ushtarëve të perandorisë... Dhe në këtë debat, njerëzit kanë filluar të gjejnë varret e të parëve dhe u rezulton se veç varre dibranësh nuk ka...

Për Radikën erdhën fjalë të mira nga Strasburgu... Por fjalët e mira këndej rrallë vijnë dhe punët e mira rrallë e më rrallë... Qeveria e Maqedonisë e ka një projekt që deri në vitin 2030 ta ndërtojë Lukovën, bashkë me Boshkun dhe ca të tjerë të vegjël...

Korabi po ecën mirë në futboll. Që kur Federata e kuptoi që fusha është e rrafshët dhe plot me bar, vendosi që ekipi të luajë në Peshkopi. Dhe që prej asaj dite veç fitore ka marrë, sa tani rrezikon të shkojë në superligë... Duket se ekipin po e ndjek edhe volejbolli i vajzave. Edhe tifozëve po u vjen dalëngadalë qejfi për festime, por kur vjen puna për ta blerë një biletë për ndeshjen, aha, ...ncëk, s'ka lekë...

Meqë e nisëm me yllin, ta mbyllim me flamurin. E ngritëm me 28 dhe e ulëm me 29. Ndërsa me 30 nuk dimë ku e kemi vendosur: i rikthehemi punës për pak korrupsion, sa për të nxjerrë ndonjë lek xhepi...


Fitues i Çmimit të Madh Kombëtar për Letërsinë, 2009

Agron Tufa

THEMBRA E AKCILIT

Miniatura



Botimet M&B

Libri më i shitur në Panairin e Librit "Tirana 2015"

**Agron Tufa**
**Thembra e Akcilit**

Botimet M&B
ISBN:
978-9928-172-62-4
Çmimi: 800 lekë


# Erzi

Nga **AGRON TUFA**

Shoferi me të cilin udhëtoja, Sakipi, ishte një i njohur i vjetër, pinjoll i një prej tre oxhaqeve të Dibrës. Furgoni po hynte në luginën e lumit Mat. Dikush po rrëfente histori ngjethëse nga nëntëdhjetë e shtata, histori bandash që u dilnin në pritë autobuzave dhe furgonave të linjës Peshkopi-Tiranë e kthim.

Një zë i naltë plaku nga mesi po shkaktonte miratime dhe mbështetjen e të tjerëve. Ai fliste dhe e kërkontë vetë miratimin e të tjerëve. "Është një komunist i vjetër nga Sh.,", më thotë Sakipi me zë të ulët. Në thelb, plaku shprehte mendimin se "në kohën e atij rahmetliut (nënkupto: Enver Hoxhës) kishte dhe rend, dhe qetësi, po dhe rregull". Të tjerët ose nuk donin t'i hyjnë kuvendimit me të, ose i thonin një "po, po" neutrale për ta lënë të vazhdojë. Dhe plaku e quajti mbështetje kurajoze këtë reagim, ndaj e ngriti ca oktavë më lart zërin e tij:

- Se, or burra, në kohën e atij rahmetliut, dilte gruaja qyqevetun, e merrte rrugën prej këtu e deri në Sarandë, por nuk guxonte kush ta prekte me dorë...! Të paktën ai sistem namuzin ta ruante... apo e kam gabim, or Sakip?

Kaloi një copë heshtje dhe u çudita kur Sakipi ia ktheu, ngase ai nuk përzihej asnjëherë në muhabetet e pasagjerëve të tij, vetëm sa tundte kokën papërcaktueshëm dhe i mëshonte timonit.

- Pa ndigjo or mixhë, - ia nisi ai. – Më duket sa tani na hape zavalle...

- Fol pak ma fort, - i tha plaku.

- Për punën e atij namuzit dhe gruas e kam fjalën, - e shtoi zërin shoferi.

- Po, po.

- Më kujtohet njiherë një katundar i joni, - hyri në temë shofer Sakipi.

- Anaj?

- Ky katundari u martue, por nuk i ra gjatë me ndejtë me nusen e re, se e thirrën ushtar. Nejse mo, ky shkoi ushtar, la nusen me nanë e babë, por ditë për ditë në shpi – presion. Vinte Kryesia e Kooperativës dhe u kërkonte vjehrrit e vjehrrës ta qitnin nusen në punë. Kohë fushate... e ke parasysh vetë. Ik e hajde, ik e hajde, herë kryetari, herë përgjegjësi i sektorit, herë brigadieri, herë agronomi, herë Sekretari i Byrosë së Partisë – nuk i lanë rehat. Herëdokur, u lidhën me djalin ushtar dhe ia thanë ku e qysh puna. Dhe djalit atje, në repart, i kishin ardhë letrat e ankimit se nusja nuk i del në punë. Me nji fjalë, edhe atij atje presion. Pa ç'pa ky i shkreti, i merr prindërit në telefon dhe u thotë ta nxjerrin nusen në kooperativë... tek e fundit – si gjithë të tjerat, edhe nusja e tij. Shkurt muhabetit, e nxorën nusen e re në kooperativë dhe ranë rehat, thua ti. Masanej, erdhi fushata e korrjeve. Kooperativistët – të gjithë e mbajmë mend – i ngrinin në mes të natës. Ndër ta, edhe gruan e ushtarit... Çdo natë, pa mbrrijtë ora tre, në derë të madhe vikaste zani i brigadierit:

- Lirie! Oj Lirie!

Ngrehej Liria. Vjehrra i bante trastën e bukës hazër dhe e përcillte deri te dera e madhe me bukën në njërën dorë e me draprin në tjetrën. Aty ia dorëzonte brigadierit dhe të dy largoheshin n'errësirë. Masanaj plaka mbyllte derën e madhe me lloz, kthehej e shtrihej përbri plakut. Kështu, natë për natë, në orën tre ajo përcillte nusen e re me brigadierin, mbyllte derën me ganxhë dhe shtrihej prapë. Njëherë e pyeti plaku:

- Po pse moj plakë e mbyll derën me ganxhë?

- Si pse mor burrë?! Po mos me na hy kush në shpi... me na vjedhë a me na marrë erzin! Pse tjetër?

- Jooo, jo! – iu gjegj plaku. - Derën s'ke pse e mshel mo! Se atë që duhej me e ruejt, ti e nxore vetë dhe ia dorëzove tjetrit. Tani pse e mbyll? Kujt kanë me ia marrë erzin? Mue e ty apo mureve? Pranej, ngrehu e hapi dyert të gjitha, kanatë më kanatë, se s'kemi çfarë me ruejt tjetër...

Rruga e Arbërit nr. 115



Disa mendime rreth librit "Tribuna Qytetare"
të Shpëtim Camit dhe Harallamb Zervës

# Java kulturore në Peshkopi: **Folk, pikturë dhe libra**

Është viti i 21-të që "Oda Dibrane" mbush katër qoshet e saj me grupe kulturore nga bota shqiptare, në këtë anë e në anën tjetër të kufirit "shqiptaro-shqiptar", prerë me sëpatën e ndryshkur të "Londrës-1913" dhe më gjerë.

Këtë vit "Oda Dibrane" kuvendin e saj e nisi në Dibër, Dibër të Madhe, Shehrin e Dibrës siç e quajnë dibranët për ta përcjellë në dy ditët vijuese në Peshkopi.

Risia që veprimtaria kulturore të kapë mbarë Dibrën nisi vitin e kaluar, në përvjetorin e 20-të kur nata e dytë e saj u zhvillua në qendrën historike të trevës për të vijuar këtë vit me natën e parë e mbase në vitet pasardhëse edhe në natën e tretë, dhënien e trofeve fituese.

Paralelisht me "Odën Dibrane-2015", në mjediset e Pallatit të Kulturës të Peshkopisë u hap edhe ekspozita me punimet më të mira të piktorit dibran Zaim Elezi. Mbi 40 punime të këtij piktori të talentuar, mjeshtër i portretit dhe peizazhit u prezantuan për disa ditë me radhë. Te pikturat e Elezit binin në sy ngjyrat e forta të peisazhit, portretet origjinale dhe plot kontraste, sidomos ajo e aktorit të madh, Sulejman Pitarka, por edhe piktura të tjera plot gjallësi si "Dasma Dibrane", "Skënderbeu", ej.

Një nga veprimtaritë e tjera ishte edhe kolonia e artit "Miqtë e Dibrës", organizuar për herë të parë nga Botimet M&B dhe shoqata PAMART,



në përbërje të të cilëve ishin piktorët Zef Shoshi, Mustafa Arapi, Ikbale Kalaja, Leon Çika, Pjetër Marku, Marjana Goxhabelliu, Hamdi Kaci, Zaim Elezi, Ina Elezi, Dritan Boçku etj. Ekspozita në mbyllje të kësaj veprimtarie solli ngjyrat ende të pa thara mbi pamje vjeshtore të Peshkopisë e vendeve për rreth.

Panairi i Librit këtë vit, në edicionin e dytë ishte më i zgjeruar, jo vetëm nga gama e botimeve të të gjitha fushave, por edhe nga seria e veprimtarive. Agron Tufa ishte në shkollën e Sohodollit, vendlindjes së tij në një bisedë të hapur ku u fol për librat, poezine dhe krijimtarinë artistike të tij. Kjo veprimtari u organizua me mbështetjen e World Vision - Peshkopi në bashkëpunim me shkollën. Gjithashtu, një nga veprimtaritë e suksesshme ishte edhe promovimi i librit "Tribuna qytetare" me autor Shpëtim Camin dhe Harallamb Zervën.

I veçantë ishte prezantimi i gazetarit të njohur dibran Abdurahim Ashiku, udhëtimi i tij rreth njëmijë kilometra nga Athina, me gjashtë vëllime të serisë së tij publicistike "Njerëz që i dua" me jetë njerëzish në mërgim, midis të cilëve edhe shumë dibranë, si dhe i filmit dokumentar "Vera-mësuesja e dy ishujve" një bashkëpunim i frytshëm me operatorin Arian Melonashi, bashkëpunim i cili hedh dritë mbi përkushtimin atdhetar të mësueses Vera Shkurti e cila ka mbledhë fëmijët e mërgimtarëve shqiptarë dhe u mëson atyre të shkruajnë lexojnë dhe këndojnë shqip në dy ishuj, atë të Tinosit dhe të Sirosit në hapësirën e gjerë detare të Detit Egje, pa asnjë shpërblim dhe pa mbështetje ligjore nga shteti shqiptar. Për koloninë e piktorëve dibranë, numrin e ardhshëm do të lexoni një reportazh të posaçëm, ndërsa këtë numër po sjellim dy recensa për botimet e Abdurahim Ashikut dhe Shpëtim Camit.

*Redaksia*

# "Tribuna Qytetare" - një mundësi komunikimi me qytetarët

*Nga* **HYSEN UKA**

Libri "Tribuna qytetare" është një mundësi më shumë komunikimi. Libri në themel, qëllim kryesor ka komunikimin, komunikimin njerëzor midis qytetarëve dhe të zgjedhurve prej tyre. Ky është një komunikim krejt i veçantë në llojin e vet, një komunikim i zgjedhur me vullnetin e qytetarëve dhe në provën e vlerësimin e tyre të vazhdueshëm.

Qytetari i informuar është qytetar i lirë. Ky është motiv që ka udhëhequr në veprimtarinë e tij ish kryetarin e Njësisë bashkiake Nr.1, zotin Shpëtim Cami dhe bashkëpunëtorët e tij. Dhe për të realizuar këtë parim themelor në ushtrimin e një përgjegjësie publike, kushti kryesor mbetet transparenca, të jesh i hapur e në komunikim të vazhdueshëm me votuesit/qytetarët. Nga të qenit i hapur e transparent para qytetarëve kushtëzohet edhe cilësia e llogaridhënies, llogaridhënie reale, përmes së cilës qytetarët kanë mundësinë të gjykojnë e të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje e në vizionimin e të ardhmes së tyre.

Dhe misioni i "Tribunës Qytetare" është pikërisht ky, të krijojë hapësirat e nevojshme për qytetarët, për ata që do të qeverisin, që të mund të informohen e të gjykojnë drejtë e të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje. Autorët e shohin detyrimin për informim të qytetarëve si një "detyrim ligjor dhe përgjegjësi", pjesë të detyrës. Libri është një komunikim përtej sportelit të zyrës së pritjes së qytetarëve, të cilët kjo tribunë e informimit shpërthen…

Shpëtim Cami karakterizohet nga një aftësi e veçantë, e cila është edhe një vlerë e cilësi që duhet të ketë çdo drejtues publik, aftësinë për të dëgjuar me respekt e vëmendje maksimale e qetësi, dhe mbajtja e shënimeve ... Ai ka zhvilluar edhe aftësinë e të shkruarit politik përmes sprovave, artikujve dhe punimeve e botimeve të shumë librave. Kultura e gjuhës është pjesë e formimit intelektual të çdo drejtuesi të punëve publike… Kultura e informimit, cilësia e dhe fuqia e komunikimit varet edhe nga formimi e kultura e gjuhës së shkruar…

Vendi që zë në komunikimin me publikun kultura e gjuhës… Komunikimi teknologjik nuk mund të zëvendësojë komunikimin njerëzor. Teknologjia është "produkt i mendjes njerëzore" dhe në shërbim të tij… Pikërisht këtë na mëson përmes rreshtave të tij ky libër, "Tribuna qytetare". Komunikimin e sinqertë e qëllimmirë njerëzor ndaj qytetarëve… Jo të gjithë qytetarët janë të zotët të përdorin teknologjinë. Në libër janë sistemuar e vijnë të qarta të gjitha problemat dhe tematikat e veprimtarisë e funksionimit të këshillit bashkiak, e drejta për arsim, shëndetësisë, ndihmë ekonomike, treguesit e fëmijëve, komunikim me ligjin, të drejtën për mbrojtje sociale…


Shpëtim Cami sjell përmes këtij libri një praktikë reale të komunikimit me qytetarët e votuesit e tij, nuk është një trill lënda e këtij libri, por një praktikë e përditshme e funksionimit




**Shpëtim Cami sjell përmes këtij libri një praktikë reale të komunikimit me qytetarët e votuesit e tij, nuk është një trill lënda e këtij libri, por një praktikë e përditshme e funksionimit të pushtetit dhe administratës, njësi të qeverisjes vendore në një vend demokratik.**

të pushtetit dhe administratës, njësi të qeverisjes vendore në një vend demokratik.

"Tribuna Qytetare" është libri me vlera e shembuj praktikë për të gjithë ata që kanë marrë përsipër barrën e drejtimit dhe të administrimit të jetës publike përmes institucioneve demokratike. Bëhet fjalë për një model të lavdëruar se si duhet të funksionojë në nivel vendor qeverisja dhe posaçërisht si duhet të komunikohet me publikun për të qenë të hapur e për bërë publikun pjesëmarrës në vendimmarrje.



promovim

Rilindësit e Kohës Sonë janë ata që duan rilindjen e vërtetë, që duan ringjalljen e burrave të mëdhenj, të mesazheve të tyreRilindësit e Kohës Sonë janë ata burra të zgjuar e të përkushtuar që duan integrimin e Shqipërisë, por një integrim me identitet dhe me dinjitet.

# Abdurahim Ashiku në "Njerëz që i dua"

*Nga* **BUJAR KAROSHI**




**Abdurahim Ashiku vjen në Odën Dibrane me 6 libra të serisë "Njerëz që i dua" dhe me filmin dokumentar të suksesshëm "Vera-mësuese në dy ishuj të Egjeut", një histori frymëzuese për edukimin e fëmijëve të shqiptarëve në emigracion**

Abdurahim Ashiku lindi, siç thotë vetë në vëllimin e parë të serisë publicistike "Njerëz që i dua", *"...Pesë ditë para Ditës së Verës për tu regjistruar pesë ditë pas Shëngjergjit, më 11 maj të pranverës 1941..." Lindi në fshatin Brezhdan-Zdojan, më i madhi fshat në Dibër, fshat, që siç thotë..."Ka në sfond Drinin në tallazet e të cilit mësova notin, ka një fushë të madhe dhe një radhë kodrash, ka një perëndim të mrekullueshëm kur dielli fshihet pas Runjës e Gjagjishtit, për t'i ndalë pak rrezet mbi gjelbërimin dhe kaltërsinë e liqeneve të Lurës..."*

"Pasi mbarova katër klasë të fillores, vazhdon, u "rashë këmbëve" dhe shkova në shkollën shtatëvjeçare të Peshkopisë, duke bërë çdo ditë 10-12 kilometra rrugë. Mësoja nën dritën e kandilit dhe më vonë të llambës me vajguri. Drita elektrike në fshatin tim erdhi në vjeshtën e vitit 1955 kur unë isha nisur rrugës së madhe të jetës.

Dy vjet në Shkollën Ushtarake "Skënderbeg" do të vijonin me tre vite në Teknikumin Bujqësor të Fierit, ku diplomohet agronom i mesëm...

Pasi punoi dy vjet në Peshkopi, ndër të tjera edhe në piketimin e blloqeve të mëdhenj frutorë dhe të vreshtave të njohura të Dibrës, në shtator të vitit 1961 nisi studimet në Institutin e Lartës Shtetëror të Bujqësisë në Tiranë për t'i mbaruar ato më 16 shkurt 1966.

E nisi punën, tashmë si specialist i lartë, atje ku e "kishte lënë", në shijimin e fryteve të punës së pesë viteve të shkuara e në piketimin e mbjelljen e blloqeve të rinj, blloqe që i dhanë bukuri dhe begati Dibrës.

Pesë vjet pedagog në Shkollën e Mesme Bujqësore "Nazmi Rushiti" të Peshkopisë do të ngjiznin në shpirtin e tij dashurinë për arsimin, dashuri që tashmë, me martesën me mësuesen Natasha Ashiku, do të bëhej e familjes. Abdurahim Ashiku u lidh me shtypin nëpërmjet një reportazhi në gazetën "Sporti popullor" në një ekskursion me bashkënxënës të bujqësores së Fierit në truallin e Apolonisë së lashtë në pranverën e vitit 1957, për të vazhduar më pas në vitet e shkollës së mesme dhe asaj të lartë, me "Zërin e Rinisë"... Dashuria e Ashikut për shtypin u shndërrua në profesion në vitin 1974, kur u emërua korrespondent i Agjencisë Telegrafike Shqiptare për Dibrën dhe Matin, për të vazhduar më tej me gazetën "Ushtima e maleve" dhe së fundi me "Zërin e Popullit".

U largua nga Shqipëria më 21 korrik të vitit 1996, për t'i shpëtuar dhunës dhe likuidimit fizik ushtruar nga segmente ekstreme të kohës...

*"Gjatë këtyre viteve, shkruan në "Një fletë nga jeta ime", kam rritur lule në kopshtet greke, pa i lënë mënjanë "lulet" e bukura të publicistikës. Në fillim iu përkushtova gazetës "Vëllazërimi", gazetë e cila doli në qarkullim në Athinë kur në Shqipëri ishin mbyllur të gjitha gazetat, pasojë e politikës së vitit të mbrapshtë 1997, për të vazhduar më tej me "Rilindja XXI", "E vërteta", "Emigranti", "Gazeta e Athinës, "Plus Gazeta e Athinës","Fryma e re" etj., gjithnjë pa shpërblim...*

Emigracioni, jeta dhe puna e emigrantit hapi një dritare të madhe në publicistikën e Ashikut, dritare nëpërmjet të cilës morën dritë gjashtë libra me rreth 2100 faqe: "Njerëz që i dua" – 2007, "Rilindësit e kohës sonë" – 2008, "Shkolla shqiptare e Athinës" – 2009, "Po Dibrës! Jo Skavicës" – 2010, "Rrëfimet e komshiut" – 2011, "Shkolla shqipe e Selanikut"- 2014

Librat janë botuar me pensionin e tij dhe të bashkëshortes, Natasha Ashiku.

Në tre nga librat e Ashikut, si një dashuri e madhe, si njerëz që i do dhe i respekton me shpirt, vijnë mësuesit mërgimtarë, në Greqi por edhe në mbarë Evropën, në intervista e në portrete.

Me një vështrim të thjeshtë numërohen 67 mësues e mësuese, në rreth njëmijë faqe...

*"Është gjë e bukur të jesh mësues, shkruan Ashiku në kopertinën e fundit të librit "Rilindësit e kohës sonë", të shohësh si lëshojnë shtat fëmijët e thithin dituri, si rriten e ngjiten, si lulëzojnë e piqen... E kam pasur këtë fat vetëm për pesë vjet...*

*Më mungon të qenit mësues. Më ngushëllon fakti se edhe sot kur udhëtoj drejt të tetëdhjetave të jetës, e ndjej veten nxënës, njeri të lidhur fort me Mësuesen e Madhe-Jeta Njerëzore.*

*Isha në mëdyshje për titullin. Disa herë e shkrova dhe e shova. Më në fund më erdhi në ndihmë DritëroAgolli i madh i letrave shqipe kur në një bisedë më 9 prill 2009 më tha...*

*"...Këtë anë rilindëse të emigrantëve të hershëm e kanë shfrytëzuar, apo e kanë përvetësuar emigrantët e sotshëm duke vazhduar kohën e Rilindësve që punojnë për mëmëdhenë".*

*"Profesor i nderuar!",* i shkruan Gjovalin Lumaj nga Vermoshi, nxënës i mësuesit Abdurahim Ashiku në Shkollën e Mesme Bujqësore "Nazmi Rushiti" në Peshkopi, mërgimtar në Miçigan të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. *"Festën ta kam uruar, por më zgjoi emocione titulli aq domethënës i publicistikës suaj, "Rilindësit e Kohës Sonë"... Kam besim se domethënia e librit është ajo që mendoj unë edhe pa e lexuar.*

*Rilindësit e Kohës Sonë janë ata që duan rilindjen e vërtetë, që duan ringjalljen e burrave të mëdhenj, të mesazheve të tyre Rilindësit e Kohës Sonë janë ata burra të zgjuar e të përkushtuar që duan integrimin e Shqipërisë, por një integrim me identitet dhe me dinjitet. Rilindësit e Kohës Sonë janë edhe ata që hapin shkolla Shqipe në emigracion. Nderim e respekt mësuesve!"*

Vepra në gjashtë vëllime e publicistit Ashiku ka një titull të përbashkët, "NJERËZ QË I DUA", një titull domethënës.

*"Njeriun duhet ta duash, thotë Ai, para se të marrësh penën e të shkruash."*

Dashurinë e tij për njerëzit ai e ka shpërndarë në 341 personazhe, heronj, siç i quan Ai, njerëz të thjeshtë dhe të dëgjuar.

*"E s'kishte si mos ishin pjesë e librit, shkruan redaktorja e librit "Rrëfimet e Komshiut" Miranda Goleci, edhe nënat shqiptare, këta gra që kanë marrë rrugën e kurbetit, që çohen që me natë, vrapojnë sa në trena në autobusë e taksi. Punojnë në punët më të vështira e të pështira... Dhe kthehen mbrëmjeve pranë familjeve deri në këputje krahësh. Kthehen jo për t'u shtrirë e pushuar, por për të rinisur punën në një turn tjetër, turnin e përgatitjes së drekës e darkës, larjen e shtëpisë e larjen e hekurosjen e rrobave...*

E autori bën pyetjen:

*"Po gruas emigrante, që e ka trefish të këputur shpinën, si duhet t'i thonë"?* (Rrëfimet e komshiut, f. 331)

*"Shpinë këputura e punë pa dukura"*- është përgjigja e tij, përgjigje që e ka dhënë në portretet e 74 grave e vajzave në 346 faqe të të gjashtë librave të tij. Një nëntitull që Ai e ruan për një libër të veçantë për këtë qenie njerëzore që shuhet si qiriri për të mbajt jetën në mërgimin e lodhshëm shqiptar.

Fotografia është një pjesë e veçantë e jetës së tij. *"Me Aparatin fotografik, thotë Ai, kam udhëtuar qysh në shkollën e mesme. E kam pas "gjymtyrë të pestë të trupit". Ato mijëra negativë që i kam me vete në Athinë e që kapin një periudhë 50 vjeçare, një ditë do t'i kaloj në kompjuter. Ato janë pjesë e jetës sime, një prej dashurive të mia"...*

E këtë dashuri të tij e ka vazhduar gjatë nëntëmbëdhjetë viteve në Greqi. Atë e sheh kudo me aparatin e tij të vogël fotografik, si një "gjymtyrë" të tij duke mbledhë dhe përcjellë vlera të punës e të jetës së mërgimtarëve shqiptarë kudo që ka shkuar.

Një dashuri të jetës së tij, telereportazhin e udhëtimeve nëpër malet e Dibrës me operatorë të mëdhenj të ekranit të vogël, e ka zbritur në ultësirat e Detit Egje në një filmi dokumentar me Arian Melonashin, kushtuar mësueses Vera Shkurti që ka mbledhë fëmijët dhe u mëson gjuhën e bukur shqipe në dy ishuj, në atë të Tinosit dhe të Sirosit.



Nëse Rruga e Arbërit bëhet, askush nuk na e var më, pasi duhet të shkojmë dhe të kthehemi brenda ditës me duar në xhepa, pa patate, pa mollë, pa arra, pa gjizë, pa...

# Dibra ka nevojë për të rinjtë!



Foto © Neki Feta

*Nga* **EDISON BALLA**

Për rininë është shkruar shumë, është diskutuar shumë, janë hartuar platforma ndër vite me qëllime specifike grupore ose individuale, por ajo që na ofron realiteti ne sot është një tablo komplet ndryshe nga ajo që është premtuar.

Sot të rinjtë në Dibër, duke folur edhe në emrin tim personal, jemi lodhur dhe zhgënjyer njëkohësisht nga ajo që na është premtuar dhe nga ajo që na serviret si realitet. Arritja dhe realizimi i këtyre premtimeve duket akoma që është shumë larg, pasi "nga e thëna në të bërë është në mes një mal i tërë".

Shqipëria në tërësi, dhe Dibra në veçanti, ka sot një kapital human të rinjsh shumë solid, që shumë vende do e kishin zili. Ne jemi të ndërgjegjshëm sesi vendet e Bashkimit Europian i trajtojnë të rinjtë, duke i nxitur me politika sociale afatgjata për ti shndërruar në "lokomotiva drejtuese" për shtetet e tyre.

Çfarë ofron Dibra dhe pushteti i saj lokal për ne, të rinjtë?

Sipas të dhënave zyrtare të Institutit të Statistikave, aktualisht, në qarkun e Dibrës 83.5% e të punësuarve vijnë nga sektori privat, ndërkohë që nga ana tjetër Dibra mbetet qarku që ka numrin më të vogël në rang kombëtar të "ndërmarrjeve ekonomike". Dibra është gjithashtu qarku me numrin më të lartë të familjeve që marrin ndihmë ekonomike e ndjekur nga Shkodra.

Duke dashur që të evitoj sadopak këto statistika kaq të zymta dhe dramatike, këshilla ime për të rinjtë e Dibrës është kjo: le të lëmë pas "djathin e vjetër" dhe të vihemi në kërkim të "djathit të ri". Le të lëmë mënjanë ankesat, premtimet boshe, tabutë tradicionale dhe të guxojmë të bëjmë më të mirën për veten, familjen dhe Dibrën tonë. Nuk mund të presësh asgjë nga të njëjtët persona dhe nga i njëjti shtet i cili për 24 vite tranzicion, nuk ka bërë as më pak e as më shumë, përveçse ka shuar çdo shpresë, ka pllakosur çdo buzëqeshje, ka ndërprerë në mes çdo ëndërr dhe ka demoralizuar çdo të ri. Në të tilla rrethana dhe me një analizë të thjeshtë logjike ne "të rinjve" sot na paraqiten përpara dy alternativa:

-E para, të rrimë duarkryq dhe të pranojmë me vetëdije të mbetemi pjesë e kësaj "vorbulle mjerane" që po na kthen çdo ditë e më shumë në viktima të një sistemi gjakpirës;

-E dyta, të mundohemi dhe të guxojmë të veprojmë "me mish e me shpirt" deri në pikën e fundit të fuqisë tonë, për ta ndryshuar këtë gjendje kaq kritike.

Ne e dimë shumë mirë që nëse duam të ndryshojmë mënyrën se si një person e sheh një rrethanë apo dukuri, duhet që së pari të ndryshojmë qëndrimin tonë kundrejt asaj dukurie, pasi nuk mund ti kërkojmë dikujt që të bëjë diçka ndryshe kur ne vetë vazhdojmë të bëjmë të njëjtat gjëra, apo më keq, bëjmë gjërat e gabuara.

Teksa shkruaj këto rreshta më vjen menjëherë në mendje një vepër letrare e titulluar "7 zakonet e njerëzve të suksesshëm" e shkrimtarit amerikan "Stephen R. Covey", autor i disa best-sellerave. Kjo vepër letrare fliste për "forcën e ndryshimit" dhe në qendër të saj kishte një person vizionar, i cili aspironte të bëhej lider. Ai dëshironte ta fillonte rrugën e gjatë të ndryshimit nga shteti i tij, por kuptoi se divergjencat dhe problemet makro ishin shumë më të komplikuara seç ai mendonte dhe hoqi dorë, për tu përqendruar më pas tek qyteti i tij i lindjes.

Brenda pak kohësh hoqi dorë edhe nga kjo sfidë, pasi mendoi se ishte shumë për të, tanimë forcat e tij për të ndryshuar u përqendruan në lagjen e tij, por konfliktet dhe mospërshtatja bënë që shumë shpejt ai të tërhiqej edhe nga kjo, për tu marrë dhe për të ndryshuar gjënë më të rëndësishme ne jetën e tij, pra familjen. E dini çfarë? As kësaj nuk ia arriti dot, pavarësisht dëshirës dhe vullnetit. Por a e dini pse nuk ia arriti? Sepse ky person, duke dashur që të ndryshonte të tjerët, kishte harruar të merrej me veten e tij, pra kishte harruar të ndryshonte qëndrimin e vet. Ky person kuptoi që nëse dëshironte të ndryshonte dikë, duhej që së pari të merrej me veten, të ndryshonte, sepse vetëm atëherë ai mund të aspironte të ndryshonte familjen, lagjen, qytetin dhe më pas shtetin e tij.

Dibra është një zonë, e cila historikisht është karakterizuar nga pasuria humane dhe si e tillë ka nxjerrë intelektualë me përmasa kombëtare. Unë besoj se Dibra jonë sot ka një brez të ri me aspirata dhe solide, e aftë të jenë lokomotivë drejtuese në rang qendror dhe lokal, të aftë të sjellin ndryshimin e munguar ndër vite dhe të përgatitur më shumë se kurrë të "thyejnë akujt" dhe të "shembin tabujt" për ta drejtuar kështu Dibrën kah emancipimi dhe zhvillimit shoqëror e ekonomik.

Unë nuk mendoj që vetëm të pasurit mund ta drejtojnë këtë vend. Unë nuk mendoj që vetëm të "zgjedhurit e pushtetit" mund të na udhëheqin. Unë nuk mendoj gjithashtu që vetëm klientelistët dhe populistët mund ta "bëjnë" këtë vend. Jo, unë nuk mendoj kështu, madje nuk mendoj as se Dibra nuk mund të bëhet siç shumë mendojnë. Dibra ime, Dibra juaj, Dibra jonë ka nevojë për të rinj me aspirata dhe të ndershëm, të kulturuar e të thjeshtë, por mbi të gjitha, Dibra ka nevojë për të rinj që e duan me zemër atë, për të rinj që janë të gatshëm të bëjnë gjithçka për ta ngritur në piedestal emrin e artë të Dibrës.

Dibra jonë ka nevojë për ne, për të rinjtë... Dhe për ti dhënë përgjigje tezës time që ngrita në krye, them me bindje se "Po", ne jemi brezi i duhur për të sjellë ndryshimet e shumëpritura për Dibrën. Është koha që ne të veprojmë për të sjellë ndryshimet e munguara.

# Unë nuk dua që të bëhet Rruga e Arbrit

*Nga* **SEFULLA KATA**

Ka vite që flitet për ndërtimin e Rrugës së Arbrit, aq shumë vite sa ka edhe vetë shteti shqiptar i pas nëntëdhjetës. Unë e mbaj mend si ka filluar kjo përrallë, pasi kam qenë dëshmitar në sheshin "X" kur pushtetari "Y" i kërkonte kandidatit për deputet "Z" që të hidhte gurin e parë të inaugurimit, si dëshmi se ndërtimi i rrugës sapo kishte filluar. Mbaj mend se sa shumë u skuq kandidati "Z" përpara gjithë atij publiku të mbledhur aty ngaqë nuk mundi të gjente asnjë gur të vetëm në sheshin e shtruar me asfalt.

Ca më vonë një tjetër pushtetar, për t'ua mbushur mendjen njerëzve votues se ai e kishte marrë seriozisht ndërtimin e rrugës ndaj dhe ata duhej ta merrnin shumë seriozisht dhënien e votës, u tregua më dinak se pushtetari i parë. Porositi pronarin e një firme ndërtimi rrugësh që të mbushte dy kamionë me zhavorr, të sillte një ekskavator dhe një rul, i tha njërit prej pushtetarëve lokalë që t'i blinte një copë shirit të kuq dhe një palë gërshërë, mblodhi njerëzit diku në hyrje të qytetit dhe pasi zhavorri u shkarkua dhe ekskavatori me rulin bënë punën e tyre, nxori gërshërët dhe preu shiritin e inaugurimit. Po rruga nuk u bë që nuk u bë. Ama një gjë u bë dhe u bë mirë. Votat u dhanë, pushtetet u ndërruan, pushtetarët u gëzuan, kandidati për deputet e mori mandatin pastaj e la dhe harroi se nuk i ishte dhënë asnjëherë fjala në Kuvend që të fliste për Rrugën e Arbrit.

Një tjetër pushtetar, i treti në radhë, për t'ua mbushur mendjen dibranëve se rruga kësaj here do të bëhej me të vërtetë, u tha këtyre të fundit, se ndërtimin e rrugës e kishte marrë përsipër Kina, motra jonë e madhe e dikurshme, ajo që na deshi aq shumë sa na ndërtoi Metalurgjikun e Elbasanit nga tymi helmues i të cilit kanë vdekur dhe vazhdojnë të vdesin ende njerëz. Loja këtë radhë është shumë djallëzore. E zëmë se rruga nuk ndërtohet, kujt mund t'ia hedhësh fajin? Cilit kinez? Apo nuk janë dhe shumë ata! Duke llogaritur se sa pak jemi ne si popull dhe ende nuk e kemi gjetur fajtorin që prej njëzet e pesë vjetësh, hajde ta gjesh në Kinë në mizorinë e një miliard e gjysmë njerëzve.

Kur e pa se pushtetarët e kishin harruar fare premtimin për ndërtimin e rrugës, intelektuali A, ndonëse me banim jashtë atdheut e me pak interes për ndërtimin e kësaj rruge, hartoi një peticion të cilin e nënshkroi i gjithë mileti dhe me të në dorë u paraqit zyrë më zyrë për tua mbushur mendjen shtetarëve tanë që të mos e braktisnin projektin. Argumentet që paraqiste intelektuali në emër të gjithë nënshkruesve të peticionit ishin më se bindës por pikërisht ngaqë ata ishin të tillë, të mëdhenjtë e këtij vendi ose ia mbyllnin derën ose e prisnin dhe i premtonin sa për të larë gojën...

Pas gjithë këtyre, unë tani nuk dua që rruga të ndërtohet. Ky mendim më lindi gjatë udhëtimit tim të fundit për në Dibër. Që para se të nisesha e kisha caktuar jo vetëm itinerarin por dhe orarin e mbërritjes. Dhe mezi prisja të zija vend në ndenjësen e fundit të modifikuar të një furgoni nga ku si dhe shumë e shumë herë të tjera do të kisha mundësi të sodisja dhe shijoja bukuritë e relievit fushor e malor që nuk ka të sosur. Do të kaloja edhe njëherë pesë orë të këndshme udhëtimi me shpejtësi nga 30 deri në 40 km/h. Në fakt gjithë herët e tjera që e kisha bërë këtë rrugë, e kisha marrë me shumë stres jo se rruga ishte e gjatë dhe e lodhshme por sepse trurin ma kishte mpirë ideja se të njëjtin itinerar kur të ndërtohej Rruga e Arbrit do ta përshkoja në më pak se dy orë. Po sikur qoftë larg të ndodhte?! Ku do t'i gjeja unë edhe 2-3 orë të tjera të këndshme, duke soditur malet, fushat, lumenjtë, liqenet?! Ku do ta gjeja muhabetin e këndshëm me fqinjin e ulur ngjitur me mua në korridorin e ngushtë të furgonit mbi stolin e sajuar sa për të shtuar numrin e pasagjerëve?! Po rasti për të kaluar nga Rruga e Kombit a do të më binte më?! Po nëpër qytetin e bukur të Rrëshenit a do kisha më mundësi të kaloja?! Po mes pyjeve të bukura të dushkut që përshkojnë zonën mes Mirditës dhe Matit a do të kaloja më vallë?! Kur më kujtohej shija e pilafit gjysmë të zier që haja në lokalet e Klosit, të përgatitur me ujë përroi dhe Galina Blanca, më vinte të pëlcisja duke menduar se një ditë nuk do ta kisha më këtë mundësi. Nuk do t'i shihja më njerëzit të cilët në ora nëntë të mëngjesit i turren biftekut dhe mishit të pjekur a thua se nuk kanë ngrënë kurrë mish dhe mezi presin tu bjerë rruga nga Klosi. Do të më mungonin jo vetëm pilafi por edhe kosi gjysmë i thartuar, edhe fiqtë, edhe misrat e zier, edhe një gotë raki kumbulle a rrushi e zier në shtëpinë bujare të klosianit. Kur mendoja se një ditë nuk do ta ngjisja më Qafën e bukur të Buallit, duke u përkundur si në djepin e fëmijërisë aty në ndenjësen e fundit të furgonit, se do më mungonte rehatia që ndjejnë veshkat dhe shtylla kurrizore në atë përkundje të pasosur mbi asfaltin gropa-gropa të shtruar këtu e pesëdhjetë vite më parë, më vinte të ulërija. Jo, jo! Nuk dua ta ndërtoni Rrugën e Arbrit. Jemi mirë kështu siç jemi. Mos na e prishni rehatinë. Mos na lini pa miq e të afërm. Ne jemi mësuar të flemë ndonjë natë në Dibër e pastaj të kthehemi të nesërmen me trastat e mbushura me patate, misra, dardha, mish viçi e gjithë farë prodhimesh fshati. Nuk na prish aspak punë fakti që furgonat janë të mbushur me thasë dhe trasta të të gjitha llojeve. Hipim edhe mbi thasë. Mjafton të mos na shkojë rruga kot. Nuk prish punë se furgoni bie erë këmbësh dhe bulmeti, patatesh të prishura, kastravecësh turshi e gjithfarë llojesh të tjera. Nëse rruga bëhet askush nuk na e var më pasi duhet të shkojmë dhe të kthehemi brenda ditës me duar në xhepa, pa patate, pa mollë, pa arra, pa gjizë, pa....

Për arsyet që rendita më sipër e për qindra të tjera që mund t'i rendisni a shtoni vetë, ju lutem mos e ndërtoni Rrugën e Arbrit!

**Për opinione dhe komente mund të na shkruani në adresën: <rrugaearberit@gmail.com>**

OPINIONET DHE KOMENTET E BOTUARA NUK SHPREHIN DOMOSDOSHMËRISHT QËNDRIMIN E REDAKSISË

opinion

Rruga e Arbrit mbetet kauzë e dibranëve të thjeshtë, që e duan këtë rrugë për t'ua shkurtuar distancën me Tiranën, sidomos në këto kohë, ku thuajse një i dyti dibran jeton në kryeqytet.

# **Rruga e Arbrit** *nuk është "firmë kineze"* *dhe* **as ëndërr nacionalistësh!**

*Nga* **DIONIS XHAFA**

Shkrimtari i njohur shqiptar Ernest Koliqi ka shkruar një vepër jashtëzakonisht interesante, e cila ka një fabul që zë vend edhe në realitetin e sotëm. Titullohet "Tregtar flamujsh" dhe flet për dy persona që ishin krejt të kundërt në filozofinë e tyre të të menduarit.

Një prej personave në roman bën kinse sikur është patriot i madh, valëvit flamuj dhe i shet ato, duke përfituar para prej shitjes së tyre, ndërsa tjetri që punon ndershmërisht për Shqipërinë, por nuk e ngre flamurin.

Koliqi në këtë fabul do të tregojë se s'ka rëndësi a e ngre flamurin apo jo, por se sa punë bën ti për hir të përparimit të atdheut, sa i shërben ndershmërisht atij. Mora këtë shembull për ta sjellë në kontekstin e sotëm.

Në fillim të këtij muaji, kreu i të ashtëquajturës partia Aleanca Kuq e Zi, Kreshnik Spahiu mblodhi ca të rinj dibranë me flamuj, cule e lodra për të protestuar lidhur me "Rrugën e Arbrit".

Pse them i ashtëquajturi Kreshnik Spahiu? Sepse ka qenë ky njeri që në zgjedhjet e vitit 2013-të për fatin e mirë të dibranëve dhe të shqiptarëve ka marrë vetëm 0.44 për qind të votave, duke qenë ekuvalente me atë se as vetë Spahiu nuk arriti të marrë mandat deputeti.

Ky një fakt vërtetë për tu duartrokitur. Kjo sepse Kreshnik Spahiu është personi, që më së miri i shkon për shtat shprehja "shkallmojnë shtetin, hiqen si patriotë" apo se nacionalizmi është streha e fundit e horrave.

Spahiu ka qenë nënkryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, numri dy i të bërit ligj në këtë vend, në kohën kur shqiptarëve të ndershëm iu thyheshin brinjët nëpër gjykatat deri kriminale të shtetit tonë dhe kur të fortët nuk pyesnin për ligj e kushtetutë.

Ky njeri fajtor për shkaktimin e plagëve të hapura ndaj atdheut në mënyrën më të turpshme dhe të padenjë ngre lart flamujt kombëtarë, duke keqpërdorur simbolet e shenjta për një shqiptar.

Kreshnik Spahiut i shkon për shtat më së miri edhe thënia se ngjan si gjeli majë plehut me nacionalizmin e tij krejt të marrë, fals dhe pa asnjë lloj lidhje me realitetin e kohës që e jetojmë.

Tani le të dal tek thelbi i arsyes për të cilin po e shkruaj këtë artikull. Kreu i të ashtëquajturëve "kuqezinj" gjen disa kauza më së koti dhe me flamuj në dorë përpiqet tiu mbushë mendjen njerëzve.

Ky është ai njeri që kur humb Shqipëria thotë se e ka fajin qeveria, ndërsa kur fiton Kombëtarja gjen lloj-lloj pretekstesh për të sulmuar qeverinë. Llum. Llum dhe mjerim në gojën e kujt kanë ngelur fjalët "komb, atdhe e flamur".

E, që ta informoj më së miri lexuesin tim të kujdesshëm, Spahiu me megallomaninë e tij, me lodra e cule, me dajre e flamuj si një nacionalist liliput që është, bërtiste në Maqellarë për ndërtimin e "Rrugës së Arbrit".

Ku ishte Kreshnik Spahiu, kur qeveria e kaluar i vuri shkelmin "Rrugës së Arbrit"? Ka qenë numri dy i qeverisë dhe një fjalë të vetme nuk e ka thënë, lërë se ka qenë i përlyer me një pushtet të kalbur në rrënjë.

Personalisht nuk kam si të besoj tek nacionalisti Kreshnik Spahiu, pasi e kam parë që edhe në çështje të tjera flet pa fakte, por në ajër, me një lloj propagande që edhe nazizmi ndoshta do ta kishte zili.

Kreshnik Spahiu në protestën e vet në Maqellarë, as edhe një argument të vetëm që të qëndrojë nuk e tha. Ai është shpërfytyrimi më i madh i vlerave kombëtare, që i ngul thikën atdheut e nga ana tjetër me daulle e flamuj bën sikur i dhimbsen çështjet kombëtare.

Kreshnik Spahiu nuk mund të jetë personi që mund ti besohet një projekt që e ëndërrojnë dibranët, siç është ndërtimi i "Rrugës së Arbrit".

Më së pari ai është njeri politik që kërkon të përfitojë dhe jo civil. Më së dyti ai është i tmerrshëm në vizionin që paraqet për të ndërtuar këtë rrugë.

Më së treti, Spahiu ka një retorikë boshe nacionaliste, sa tragjike aq edhe qesharake për ata që përpiqen ti analizojnë sadopak veprimet dhe thëniet e tij.

### MBI TË RINJTË QË IU BASHKUAN KRESHNIKUT NË PROTESTË

Për fat të keq në këtë protestë sa për zhurmë dhe ku nuk u fol me argumente, por me trumpentime kauzash të mëdha e punësh të vogla, pashë disa të rinj dibranë, bashkëmoshatarë të mi.

Ndoshta ngaqë i tërheq flamuri kombëtar, ndoshta nga padija, më shumë mundësi nga naiviteti, iu bashkuan Kreshnik Spahiut në këtë protestë.

Apeli im për këta të rinj dibranë do të ishte që të përpiqen ti analizojnë mirë disa gjëra përpara se të dalin të protestojnë për një kauzë të caktuar. Sepse dilet në një protestë që e drejton një njeri, i zhytur në të kaluarën në një sistem të kalbur politik dhe që sot është bërë flamurtar i nacionalizmit.

Besoj se dihet se patriotizmi i vërtetë, ai i pastër si kristal nuk qëndron në fjalë, por në veprime karshi vendit.

Nëse nisemi nga historia, heroi ynë kombëtar Gjergj Kastrioti nuk është cilësuar i tillë se ngriti lart flamurin, por se luftoi kundër perandorisë osmane në një kohë që mes shqiptarësh mungonte liria.

Iljaz Pashë Dibra nuk është i njohur nga historia për shkak se tundi dhe shkundi flamuj, por se u bë shtyllë mbrojtëse në "Lidhjen e Prizrenit", përkrah Abdyl Frashërit kur cënohej copëtimi i trojeve shqiptare.

Nazmi Rushidi po ashtu bëri emër sepse luftoi pa kompromis kundër pushtuesit të Shqipërisë më 1944-45, gjersa e burgosën, torturuan dhe në fund e vranë.

Said Najdeni po ashtu është një hoxhë i nderuar, sepse shpërndau dije ndër dibranë.

Pra, secili dibran që ka lënë gjurmët e veta në histori ka luftuar për kauza të drejta, ka dhënë jetën për liri, ka firmosur aktin e lartë të pavarësisë apo është bërë therror kur e ka thirrur detyra e lartë e mbrojtjes së atdheut.

Pra, bashkëmoshatarë, patriotizëm është të punosh ndershmërisht për atdheun dhe jo ti vësh shkelmin e të bësh sikur e do atdheun tënd, duke parë gjithnjë interesin personal siç ka bërë Kreshnik Spahiu.

Nëse punoni ndershmërisht, të punoni me punë të ndershme për atdhe, do t'iu respektojnë në punën tuaj dhe do të shihni se me punë të mirë karshi vendit tuaj nuk do ta keni nevojën as të flamurit dhe as të daulleve të nacionalizmit.

Dua të besoj se bashkëmoshatarët e mi në këtë protestë ishin naivë dhe se do ta mendonin dy herë kur të dilnin sërish të protestonin.

Protesta me kryeorganizator Kreshnik Spahiun u zhvillua shpejt, befas, krejt papritur, pa i thënë ndokujt, pa ndonjë konsultë të gjerë, por me siguri me logjikën "të bëjmë zhurmë sa të mundemi".

Dibranët u treguan edhe këtë herë të zgjuar, teksa nuk dolën në shesh me Spahiun, duke i dhënë mesazhin se llomotitjet nacionaliste të tij nuk zënë vend në Dibër dhe në mesin e dibranëve.

### NUK BESOHEN QEVERITË, POR AS FUNDËRRINAT NACIONALISTE

Megjithë atë që përfaqëson kreu i AK-së Kreshnik Spahiu dhe me një fjalor nacionalist që e kalon çdo cak, ai e ka një pikë të vetme që sadopak duhet lëvduar.

Spahiu ka dalë hapur kundër partive që janë në pushtet dhe atyre që ishin në pushtet dhe vota e shqiptarëve i mënjanoi.

Pra, kauza e ndërtimit të "Rrugës së Arbrit" nuk mund ti besohet Kreshnik Spahiut, por gjithnjë ka dyshime të mëdha edhe nga ana e qeverive që vijnë njëra pas tjetrës në pushtet, "të majta e të djathta".

"Rruga e Arbrit" është tradhtuar si kauzë jo pak herë qysh në fillime të ardhjes së demokracisë në vend. Besimi tek qeveria aktuale për të bërë vepra të mirë në interes të komunitetit ishte sidomos i madh fill pas fitores së thellë të "të majtës" së bashkuar më 2013.

Qeveria aktuale e Tiranës ka premtuar se do ta çojë deri në fund premtimin për ndërtimin e "Rrugës së Arbrit", por se edhe ndaj këtij premtimi duhet një skepticizëm tepër i madh, gjerisa rruga të shihet krejtësisht e përfunduar. Sesa punë do të bëjë kjo qeveri për ta ndërtuar "Rrugën e Arbrit" pritet të shihet në të ardhmen. Premtimin le tia lëmë kohës. Ajo është treguesja më e mirë e së vërtetës.

### RRUGA E ARBRIT, KAUZË CIVILE E DIBRANËVE

Për "Rrugën e Arbrit" vështirë se iu rreh mendja qoftë "të majtëve", qoftë "të djathtëve" në Tiranë, ku kolltuku i ngrohtë me pak punë e shumë para të bën të largohesh nga hallet e njerëzisë.

Politikanët tanë, të ndarë ca këtej dhe ca andej vështirë se i mbajnë premtimet në fushatë, pasi mund të cilësohen ashtu siç i quan Dritëro Agolli, "majtas dreqër, djathtas djaj". Kështu, gjasat janë që edhe premtimi për ta ndërtuar "Rrugën e Arbrit" mund të rezultojë premtin fals.

Politika në Tiranë do të besohej vetëm nëse ajo zbret në nivelin e shoqërisë civile, e problemeve reale të njerëzve që jetojnë në Shqipëri, por dhe më gjerë në trojet shqiptare.

Në kushtet aktuale, "Rruga e Arbrit" mbetet kauzë e dibranëve të thjeshtë që e duan këtë rrugë, për tua shkurtuar distancën me Tiranën, sidomos në këto kohë ku thuajse një i dyti dibran jeton në kryeqytet.

Ideali më i pastër i dibranëve realizohet vetëm duke ua ndërtuar rrugën e tyre në mënyrë të rregullt dhe ata taksa që derdhen në ndërtim të asfaltit të jenë taksa të hedhura ndershmërisht dhe jo duke grabitur taksat qytetare për interesa personale pushtetarësh.

## Shpresa është e vetmja rrugëzgjidhje që nuk ka vdekur akoma

*Nga* **SAMET ZAGRADI**

Të nisesh nga kryeqendra e Shqipërisë, Tirana, për të shkuar në lindje do të thotë shumë. Të nisesh po ashtu nga qyteti i Peshkopisë për në kryeqytet duhet të jesh i përgatitur mirë nga ana shëndetësore, ekonomike, morale, psikologjike e me pas të ndërmarrësh një hap të tillë.

Janë vetëm 170 kilometra për tu përshkruar deri në destinacion. E përkthyer kjo me një autostradë imagjinare përllogaritet që të arrish në Tiranë dhe anasjelltas vetëm për një orë e gjysmë, kohë kjo idealja dhe e pamenduar asnjëherë që do të bëhet realitet.

Ëndërrojnë më tej duke parë se sa afër me të afërmit e tyre do jenë, sa komod, pranë zhvillimit. Por ëndërrimi prishet kur kthesat e pafundme të zgjojnë nga ëndrrat. Orët kalojnë dhe përpara teje shfaqen qindra gropa, e për të mos mjaftuar kjo kthesave nuk po u vjen fundi.

Me një sy të lirë has çdo 5 metra lapidarë që tregojnë në një farë mënyre që kjo rrugë po i ha dibranët ditaditës. Djem të rinj, dhe jo vetëm, përfundojnë çdo ditë në humnerat e pafundme, gjë e cila nuk po e vë re askush. Duke ecur tutje, me një dëshirë që po shkon në kryeqytet, kilometrat vetëm shtohen, e për të mos mjaftuar kjo, kthesat e pafundme të Qafës së Buallit dhe Klosit largojnë me tej Tiranën, e kështu largojnë edhe dëshirën për të shkuar atje.

Shikon orën teksa akrepat pothuajse nuk lëvizin fare e çdo minutë mendon kilometrat që të presin. Për të mos mjaftuar kjo, pikën mbi "i" e vendosin lokalet anës rrugës, ku cilësia e shërbimit bie në kontraditë të fortë me tendencën për të zhvatur çdo hallexhi që i bie rasti të konsumojë diçka aty.

Vitet ikin shpejt,madje më shpejt se ideja e një udhëtimi nga Dibra për në Tiranë dhe jo vetëm. Pavarësisht sakrificave të pafund, asgjë nuk ka ndryshuar e si për ironi të fatit dibranët vazhdojnë të jetojnë ende të izoluar në rrethinën e tyre. Dibranë të tjerë punëtorë, fisnikë nuk janë pajtuar me fatin e tyre, me izolimin në një cep të Shqipërisë, pa asnjë lloj shprese për të jetuar. Janë detyruar të shpërngulen përgjithmonë ...

Vitet kalojnë edhe po e njëjta histori. Qytetarët dibran vazhdojnë ende të ecin në rrugët që nga realiteti duken të ndërtuara miliona vite më parë, pikërisht aty ku edhe dhia e ka problem, sepse edhe ajo mund të ketë frikë nga lartësitë. Mijëra kthesa, male pafund të cilat duken që të gllabërojnë nën rrënjët e tëre duke të marrë dhe frymën.

E mangët, po ashtu si rruga, është edhe situata aspak normale në këtë qytet. Varfëria tashmë e ulur këmbëkryq përforcohet më shumë me faktin e mungesës së një rruge drejt zhvillimit. Djersa e një viti, pa marrë parasysh edhe shpenzimet, hidhët për shkak të mungesës së tregut. Qindra ton patate, mollë, perime janë të destinuara të shiten. E vetmja mënyrë kjo për të mbajtur barkun me bukë, por mungesa e rrugës po ua mohon edhe këtë dibranëve...

Realitet i zymtë, ku dëshirën për të udhëtuar komod dhe me një distancë më të shkurtër kohore e sheh akoma me dylbi. Dëshira universale e çdo dibrani mbetet pikërisht ajo që çdo pushtetar ka përfituar për të rrëmbyer votë në këmbim të ndërtimit të Rrugës së Arbrit. Çdo prag zgjedhjesh po i njëjti premtim, po të njëjtat fjalë, që në përbërje të tyre ekziston dozë e tepruar gënjeshtre. Çdo prag zgjedhjesh premtohet shpëtimi i verilindjes dhe afrimi i Europës me afër... Çdo prag zgjedhjesh premtimet janë të njëjtat, por me protagonist të ndryshëm, premtime që fatkeqësisht nuk u bënë asnjëherë realitet. Çdo prag zgjedhjesh bëhet sikur aty po punohet. Çdo centimetër rrugë pasqyrohet në media, çdo tunel, çdo fadromë, e cila numërohet me gishta, filmohet për të bërë një zhurmë sikur po punojmë.

Dibranët, dhe jo vetëm, duhet të besojnë te mrekullitë. E vetmja gjë që na ka mbetur të bëjmë. Duhet të shpresojmë. Fundja, shpresa është e vetmja rrugë zgjidhje që nuk ka vdekur akoma.

**Nën moton "Parandalimi - kurimi më i mirë", për të tretin vit, një grup mjekësh nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës kryejnë një sërë vizitash falas në fshatrat e Dibrës.**




*Nga e majta Hilda Newell, Lira Rajta, Iris Pjeci, Marcus Allen, Mathey Zellars, Ermal Lushi, Sarah Lushi, Rhonda Cmbs,Kendell Klarkston, Endrit Torba*



*Fushë Cidhen - prinderit ne pritje te vizites*

# Mjekë nga Amerika - vizita falas për fëmijët në Dibër

Nën moton "Parandalimi - kurimi më i mirë", për të tretin vit, një grup mjekësh nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës kryejnë një sërë vizitash falas në fshatrat e Dibrës. Këtë vit ky projekt u zhvillua fshatrat Blliçe, Rrenxë, Fushë Çidhën dhe Brest i Sipërm.

"Medical projekt" është një nga veprimtaritë e kishës ungjillore Alfa Omega në Peshkopi në shërbim të komunitetit", - thotë Ermal Lushi, drejtor i projektit. Sipas tij, projekti ka dy hapa kryesorë: së pari evidentimin e fëmijëve të sëmurë të moshës 0-12 vjeç dhe së dyti adresimin për ndjekjen e rasteve në institucionet dhe mjekët përkatës".

Këtë vit projekti është zhvilluar në datat 10-16 tetor 2015 në disa fshatra të komunës së Fushë Çidhnës dhe Kastriotit. Nga ky projekt kanë përfituar mbi 346 fëmijë të kësaj moshe, të cilët janë vizituar nga dy mjekë pediatër amerikanë të ardhur posaçërisht.

Kendell Klarkston është drejtuesi i ekipit, mjek pediatër nga Cox Health Center në Shtetet e Bashkuara. CoxHealth është një spital që nuk ka synime përfitimi. Ata kanë si mision përmirësimin e shëndetit të njerëzve duke shërbyer përmes cilësisë së kujdesit shëndetësor, arsimit dhe hulumtimit. Vizioni i tyre është një shërbim më i mirë për ata që kanë nevojë dhe vlerat e tyre bazohen mbi sigurinë, dhembshurinë, respektin dhe integritetin. CoxHealth ka spitale në disa rajone në Shtetet e Bashkuara, Springfield, Monett dhe Branson si dhe më shumë se 80 klinika. Spitali është themeluar në vitin 1908 dhe në fillim ka pasur vetëm 30 shtretër, ndërsa tani është integruar ndër rrjetin e 100 spitaleve më të mira të kujdesit shëndetësor në Shtetet e Bashkuara.

Klarkson, së bashku me kolegët e tij Willow Springs, Hilda Newell nga Ozarks Medical Center, Rhonda Combs, infermiere dhe Iris Pjeci, mjeke e përgjithshme, zhvilluan vizitat në fshatrat e Dibrës bazuar mbi disa rregulla rigoroze. Në fillim fëmijët kalonin nga stacioni i infermierisë,

**Ermal Lushi: Qëllimi ynë është të sigurojmë ekzaminime shëndetësore falas për fëmijët nën ose baras me moshën 12 vjeç dhe të identifikojmë fëmijët me probleme shëndetësore**

ku u bëhej matja e peshës, gjatësisë, tensionit, oksigjeni dhe më pas kalonin në një vizitë e hollësishme nga mjeku i përgjithshëm.

Më pas atyre u bëhej një test i shikimit dhe në fund, pas konkluzioneve që mjekët arrinin, u jepeshin edhe këshilla për shëndetin, kryesisht që kishin të bënin me sensibilizimin për higjienën, larjen e dhëmbëve, etj.

"Gjithë puna jonë është e mbështetur në punën vullnetare, - thotë Ermali. - Përveç mjekëve dhe infermierëve nga Shtetet e Bashkuara, ne kemi edhe ndihmë nga Drejtoria e Shëndetit Publik në Dibër si dhe vullnetarë nga stafi ynë. Me anë të tyre ne identifikojmë fëmijët që kanë nevojë për një vizitë mjekësore, si dhe vendet ku ata ndodhen. Më pas, ne caktojmë datat dhe vendet ku ata kanë mundësinë të vijnë dhe kështu në një periudhë një javore kryejmë një punë vërtet të lavdërueshme".

Projekti është zhvilluar edhe më herët në Dibër. Tre vjet më parë, në vitin 2012, kanë përfituar fëmijët e fshatrave Katund i Ri, Lishan i Sipërm, Hotesh, Selishtë, Lunar, Erebarë, ndërsa në vitin 2013 projekti u zhvillua në fshatrat Kandërr, Kishavec, Vakuf, Selane, Cetush, Bahute, Zimur, Rabdisht dhe Cerjan. Përfitimet që kanë ardhur nga kjo kanë qenë të mëdha. Mbi 800 fëmijë janë vizituar dhe kanë marrë këshilla mjekësore falas. Ka pasur raste kur janë evidentuar sëmundje të rrezikshme në fillesat e tyre dhe me anë të kurimit të shpejtë ata fëmijë janë sot shëndoshë e mirë, por kemi pasur raste të kurimit të gabuar, ndërprerja e të cilave dhe adresimi te mjeku specialist ka bërë të mundur parandalimin e pasojave për këta pacientë.

"Ardhja e mjekëve nga Shtetet e Bashkuara ka qenë edhe një mundësi e mirë për mjekët këtu, - thotë Ermal Lushi, pasi nga bisedat me ta janë shkëmbyer përvoja të ndryshme, që u kanë ardhur në ndihmë të dyja palëve".

Vizitat nuk bëhen shpejt e shpejt apo për të kaluar radhën. Kujdesi i mjekëve është shumë i madh dhe gjithçka bëhet në mënyrën më të mirë. Në fillim merret anamneza e fëmijëve, e cila konsiston në historinë aktuale ose të kaluar të ndonjë problemi shëndetësor, operacione, historinë e lindjes, medikamentet që janë duke marrë, alergji, historiku familjar, historikun e zhvillimit, statusin shoqëror dhe përmbledhjen e simptomave. Më pas realizohet një ekzaminim fizik i përgjithshëm nga mjekë në prezencën e njërit prej prindërve. Ky ekzaminim përfshin matjen e parametrave vitalë dhe parametrat e rritjes. Më pas bëhen analiza e hematokritit për të zbuluar aneminë. Në fund bëhet analiza e faktorëve historikë, ekzaminimi fizik, duke bërë një përmbledhje për shëndetin e fëmijës dhe diskutohet me prindin. Për ndonjë shqetësim ose rekomandim ata adresohen te infermierja, mjeku në spital ose në burime të tjera mjekësore pranë vendbanimeve të tyre.

Konstatimi i përgjithshëm nga mjekët është se fëmijët kanë problem të kujdesit dentar në masë. Nga të gjithë vizitat vetëm një fëmijë nuk kishte problem dentar dhe ai sepse ishte rritur në Itali.

"Ajo që është shumë e rëndësishme të theksohet, - thotë Ermali, është se qëllimi ynë është të sigurojmë ekzaminime shëndetësore falas për fëmijët nën ose baras me moshën 12 vjeç dhe të identifikojmë fëmijët me probleme shëndetësore, të cilat kërkojnë ndërhyrje. Në synojmë të sigurojmë depistime për sëmundje të zakonshme si anemia, nga mungesa e hekurit në gjak.

Gjithashtu, të koordinojmë kujdesin shëndetësor për fëmijët në risk nga dhënësit e kujdesit lokalë të zonës ku jetojnë dhe të sigurohen për ndjekjen e tyre në lidhje me problemet e identifikuara. Më pas jepen udhëzime paraprake në lidhje me praktikat e shëndetshme si larja e duarve dhe shmangia e dhunës brenda familjes, duhanpirjes dhe përdorimit të substancave të paligjshme."

"Duke punuar së bashku me stafin tonë edhe infermieret e lagjeve, ne kemi mundur të marrim njohuri në lidhje me fëmijët në risk për shkak të historikut të tyre dhe procesit të ekzaminimit. Stafi ynë merr njohuri të paçmueshme nga infermieret dhe mjekët e lagjeve dhe njerëzve të tjerë për sa i përket asaj se çfarë është e nevojshme në këtë komunitet për të promovuar shëndetin dhe për të shërbyer si bazë për vizita të tjera në të ardhmen", - thekson Sarah Pringle Lushi, misionare pranë kishës Alfa Omega në Peshkopi. Sara tani ka zgjedhur Peshkopinë të jetojë, jo vetëm përkrah Ermalit, por edhe në shërbim të komunitetit. Ajo thekson se "shpresojmë që ky proces do të çojë në një përmirësim të shëndetit të fëmijëve në Peshkopi si dhe të vazhdojë edhe vitet e ardhshme".

Sarah thotë se gjatë punës në terren mjekët e ardhur nga Amerika mbetën shumë të befasuar edhe nga mikpritja. Pavarësisht se mjekët kishin një punë intensive, ata patën mundësi të shihnin qartë interesimin e lartë të banorëve që prisnin në radhë dhe insistonin për një vizitë tek mjeku.

Alfa Omega është një organizatë e krishterë me qendër në Peshkopi, e cila vazhdimisht është marrë me projekte humanitare në terren. Ajo ka ndihmuar në pajisjen me mjete të domosdoshme disa shkolla në Dibër, si në Limjan, Erebarë, Cetush, Gjuras si dhe pajisjen e disa qendrave shëndetësore me pajisje mjekësore.

BUJAR KAROSHI



*Doktor Kendell Klarston duke vizituar një djalë në Blliçe.*

**"Parandalimi - kurimi më i mirë" është motoja e projektit të Kishës Ungjillore Alfa Omega që ka nisur të realizohet në vitin 2012. Mbi 1000 fëmijë janë vizituar falas dhe kanë marrë këshilla për shëndetin në mënyrë të drejtpërdrejtë në mbi 20 fshatra.**



*Doktoresha Hilda Newell duke vizituar një fëmijë gjatë javës së projektit.*

cyan magenta yellow black

vendlindje

# Tërnova kjo magji malli e bjeshkëve



**Tërnova ka qenë një vatër e zjarrtë e patriotizmit dibran dhe krenohet me heronjtë e vet, bijtë e saj më të mirë që nuk kursyen për atdheun gjënë më të shtrenjtë, jetën... ne dhe brezat që do të vijnë përkulen me respekt para veprës heroike dhe sakrificave të dëshmorëve, Fejzulla Gjika, Halil Hasa e Gjeladin Murati...**

*Nga* **HALIL TEODORI**

Rrugës duke u ngjitur nga Fushë Bulqizë, përmes një shtegu gjarpërues, shfaqet përnjëherë, përmbas shpinës së malit, një pamje që të magjeps me mistikën e vet. Në këtë tatëpjetë që shigjeton përmes shtegut që ka arritur të çajë shpatullat shkëmbore të malit, ku në të majtë ngrihet maja e Kozjakut dhe në anën e djathtë, lartësitë e Liqenit të Zi, është e pamundur mos me e pranuar një gjendje hutimi që të pushton, një tronditje e brendshme që të përkund si gjethe. Udhëtimi nëpër re i shpatit, rreket me ngjasuar me një udhëtimi si nëpër ëndrra. Rendim me ëndjen e shastisjes me përla gjithçka panorama e thekshme e këtyre maleve ngulmon të tregojë në epjen e vet, që shihen për nga qielli. Majëmalesh të formësuar përmes një procesi të kahershëm e të pandalshëm eroziv, nguten me shpërfaq atë që me kujdesin e paepur ka mundur me ndërtuar koha, në përleshjen e vet me shiun, borën, akullin dhe erën. Rendim për me arrit sa më shpejtë të jetë e mundur, ku ja që beh në kraharorin e këtij mali, Fusha e gjerë e Zerqanit dhe Vorret e Vrame. Një peizazh marramendës që veç ata që kanë patur fatin ta kanë mund me kap me sy e me fisku me admirim pamje të shumëllojshme që kjo panaromë e tregon e me u kreh ne krahët e një pasioni duhitës.

Nëpër gojtarë me namë është çapit mbamëndja e këtyre lartësive të natyrës kaq të bukur shqiptare. Ku dëshira për zotërim për të arritur sa më parë në destinacion, është një kandjë e secilit që ka marrë rrugën drejt në anën tjetër të malit. Të shastisur nga pamja, kredhur nëpër udhëpërshkrues të ndryshëm. Megjithëse, deri më sot nuk ka një histori që flet e të tregon gjithçka që ka ndodhur mbas këtyre maleve, nëpër rrëfime është përjetësuar gjithçka magjike e zonës, ku asgjë nuk ka mbetur e pa thënë dhe ku gjithçka është përkundur në djepin e legjendës dhe kushtimit**.**

Pozita gjeografike e Ternovës dhe zonës përreth e kumton atë në pjesën qendrore të Shqipërisë veriore, me territor që shtrihet përgjatë krahut të majtë të Lumit të Okshtunit, që nga Zerqani pothuajse në Verilindje, Kaptina e Martaneshit në Perëndim. Jo më shumë se njëzet njezet e pese kilometra larg nga Bulqiza.

Jeta në këto anë rrëshqet tinëzisht përmes ngutjeve të banorëve për të lëvizur drejt Vorreve të Vrame dhe për të arritur në qendër të komunës në Zerqan, Bulqizë dhe më pas drejt Tiranës, ku pothuajse tetëdhjetë për qind e popullsisë ka lëvizur që nga vitet 1990 si rrezultat e ndryshimeve të provokuara demografike.

Ternova ka një minierë që e merr emrin nga vetë fshati "Miniera e Ternovës". Dhe ujërat që mblidhen nga dy lumenjtë, ai i Okshtunit dhe i Ternovës, ngrihet një hidrocentral për prodhim energjisë elektrike. Rruga kalon nga Bulqiza në Vorre te Vrame, deri në fshat dhe një tjetër rrugë e asfaltuar kalon nga Strikçani, drejt në Smollik, Ternovë e Vogël, Okshtun e deri për tu lidhur me Sebishtin drejt qafë Studën. Dhe nga lashtësia mban emrin "Fshati i Sharrtarëve" ku në Dabrellë shumë vite të shkuara, që i takojnë shekullit të kaluar dhe më herët, ka qenë e ngritur një punishte për prodhim dërrasash. Ndërsa vetë fshati është mbajtur me blegtori që siguronin pothuajse më shumë se 70% të të ardhurave të banorëve. Pjesa tjetër e kamjes ekonomike vinte nga bujqësia, e cila kultivon grurë, misër, thekër, patate dhe pothuajse të gjitha llojet e frutave si molla, arra, gështenja, rrush, mushmolla, thana, etj. përjashtuar agrumet si dhe të gjitha llojet e zarzavateve.

Deri në vitin 1990 fshati ka pasur mbi 600 shtëpi, të ndërtuara këto me gurë dhe të mbuluara me tjegulla, diku-diku dhe me rrasa guri. Traditë e pasuar dhe pasuruar ndër breza. Pjesë e zonë është dhe Ternova e Vogël me rreth 40 shtëpi dhe fshati Smollik me rreth 70 shtëpi deri në vitin 1990. Gjithçka që e pështkon këtë dëshirim përjetues është malli i përzier me një ëndje nostalgjie që gurron në shtatin dhe shpirtin e gjithkujt që prej këtyre vendeve që i ka bekuar vetë Zoti, ka filluar jetën, ka hedhur hapin e parë, ka shqipëruar fjalën e parë, është magjepsur prej bëmave dhe gojëdhënave.

Udhëtimi përnga "Vorret e Vrame", padyshim është një kahje për ta përshkuar si në rrugëtim i përshtatshëm, por gjithashtu një mundësi për të depërtuar brenda kësaj magjie që shfaqet e bollshme dhe krahëhapur, e cila sa vjen e të përpin brenda vetes, si në një joshje dehëse, duke të davaritur çdo ndjenjë frike që ndjellin tatëpjetat. Ndërsa e përshkon këtë zvarranik mitik, që si një kapilar ushqen me jetë krejkah ku shkel, të ndërmendet histori dhe dëgjesa të pafundme, gojëdhëna e rrëfenja burrash shtatlartë si trungje lisi. Njerëz të mençur e punëtorë duarartë, ka nxjerrë gjithmonë zona. Ndërtues të arkitekturave të vjetra të stileve muzeale, janë ndërtuar nëpër vite nga mjeshtra të punës; si Avdi Burgu. Mjeshtra të punimit të drurit Has Burgu, Xhevat Isufi, Gafurr Zeneli, Zenel Gjika...Po kështu intelektual të mrekullueshëm ka nxjerr Ternova, si profesorin e matematikës, Xhemal Kamberri, Ing. Hasan Cani, doktorrin, Xhaferr Cani, mësuesin e talentuar, Asllan Zeneli, mësuesin dhe intelektualin, Sulejman Teodori, Kujtim Kamberi, Barije Xhafa, Riza Gjika, Xhevat Zeneli, Faik Zeneli, Hysni Imeri, Sadete Sadiku, Hasan Stafa, Bihane Burgu, Rexhep Murati, Haki Teodori, Inxhinjeri Bujar Murati, Jonida Xhafa, Marie Isaku... etj. Janë intelektual që i kanë dhanë vlera të padiskutushme gjithë zonës dhe më gjerë.

Po kështu Ternova krenohet dhe me zëri e bukur dhe melodioz të këngëtares, Fatbardha Isaku dhe vëllait të saj Selim Isaku.

Ternova ka qenë gjithashtu një vatër e zjarrtë e patriotizmit dibranë dhe krenohet me herojtë e vet, bijtë e saj më të mirë që nuk kursyen për atdheun gjënë më të shtrenjtë, jetën. Sot e përgjithmonë, ne dhe brezat që do të vijnë përkulen me respekt para veprës heroike dhe sakrificave të dëshmorëve, Fejzulla Gjika, Halil Hasa e Gjeladin Murati, të cilët dhanë jetën në rininë e tyre të hershme për çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj. Gjurmë të pashlyshme në Terovë kanë lënë ndër vite, Nazmi Gjika, Qemal Xhafa, Mehmet Teodori, Hysni Sinani nga Smolliku, Seman Qylhani etjere.

Çdo shkëmb, gëmush apo krua, çdo shpat, krep apo livadh, çdo luginë, majëmalit apo pemë vetmitare, krejt asaj anë munden me kumtu, me tregu e më dëshmuar, për çka kanë pa e dëgjuar. Shëmbëllen e kungon bukuri dhe hutim. Copëza të hallkatura deri lart në re lëshojnë një energji tërheqëse. Një pyll me pisha të djegura nga dora e njeriut bën më shumë përshtypje sesa një rrokaqiell në mes të një qyteti të bujshëm.

I përfshirë në këtë amfiteatër natyror dhe eposi, s'ka gjasë me mbetun përjashtë një rrëmbese ndjesore të allasojtë, një batërdie e përzishme dhe një kaosi përfytyrimesh dhe ngjarjesh, të cilat duke t'u rikthyer në kujtesë, si trokitje në portat e rijetimit, të pushtojnë, të kanë tjetërsuar në një copë të këtij mozaiku të parrëfyeshëm dhe magjepës. Njerëzit në këto anë tregojnë se si janë vendosur që në kohe të lashta. Ata u janë largur fushave si rezultat i presioneve që kanë ardhur nga pushtuesit që kane pushtuar herë pas here Dibrën. Janë ruajtur traditat dha zakonet që në lashtësi. Banorët shkonin në shehër dhe tregtonin prodhimet e tyre bujqësore e blegtorale dhe ktheheshin me çantat e mbushura me vaj, kripë, sheqer, oriz, pëlhura për të mbajtur gjallë familjen.

Deri në shekullin e XV në Ternovë dhe gjithë zonën përreth kanë ekzistuar sipas tefterve të taxave Turke (spas Doc. Valbona Ramçi) banorë të krishterë, si në Ternovë dhe në Okshtun, dy zona këto që s'ndahen nga njëra-tjetra. Si kudo në vendin tonë ndryshimi i fesë dhe i emrave është bërë më vonë, pas shekullit të pesëmbëdhjetë.

Ternova është e përbërë nga disa lagje, Ternova e Madhe, lagja përtej Zallit, lagjja Kurtaj. Ternova e Vogël ndahet nga Lumi i Terovës, që e ka zanafillën e rrjedhës që nga Kaptina e Martaneshit. Më përtej drejt luginës, aty ku bashkohen lumi i Ternovës me atë të Okshtunit, lugina bëhet më e cekët me aspekte të shumta të ngushtimeve dhe zgjerimeve, të ndara nga vendkalime dhe shtigje. Ekspertët janë të mendimit se kjo zonë është mineralmbajtëse dhe formohet nga detashmentet akullnajore dhe tektonikë. Lugina përgjatë lumit, deri në kufinjtë e Okshtunit është tipike e formuar midis maleve të Kaptinës dhe vargmalesh.

Ternova ka një faun dhe florë shumë të larmishme dhe bujare, karakteristike e vendeve të Evropës Qëndrore. Në lartësitë 800-1200 metra, gjenden pyje ahu dhe toka është e shkrifët. Në lumejt e Okshtunit dhe Ternovës gjenden njiheraz, si për ta përplotësuar me të gjithë elementet këtë shastisje, specie të rralla. Nga peshqit që i gjejmë në lum, është trofta. Për të vijuar me shpendët, i rralli gjeli i egër dhe nga familja e gjitarëve, ariu murrmë, macja e egër, ujku, dhija e egër, dreri, derri i egër e tjere që i hasim gjithandej.

Jo çdo ndarje është kaq e trishtë, e jo çdokënd lumejt e përcjellin me pahir, as atëherë kur bora zbret, era fryn me tërsëllimë, lumi gulçon përmes shkëmbinjsh, dorzan të këtij kushtrimi të ujët malesh. E kunduam gjatë dhe papra krejt këtë bukuri. U çapitëm me të në këtë pejsazh kundrimi të pashoq që zoti i ka dhanë pa kursim bujarinë, ndershmërinë besën, burrërinë, trimërinë.. dhe robi e ka ndarë me shoji-shoijnë bukën dhe kripën.

E përshkuam këtë madhështi në shoqërinë e pandashme të një peizazh sa magjepsës, aq dhe pak të ashpër. Është kjo cekje, ky obligim, ky kushtrim që më zgjon, që na ngre peshë zemrat dhe gjakut na i vë zjarrin, zjarrin e dashurisë dhe mallit, për tokën që e vaditën me gjak paraardhësit tanë, plisin që e njomëm me djersë ëndrrat tona për një jetë më të mirë. Sot Ternova dhe e gjithë ajo malësi, Shqipëria krejt është një rrahje zemre, është një zë që dëgjohet në kushtrimet e brezave, në kushtimin që ne i detyrohemi etërve tanë, të gjithë atyre që e shkruan me shkronja gjaku emrin që ne mbajmë sot, emrin shqipëtar.







Rruga e Arbërit nr. 115

recensë

Romani "Nomeja e largët" i shkrimtarit të njohur Faik Ballanca u promovua edhe në Dibër të Madhe, në vendlindjen e shkrimtarit, ku siç shprehej autori: "Nuk kam shkelur kurrnjëherë në Dibër, por e shoh përherë me sytë e zemrës".

# Arti në dilemën e konkurrencës së opinioneve

*Nga:* **ATLI DEMA**
**LUTFI TURKESHI**




*Shtëpia Botuese "Onufri" botoi këto ditë dhe paraqiti në Panairin e Librit të Tiranës romanin "Nomeja e largët", të shkrimtarit të njohur Faik Ballanca. Libri u përgatit me kujdesin e veçantë të poetit Pandeli Koçi dhe u promovua edhe në Dibër të Madhe, në vendlindjen e shkrimtarit, ku siç shprehej autori: "Nuk kam shkelur kurrnjëherë në Dibër, por e shoh përherë me sytë e zemrës".*

*Në mjediset e Këshillit të Komunës në Dibër të Madhe më 13 nëntor u zhvillua një veprimtari për nder të 70-vjetorit të lindjes së Faik Ballancës. Kjo veprimtari u mbështet nga kryetari i Komunës, Rruzhdi Lata dhe Mexhit Capa, administrator i Llixhave. Në këtë veprimtari morën pjesë shkrimtarë dhe studiues nga Kosova, Dibra, Mati, Gostivari, nxënës dhe dashamirës të letërsisë.*

*Shkrimtari dhe poeti Pandeli Koçi, një ndër miqtë më të ngushtë të Faikut, moderoi këtë veprimtari, si dhe mbajti një kumtesë në lidhje me jetën dhe veprën e shkrimtarit Faik Ballanca. Studiuesja Bleta Qormemeti, kritiku Mexhit Prençi, shkrimtari Vasil Premçi, shkrimtari Nebi Samarxhi, poeti Basir Bushkashi, studiuesi Hysen Uka, etj., mbajtën kumtesa për veprën letrare të Faik Ballancës, duke evidentuar nivelin e lartë të tregimeve, novelave dhe romanit, strukturën e të shkruarit, veçoritë e gjuhës së shkruar, etj. Në përfundim të veprimtarisë, nxënës të Gjimnazit "28 Nëntori", lexuan pjesë nga tregimi "Mbaje pallton çun". Vajza e Faik Ballancës, Erinda Ballanca, dhuroi disa kopje të romanit të fundit të Faik Ballancës, "Nomeja e largët" dhe në veçanti Bibliotekës së Gjimnazit Dibër dhe Bibliotekës së Qytetit Peshkopi.*

*Me këtë rast, redaksia po boton një ese nga Atli Dema dhe Lutfi Turkeshi, shkruar kohë më parë, si dhe kumtesën e mbajtur nga Hysen Uka, i cili temën e tij të diplomës në Fakultetin e Histori-Filologji, vite më parë e ka mbrojtur me studimin mbi krijimtarinë artistike të Faik Ballancës.*

Për artin, për kulturën në përgjithësi është folur shumë. Të shumta kanë qenë studimet dhe botimet, opinionet dhe hulumtimet e bëra në funksionet e tij, për misionin që ai luan e mbi të gjitha për magjinë dhe kënaqësinë estetike që ai të jep, sot më shumë se kurdoherë po ndihet një lloj shpërfilljeje për artin dhe kulturën në përgjithësi. Mbase rendja drejt prakticitetit të përditshëm material është arsyeja që po bën që gjithmonë e më shumë të mos ndiqet ai konsum i nevojshëm estetik që gjithsesi të sjell kënaqësi të madhe e mbi të gjitha të lehtëson nga stresi i përditshëm. Me këtë refleks shtrojmë konstatimin se arti që flet me gjuhën e shpirtit rrezaton dhe emancipon shoqërinë. Sot fjala vjen kemi autorë shumë të popullarizuar dhe autorë, si shumë të mëdhenj, që presin lexuesin e ardhshëm. Në njërën anë janë krijuesit që me veprën e vet identifikojnë konjukturat politike dhe në atë mënyrë krijojnë raporte vazaliteti, këta që janë me shumicë i këndojnë vetes për së gjalli. Përkundër këtyre janë krijuesit që në vepër e projektojnë ekzistencën e vet dhe ku referenca artistike buron nga ekzistenca. Krijuesi është demijurg: disident i përjetshëm dhe oponent i të gjitha dogmave. Këta janë të zgjedhurit e Zotit, dhe si gjithmonë Zoti i dënon të dashurit e vet.

Një i tillë, shkrimet e të cilit janë në esencë të artit jo me shpjegimin e tij, por përjetimin, është edhe Faik Ballanca, fatkeqësisht i "harruar" në letrat shqipe. Me këtë rast, nuk duam të kërkojmë arsyen pse Faik Ballanca, ky shkrimtar i vyer yni nuk gjendet në antologjitë e shkrimtarëve të mirëfilltë shqiptarë, por të nënvizojmë se formalistët rusë kanë zbuluar një parim shumë të rëndësishëm për artin, gjegjësisht letërsinë. Ky parim është zëvendësimi i qendrës me periferinë. Në kohërat e ndryshme një vepër artistike ofron referenca, shtresa dhe mesazhe të fshehura, ajo që sot është aktuale, nesër do të jetë periferike, e ajo periferikja e sotme do të jetë qëndrore. Vepra e mirëfilltë artistike, për të cilat autori nuk ka kurrëfarë garancë, në kohëra të ndryshme, nëse është art i vërtetë, do t'i zbulojë shtresat e fshehura, vizionet që rrezatojnë nga bërthamat e veprës.

Për ta verifikuar këtë parim, jo se i mbështesim formalistët por për ta retushuar esencën e artit të mirëfilltë le ta citojmë esenë e Ridvan Dibrës "Mbi rrasën e një varri" ku shënohet: " Ishin plot shkrimtarë, kritikë e studjues, ndër më të njohurit e letrave shqipe, që jepnin vlerësimet e tyre për Ballancën si njeri dhe si artist. Teksa lexoja ato vlerësime aq të vërteta, të sinqerta e entuziaste (thua se ishin vënë në garë me njëri-tjetrin ata emra të mirënjohur të gjithë bashkëkohës të Faikut, disa edhe bashkëmoshatarë u shpehën "Harruan e heshtën, t'i përmendin të mirënjohurit Robert Elsie që në "Historinë e letërsisë shqiptare" botimi i vitit 1995 të fusin edhe emrin e Faik Ballancës". Kjo antologji nënvizon Ridvan Dibra "është një tekst në të cilin, për nevojat e mia pedagogjike, kam gjetur të dhëna bio-bibliografike për turlifarë shkrimtarësh deri edhe për çunakë njëvëllimsha. Shfletoi me të shpejtë, jo pa emocione, indeksin e emrave, mandej përmbledhjen bibliografike, por më kot emri i Faik Ballancës mungon! E pabesueshme, por e vërtetë. Atëherë, shfletësoj në brendësi (me shpresë) faqet e tekstit, por përsëri emri i Faikut askund. Nuk dua ta fajësoj hartuesin e kësaj historie, mikun e letrave shqipe, dr Robertin (me të cilin shkëmbej jo rrallë mesazhe miqësore elektronike) por e kuptoj se nuk kam kurrfarë të drejtë. Dikush tjetër është fajtor për këtë "harresë" vrasëse. Janë ata, kolegët, miqtë e bashkëkohësit e Ballancës, shkrimtarët e kritikët, studjuesit e teoricientët, të cilët fort mirë e thjeshtë kishin mundur ta informonin mikun e huaj, gjatë shtegëtimeve jo të pakta që ai bëri në Tiranë. Qoftë edhe duke bërë vetëm një përqind të të gjithë atyre deklaratave entuziaste, që thuhen tashti kur Faiku nuk është. Qoftë edhe duke folur vetëm një për qind më pak për veten e tyre (të gjithë janë të pranishëm në "histori", asnjë prej tyre nuk mungon). Harruan e heshtën. Ashtu siç heshtën për turpin e tyre institucione, letrarë e akademikë. (Në të dy parathëniet e "Historisë" janë përmendur jo pak emra institucionesh, shkrimtarësh, kritikësh e studiuesish letrarë, të cilëve, autori i kësaj historie u është mirënjohës për dhënien e informacioneve "të vlefshme". Ndërsa historinë trishtuese të Faik Ballancës ia shtyn harresës. Kështu shprehet Ridvan Dibra në esenë e përkryer dhe shton: "Ishte më i mirë ndër ne!" thonë tashti për Ballancën kolegët e tij shkrimtarë, bashkëkohës me të.

Shumë vite më parë në një katund të Dibrës (edhe Faiku nga Dibra e madhe ishte) kam dëgjuar një shprehje të çuditshme: "Një fjalë e mirë ta shtyn dekën ma larg se njëqind ilaçe". Dhe pyes veten: Po sikur të gjithë këto fjalë të mira që thuhen tashti, të ishin thënë në gjallje të Faikut? Ndoshta kurrgjë nuk do të bënte vaki: gjithçka mund të vazhdonte të ecte në rrjedhën e atyre përcaktimeve misterioze a hyjnore.

Por, ndoshta, Faik Ballanca mund të ishte i gjallë mes nesh. Me disa libra (natyrisht) më shumë… Ai, pra Faik Ballanca i dëshmuar (me tregimet e novelat) dhe i pranuar si më i talentuari (!) dhe më premtuesi ndër autorët e brezit të tij. Domethënë në kulmin e potencës së tij krijuese. Moshë kur një prozator serioz thurr plane e ëndrra për vepra të mëdha. A nuk e dëshmoi një fakt të tillë Ballanca me romanin e tij të parë e të vetëm? E përsëris : Faik Ballanca ishte në kulmin e shpërthimit të tij krijues. Përse vrau veten atëherë?" pyet eseisti i shquar Ridvan Dibra dhe sërisht shton : "Mbetet (pa asnjë dyshim) shkaku i dytë: (sepse si shkak të parë autori supozon shkatërimin krijues), mospërshtatje me kohën e tij. Faik Ballanca nuk ia doli të ishte mik i kohës së tij (me të gjithë "aksesorët" që përbëjnë një kohë dhe hapësirë të caktuar) edhe pse dhuntitë i kishte të mrekullueshme: talent, kulturë, karakter, personalitet e përplot virtyte të tjera njerëzore. Por, ndoshta, pikërisht se ishte kaq i plotësuar si artist e njeri nuk ia doli të mbijetonte. ("Në rastin e artistëve seleksioni natyral kthehet kokëposhtë" thotë i madhi Niçe. Të fortët e të mëdhenjtë nuk ia dalin të përshtaten dhe zhduken. Përshtaten e mbijetojnë të dobtit mediokrët, që përbëjnë kurdoherë "shumicën").

Mbijetesa në "kohën e Faikut" (se mos vetëm në atë kohë) kërkonte më shumë se përshtatje, kërkonte tjetërsim të plotë dhe për një process të tillë si duket nuk qe i përgatitur. Ndaj gjatë çdo kujtimi që i bëjmë Faik Ballancës (këtë ia bëjnë vetëm miqtë e sinqertë të letrave shqipe) një zbrazëti e ndjeshme shprehet jo vetëm në gjirin e të afërmve, por tek të gjithë adhëruesit e letrave shqipe. E kujtojmë talentin e rrallë që për 11 vjet veprimtari, tregimet e para nisi t'i botojë në vitin 1963, la një opus të pasur në prozë prej pesë përmbledhjesh, në tregime, tre novella dhe romanin "Nomeja e largët".

I tillë ishte i biri i Zejnulla Ballancës, profesorit të nderuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës, të cilin patën rastin ta dëgjojnë edhe gjeneratat e viteve 1972-73 në Universitetin e Prishtinës dhe bir i Shazijes, një grua fisnike. Në këtë midis familjar lindi Faiku në 21 dhjetor të vitit 1945 e vdiq më 5 mars 1977. Jetoi vetëm 32 vjet. E mbaroi Fakultetin histori-filologji, degën e gazetarisë në Tiranë dhe po këtu punoi në "Zërin e rinisë" dhe në revistën "Nëntori" si gazetar dhe redaktor. Tregimet e para nisi ti botojë që në moshën 18 vjeçare kurse librin e parë me tregime "Rëmbimi" e botoi në vitin 1970. Në vitin 1971 botoi librin me tregime "Mbasdite të lagura", në 1972 vëllimin me novela "Katër orë larg shtëpisë", pastaj librat "I fundit" dhe "Shtigje me helm", një vit më vonë vëllimin me tregime "Letra anonime", në vitin 1975 librin me tregime "Pritësit e rrufeve" dhe një vjet para vdekjes, në vitin 1976 librin "Tregime të zgjedhura".

Romani i tij i vetëm "Nomeja e largët", i lënë në dorëshkrim iu botua pas vdekjes në vitin 1986 siç iu botua edhe titulli i librit : "Mbama pak pallton çun". Se vërtetë proza e tij është me shumë vlera dëshmon edhe fakti se recenzentë të librave të tij ishin shkrimtarët Ismail Kadare, Neshat Tozaj ose Teodor Laço emra fort të spikatur të romanit shqiptar. Vath Koreshi duke përkujtuar 20 vjetorin e vdekjes së Faik Ballancës në shkrimin e tij "Shkrimtar i cilësive të larta" botuar në "Flaka" të shkurtit të vitit 1998, midis tjerash shkruan : "Jo rrallë më ndodh që duke lexuar tregimet e Faik Ballancës, më vjen në vesh zëri i tij gjithmonë i shtruar dhe i mbushur me magjinë e zemrës dhe mendjes së tij aq të mprehtë… Faiku ngjallet sa herë, sepse ne kemi nevojë me diçka që na mungon. Kur jemi të padrejtë, ai na afron ndershmërinë e tij. Kur na frikon jeta ai na bën më të guximshëm. Ai di të na shtijë gjithmonë që të bëhemi më shumë njerëz, më shumë shokë dhe më shokë të mençur". Vërtetë tërë artin e tij, ky njeri me zemër vezullimtare e vuri në funksion të fisnikërimit të njeriut, të tregojë se ç'rezatim të fuqishëm ka, një shpirt që do, që dhemb… Ai është kundër cinizmit dhe prepotencës së më të fortit ndaj më të dobtit. Ai ishte një i afërt i veçantë i njeriut me halle.

Vath Koreshi e krahason Faik Ballancën me Migjenin, jo vetëm për faktin që këta të dy jetuan aq pak dhe i dhanë aq shumë letërsisë shqipe, por edhe për vlerat e tyre të ngjajshme letrare artistike. Për përkuesen e Ballancës me Migjenin, Vath Koreshi shprehet : "Kur e kam lexuar tregimin e tij "Njerka" kam pasur një bashkëshoqërim aq të afërt të ftyrës së tij me atë të Migjenit. Kjo vinte jo thjeshtë nga një ngjajshmëri dhe jo shumë e largët e tipareve të tyre me një si lëngim të përhershëm, por sidomos nga një dhimbje time që nuk e fyen dhe nuk e nënçmon njeriun e bën atë edhe më njerëzor tek çfaqet me hallet e përditshme". Edhe vlerësuesit e kritikët e tjerë që janë marrë me krijimtarinë e Faik Ballancës e kanë çmuar atë me plot pietet si nga mesazhi ashtu edhe vlera artistike e krijimtarisë artistike. Kanë theksuar se në thelb të prozës së tij është njeriu i përditshëm, njeriu i fortë dhe i qëndrueshëm me dashurinë e dhimbën e tij, me përpëlitjet e gëzimit, me ropatjet e luftën për egzistencë, me luftën kundër smirëzive dhe pushtuesve dhe urrejtjen ndaj së keqes e dhunës. Vlerësuesi virgjil Muçi për veprimtarinë e Faik Ballancës shkruan: "Pas novelës "Kënga e fundit e Marko Bocarit (të mos harrojmë, që ndërkohë, autori kishte botuar pesë vëllime me tregime), ai do të eksploronte natyrshëm viset e romanit për të mbërritur te "Nomeja e largët", për fat të keq, sinori më i fundit në krijimtarinë letrare një vepër që autori vetë nuk do ta shihte të botuar në të gjallë, pasi vdekja do të përvidhej e hynte tinzisht në rrjedhën e jetës, por këtë herë jo për të larë hesapet me ndonjërin nga personazhet, siç ndodh rëndom në veprën fikcionale, por me vetë autorin, i cili, ai shprehet se : "Kur e rimora në dorë, pas kaq e kaq kohësh, novelën e Faikut pata njëfarë tutjeje. Gjithsesi, nuk e dija se sa mund t'i kishte bërë ballë kohës dhe, apriori (?), nuk mund të parathoja nëse do të mundesha të përjetoja sërish atë drithërimë kënaqësie artistike që pata provuar asohere, si një adoleshent i dashuruar pas letrave që ende nuk e kish ngjeruar shijen e botimit. Dhe ndërkaq, teksa shfleton faqen e parë,të dytë… E kështu me rradhë, mjegulla e mëdyshjes nis e tretet dhe ti "zbulon" po atë pejsazh të mrekullueshëm letrar, po ata personazhe që jo thjesht epizmi historik por gdhendja mjeshtërore e shkrimtarit bën që tiparet e tyre të mos zbehen dhe petku artistik që kanë veshur të mos dalëbojë e vjetërohet nga moda e ditës, po atë gjuhë të pastër e të rrjedhshme shqipe që tingëllon si një i njohur i hershëm, me të cilin kishe kohë pa shkëmbyer dy fjalë, po atë dialog të zhdërvjellët e gjith nerv që vende vende zhurmon si një përrua ujëshumë e të ledhaton veshin e paqëton shpirtin me lirizmin e tij, po atë stil të sigurt e të patjetërsueshëm, që duke perifrazuar kritikun Sazan Goliku, do të shkoja ca më tej duke thanë se e bën Ballancën, të fundmin e çehovianëve në letrat shqipe. Thënë me pak fjalë, atë botë të njohur e të dashur për të cilin të kish marrë malli dhe ndoshta, pa e kuptuar as ti vetë, të kishte munguar. Bash në këtë pikë, ankthi i të rilexuarit shteron dhe nostalgjia për mikun që nuk është më, shkon e i le vendin përceptimit realist e krahasues të veprës së tij në një kontekst të ri, bashkëkohor. Ma do mendja që në rrafshin artistik, pra të formës, vepra i ka të gjitha parametrat në rregull, siç e ceka edhe pak më sipër, por ajo çka përmend dhe të çudit pas kaq vitesh është se, duke shpërthyer dogmat e socrealizmit, ajo mbart në vetvete një kumt që kumbon i gjithvlershëm edhe sot, sidomos sot në ditët tona".

Nga vlerësimet e kritikës së shprehur të rezimojmë se ajo që e zotëron të vërtetën nuk duhet të zbulojë veten, pasuritë apo emrin e mirë që ka ndaj verbërisë, marrëzisë e çoroditjes së atyre që zotit i ka pëlqyer t'i lërë në lajthim… Vepra e Faik Ballancës ka një unitet organik dhe gjithnji brenda rregullave artistike të spikatura ndaj meriton të shquhet ose t'i apostrofohet merita në panteonin përkatës të letrave shqipe.

recensë

Faiku ishte nga ata njerëz që punonte me një përkushtim prekës
për përsosjen absolute të mendjes dhe të shpirtit të vet.
HELENA KADARE

# “Nomeja e largët” një gur qosheje në kështjellën e romanit shqiptar

Nga **HYSEN UKA**

*Në radhë të parë dua të vë në dukje faktin se në këtë sofër të miqve të Faik Ballancës janë disa lloje miqsh, ata që kanë lidhje farefisnie e gjaku me të, ata që e kanë njohur nga afër dhe janë shokë e bashkëkohës të tij, miq të veprës së tij (apo ata që ne i quajmë lexues), por është edhe një kategori miqsh që mund të mos kenë pasur asnjëren nga lidhjet e përmendura, por që kanë pasur një lidhje të veçantë me tekstin e tij. Këta janë ata miq që mund të kenë studiuar apo kanë bërë kritikën letrare të prozës së Faik Ballancës për qëllime personale/kulturore e formuese, apo detyrime/detyra studimore e shkencore të formimit të tyre në fushën e studimit të letërsisë… Njëri ndër ta jam edhe unë, që kam pasur nderin të punoj mbi tekstin, të zhytem në vlerat estetike e stilistike të prozës së Faik Ballancës, si një aspirant në kërkim të diplomës në Letërsi Shqipe… Këtë e quaj një fat, për të cilin edhe njëherë dua të falënderoj Departamentin e Letërsisë Shqipe, të kryesuar në atë kohë nga prof dr. Ymer Çiraku, udhëheqësin tim, por njëherësh edhe mikun më të ngushtë të Faik Ballancës, Pandeli Koçin; shkrimtarin e shquar, që më bëri oponencën dhe më dha bashkë me Komisionin vlerësimin maksimal, të paharruarin Vath Koreshi… Është një kohë dhe janë këta njerëz, të cilëve do t’u mbetem mirënjohës tërë jetën. Për të gjithë ata që përmenda, falënderimin dua t’ia përcjell të vetmit që është këtu midis nesh, profesorit dhe mikut tim të çmuar, prej të cilit mora edhe mësimet e para të thella dhe të qëndrueshme për punën studimore e shkencore mbi tekstin, zotin Pandeli Koçi. Faleminderit i shtrenjti profesor Pandeliu!*

Të bësh art me fjalë është si të thurësh pëlhurë me rrezet e dritës. Është vërtet shumë e mundimshme, por edhe e shenjtë, është hyjnore…

Të gjithë ata që kanë provuar apo kanë marrë mbi vete barrën e të shkruarit, e kanë të provuar dhe të njohur këtë mundim e sfilitje…

Por pas kësaj, shqetësimi dhe meraku më i madh i shkrimtarit është se çfarë do të mbetet, çfarë do të mbahet mend e çfarë do të kujtohet nga mundi e përpjekja e tij si shkrimtar.

Fakti që ne mblidhemi këtu, kujtojmë e flasim për artin e prozës, për artin e produktin letrar të shkruar prej Faik Ballancës, tregon se ai e ka fituar sfidën me kohën, ai jeton si shkrimtar dhe rrezaton me lëndën e tij prej shkrimtari, me jetën e tij të përkëndejme, jetën tonë subjektive.


Faiku gjallon në librat që ne marrim në duar prej shkrimtarit, edhe pse fizikisht u bënë vite që është tek të shumtit…

Të menduarit, të ndjerit, imazhet e tij vazhdojmë t’i kemi mes nesh, vazhdojmë t’i ndjejmë e të frymëzohemi prej tyre…

Në fakt, unë e pranoj se gjithçka mund të analizohet e t’i nënshtrohet gjykimit, vlerësimit e kritikës, si asaj të specializuar, ashtu edhe gjykimit e vlerësimit të publikut. Në këtë rast, vlerësimit e përjetimit nga populli, opinioni shqipfolës, nga ai opinion që ka të njëjtin kod komunikimi, të njëjtën strukturë mentale e shpirtërore me shkrimtarin, me prozatorin Faik Ballanca, kemi të përbashkët të mrekullueshmen dhe të bekuarën, gjuhën shqipe. Jo vetëm gjuha, por edhe mjediset, marrëdhëniet, peizazhet, fracili, stanet, gunat, urtësinë e frazeologjinë, emocionin, nervin, zemërimin dhe dhimbjen e shqiptarëve ai e sjell mrekullisht me këtë gjuhë që mjeshtërisht ai e zotëron, e zbulon, e përdor, e zhvillon dhe e pasuron me merakun e mjeshtrit…

Një nder të madh i ka bërë Faiku qëmtimit, zhvillimit e pasurimi të gjuhës shqipe. Po ta “sitim” në sitën e hollë lëndën e tij letrare, do të shihni sa pasuri, sa mall i çmuar, sa thesare do të mbetet nga mademi i marrë në minierën e gjuhës shqipe. Ai ka qëmtuar e rimarrë, duke i bërë të gjalla e aktive një numër të madh fjalësh si nga gegënishtja dhe nga toskërishtja, nga dy degët e shqipes…

> Personazhet e Faikut, njerëzit e “kabiles” letrare të Faikut, janë edhe ëndërrimtarë, pasionantë e të zjarrtë… Ne dhe Faiku i kemi tanët ato personazhe, jemi nënë e bir, babë e bijë, farefis, miq e shokë, jemi të gjithë të njëri-tjetrit me ato personazhe dhe po aq sa të Faikut, ata janë edhe tanët. Të gjithë e kemi tonin Bendon, pasi të gjithë e kemi një Bendo, të gjithë e kemi tonën edhe Bardhën, edhe Rubinë e vogël... të cilët Faiku na përshkuan mjeshtërisht ...



Ai ka qëmtuar në jetën e popullit, në historinë e aktualitetin shqiptar të kohës së tij dhe ka punuar e krijuar mbi një tematikë që vjen e gjallë në imazhe e mendime nga epoka në epokë si në një pelikol filmi…

Fjalia e shkurtër i jep një ritëm poetik leximit të prozës së tij, me fjalë të përzgjedhura, të renditura e lidhur mjeshtërisht, duke e mbushur me dritë tekstin, duke e bërë likuid e të rrëshqitshëm, të rrëkeshëm si një përrua malor që rrjedh i bardhë e melodioz nga shpatet e shtrati të tij shkëmbor e të lashtë, duke u shndërruar në një ligjërim të shtruar.

Veçoria e prozës së Ballancës është se ai di të ruajë raportin e të menduarit dhe të shkruarit me imazhe dhe i të menduarit verbal… Ndoshta ai do të ishte bërë edhe një skenarist i shquar, nëse do të kishte jetuar e do të kishte provuar të shkruante për artin e shtatë. Faiku mendon me imazhe dhe skicon mjeshtërisht peizazhe. Dhe në këto peizazhe janë personazhet e tij, të cilët janë “vendas”, janë “autoktonë”, të cilët rrinë e lëvizin lirshëm në ato peizazhe të thyera e madhështore, lirike e idilike, duke dhënë e marrë, jetuar e përjetuar jetën, të përditshmen, të shkuarën, por edhe të ardhmen e tyre…

Personazhet e Faikut, njerëzit e “kabiles” letrare të Faikut, janë edhe ëndërrimtarë, pasionantë e të zjarrtë… Ne dhe Faiku i kemi tanët ato personazhe, jemi nënë e bir, babë e bijë, farefis, miq e shokë, jemi të gjithë të njëri-tjetrit me ato personazhe dhe po aq sa të Faikut, ata janë edhe tanët. Të gjithë e kemi tonin Bendon, pasi të gjithë e kemi një Bendo, të gjithë e kemi tonën edhe Bardhën, edhe Rubinë e vogël, edhe Isain, edhe Marko Bocarin, Ali Pashanë, Thanas Vanjën, dervishin Isuf, e dervishtë e ziqrit në pazarin e Janinës, kur Faiku na përshkuan mjeshtërisht pazarin kozmopolitan të Janinës, aty ku bashkëjetonin raca e kultura të llojllojshme.

Pra, ne jemi nga një fshat, nga një krahinë, nga e njëjta tokë, nga i njëjti nënëqiell me Faikun, ndaj ndjehemi e kuptohemi aq mirë me personazhet, me bëmat, me ndjenjat, vuajtjet, dhimbjet, gëzimet e të gjitha llojet e emocioneve e përjetimeve që vijnë nga një botë me fjalë, nga bota e shkrimtarit… Por në botën e tij të ndërtuar me fjalët e artit, në botën e tij letrare, vihet re edhe një rend e rregull, një mjedis i pastër nga “mëkati, e përllangia”.

Faiku nuk lejon të ndyhet në asnjë cep mjedisi i tij letrar, as në kthinat më imtime e private, ku njeriu “lëshohet” shthuret dhe as në mjedise ku rëndom shthurja përdoret për të krijuar rrahje të zemrës së lexuesit, për ta tërhequr e këndellur atë në mëkatin e mishit e në pasion pa moral. Nuk lejon që proza e tij të jetë, nëse mund ta themi kështu “prozë tallava”, një tallava letrare. Faiku nuk i lejon vetes asnjë lloj spekulimi me fuqinë e magjinë e fjalës, nuk i lejon vetes të spekulojë me këto lloj emocionesh e ndjesish… Ai i ka të shenjta e të çmuara ato... Proza tij është e mbushur me dashuri e dëlirësi, është e pastër dhe e lehtë si erë mali. Faiku ka një cilësi që e vë natyrshëm të qëndrojë në fronin, në rendin e njerëzve të urtë, duke vënë në ekuilibër atë që mendon, bën e thotë ai vetë, me atë që shkruan, veprojnë e bëjnë personazhet e tij. Faiku është shkrimtari i vlerave të larta morale, të atij morali njerëzor, të unifikuar dhe të kodifikuar si një vlerë mbarënjerëzore, si një vlerë universale…

Mjetet artistike, struktura është krejt origjinale, një arkitekturë e tekstit të estetizuar krejt e re, e panjohur më parë në romanin shqiptar. Vepra “Nomeja e largët” është e para dhe e vetmja e shtënë e tij me armën e rëndë të romanit, siç është quajtur romani: artileri e rëndë e letërsisë; por që edhe pse një e i vetëm, qëlloi në shenjë dhe që la gjurmë. Në kështjellën e romanit shqiptar ai është një gur qosheje, që do të bjerë në syrin e lexuesit dhe historishkruesve të romanit shqiptar. Veçoritë kompozicionale të këtij romani morën vëmendjen dhe bënë të çuditet edhe Kadare, i cili lidhur me këtë shprehet: Çuditem se si ka mundur të realizojë një strukturë kompozicionale të tillë, sa të vështirë, aq edhe moderne”.

Proza e Faik Ballancës ka edhe një veçori tjetër të rëndësishme, që e shquan dhe i jep atij statusin e vërtetë të mjeshtrit, të atij që zotëron e krijon, duke përdorur vetëm fuqitë e fjalës, pa u rrekur të kërkojë apo të stisë rrjedha subjektore të forta, të mbushura me befasira e trille ireale apo zgjidhje dramatike. Dhe nga kjo veçori e thënë thjeshtë, por që kushdo që e ka lexuar prozën e tij të shkurtër e ka kuptuar e ndjerë, është se ajo nuk mund të ritregohet, nuk mund të riprodhohet në formë orale, pasi është aq delikate, sa nuk të lejon ta riprodhosh e rifrymosh me asnjë frymë tjetër prozën e tij.

Faleminderit Faik për veprën dhe kujtimin që na ke lënë, faleminderit që na mbledh e na bën që edhe në rëndomësinë e të përditshmes të mblidhemi e të flasim për vlera të larta, për artin e fjalës që na ke lënë ti në veprën tënde…

## Vlerësime për Faik Ballancën

Romani “Nomeja e largët” i Faik Ballancës më pëlqeu. Asnjë nga akuzat që i bën redaksia nuk qëndrojnë. Ky është romani i tij i parë dhe çuditem se si ka mundur të realizojë një strukturë kompozicionale të tillë, sa të vështirë aq edhe moderne.

ISMAIL KADARE

Letërsia e Faikut është e thjeshtë dhe e çiltër. E mençur dhe fjalëkursyer. E mbushur me dashuri. E mbushur me dhimbje. Duke luajtur në fushën më të rrezikshme për suksesin, siç është jeta e përditshme pa maja, Faiku tregon se është shkrimtar i kualiteteve të larta.

VATH KORESHI

Mundësia (e Faik Ballancës) për të hetuar tinguj dhe ngjyra dramatiko-poetike te gjërat që i kemi pranë dhe përherë para syve. Është shkrimtar me afinitet të theksuar për të befasuar, pra sipas filozofisë “veza e Kolombit”.

ALI ALIU

Faik Ballanca i qëndroi besnik vetes, sepse e dinte se shkrimtari nuk ka një vdekje, se shkrimtari ka edhe një vdekje të dytë, më të tmerrshme se e para, vdekjen e pasvdekjes.

NASI LERA

Nëpërmjet një përzgjedhjeje të përcaktuar saktë e qartë të materialit jetësor, nga dy periudha kohore të ndryshme dhe ndër- thurjes së tyre në mënyrë origjinale, Faik Ballanca ia ka arritur të realizojë me sukses një kohezion ideor mes së shkuarës e të tashmes.

SPIRO GJONI

Rruga e Arbërit nr. 115

Festohet 90-vjetori i hapjes së shkollave shqipe
në Zogje e Gjoricë të Dibrës

arsim

# Gjeneratat e shkollave që mbushin shekullin

*Nga* **MEHDI DEMA, ZABIT LLESHI**

Ishte mëngjesi i 13 nëntorit 2015, që gdhiu ndryshe nga ditët tjera për shkollën 9-vjeçare Zogje. Një atmosferë festive njoftonte, jo vetëm banorët e zakonshëm të shkollës, por dhe çdo kalimtar të rastit, në rrugën tangent me oborrin e saj , një gëzim i ligjshëm i një dite historike flladonte portretet e mbarë banorëve të kësaj zone. Mësues e nxënës të kësaj shkolle, duke ruajtur të pastër traditën dibrane të mikpritjes, kishin krijuar atë atmosferë të këndëshme festive. Mikpritja për të ftuarit, ish-mësues në këtë zone dhe të ftuar të tjerë, shprehej në sytë dhe zemrat bujare të drejtuesit të kësaj shkolle, Jeton Lika, të mësuesëve dhe mësueseve: Sadete Kamberi, Ariana Dema, Lijljana Nasufi, Mehmet Koxha, Bektash Xhafa, Jeton Rexhepi, Tefta Dumani, Florina Mena, Fatbardha Uka, Liljana Xhafa, Fatbardha Xhafa, etj., si dhe në portretet e gëzuara të mbarë nxënësve. Përkujtohej hapja për herë të parë e shkollës shqipe në Zogje, këtu e 90 vite më parë. Si godinë e parë e shkollës, me bujarinë e Dulejman Kajës, do të shërbente shtëpia e tij. U desh që mësuesit e parë, në mungesë të atyre vendës, të vinin që nga Dibra e Madhe, Tirana, etj. , si Rexhep Baholli, Sabri Sakiqi, etj. Si dallëdyshe e parë, mësues nga zona, qe burri i zgjuar, për të mos u harruar kurrë, Abaz Xhafa, i cilli u bë frymëzim për breza të tërë mësuesish të rinj.




*Atmosferë festimi i 90-vjetorit të shkollës Zogje*

Në kuadrin e këtij jubileu, u zhvilluan një sërë veprimtarishë:

1. Sesioni Jubilar, i mbajtur me këtë rast, u hap me përshëndetjen e Drejtoreshës së Zyrës Arsimore të Bashkisë Bulqizë, Znj. Bedrie Manjani.

Në fjalën e saj të përshëndetjes, ajo kujtoi përpjekjet e mëdha që kanë bërë patriotët e kësaj zone, në luftë më pushtues të ndryshëm, për mësimin e gjuhës amtare. Kujtoi dallëndyshet e para , mëses-nxënës, të kësaj shkolle. Në vazhdim nuk la pa përmendur, arritjet në sistemin ri arsimor dhe punën e mirë të mësuesve të kualifikuar e të përkushtuar. E mbylli fjalën e saj, me urimin për ngritjen akoma më lart të rrezultave të arrira, duke shfrytëzuar përvojën e trashëguar, të gërshetuar me informacinin e pamunguar mbi të rejat shkencore.

2. Trajtesën ''Lufta e patriotëve dibranë për hapjen e shkollës shqipe" e mbajti ish- nxënës dhë ish-mësues i kësaj shkolle, studjuesi, Z. Zabit Lleshi. Në këtë trajtesë ai, me referenca bindëse, tregoi rrugën e gjatë dhe të mundimëshme të patriotëve dibranë, deri sa bënë të mundur hapjen e shkollave shqipe. Hapja e shkollës shqipe në Zogje qe rrezultat i harmonizimit të luftës të patriotëve në mbarë trevat e Dibrës dhe në veçanti ata të Grykës së Vogël, si: Tush Lleshi, Bajram Markja, Jashar Dema, Shaqir Daci, Mersim Dema, etj. Materiali i trajtuar për vet përmbajtjen, saktësinë dhë eskluzivitetin, për këtë zonë, u ndoq me mjaft interes dhe kurreshtje mbresëlënëse.

3. Trajtesën "Mësuesit e ardhur, ndihma për konsolidimin e shkollës" , e mbajti ish- mësues i kësaj shkolle, Z. Mehdi Dema. Në këtë trajtesë, para emërtimit të mësuesve që kanë kontribuar, me punën e tyre të lavdërueshme në shkollat e kësaj zone, në përballje me mjaft vështirësi që sillte koha dhë tereni i kësaj zone malore. Në kujtim të ish- mësuesve në shkollat e Zogje, që s'u kursyen për të dhënë maksimumin e energjive fizike e mendore të tyre , por që s'e jetojnë në këtë ditë, u propozua të mbahej një moment heshtjeje... Kjo trajtesë u mbyll duke ftuar mësuesit aktualë për të përcjellë më tej, e më mirë, stafetën që koha u a ka besuar ta mbajnë në dorë.

4. Trajtesën "Shkolla e Zogje, pika e nisjes për përgatitjen e kuadrove „ e mbajti ish- nxënës dhe ish-mësues i kësaj shkolle, Z. Xhevat Jella. Trajtesa pati mjaft interes, se nxori në pah emra të kuadrove të dalë nga kjo zonë, në të gjitha fushat e jetës. Shumëllojshmëria e profesineve ; mësues, agronomë, mjekë, ushtarakë, inxhinierë, juristë, ekonomistë,etj. dhe numri i madh i kuadrove, të sistemuar në këtë trajtesë, tërhoqi vemendjen e dëgjuesve.

5. Trajtesën "Shkolla e Zogje në 90 vjetorin e saj", e mbajti drejtori i kësaj shkolle, Z. Jeton Lika. Me retorikën e tij mjaftë rrjedhëse, ai dëshmoi jo vetëm për rezultatet impresionuese në punën e filluar nga stafi, në moshë mjaft të re , i kësaj shkolle, por në fjalën kopetente të tij, në sytë e tij shprehëse, shihje optimizmin, premtimin dhe shpresën e një të ardhmjeje të ndritëshme drejt ritmeve të kohës.

6. Për rrezultatet e arira në këtë shkollë dhe punën e mirë për realizimin e këtij evenimenti, përshëndeti Administratori i Njësisë Administrative, Z. Leonard Daçi.

7. Në atmosferën e bukur të kësaj vjeshte-verë, në ditën plot dritë e freski pranverore, të zbukuruar nga kostumet e shumta popullore-krahinore, plot larmi ngjyrash e stolishë, që konkuronin natyrën e bukur të bimësisë, kurorë për reth, të veshur bukur nga shumë djem e vajza nxënëse, nën kujdesin e mësueseve të apasionuara; mori fjalën të përshëndesë këtë eveniment, Kryetari i Bashkisë Bulqizë, Z. Melaim Damzi. Duke uruar për punën e mirë të bërë nga stafi i ri dhe apasionuar i shkollës me dëshirën e mirë për të qenë sa më të shkolluar e bashkëkohor, mes entusiazmit në sytë e nxënësve, premtoi në emër të tij, se në bashkëpunim me zyrën arsimore, do t'u qëndronte gjithëmonë shumë pranë për të zgjidhur çdo problem të shkollave në Zogje, për t'u bërë ato ndër shkollat më të mira në Bashki.

Në vazhdim atmosfera u ndez nga këngët, recitimet dhe vallet e bukura të grupit artistik të shkollës. Në vallet e bukura plot ritëm e gjallëri, nuk mbetën pa u përfshirë dhe mësues e të ftuar. Evenimenti u mbyll me një koktei modest, por me shumë atmosferë.

Jehona e përkujtimit për përvjetorët e hapjes së shkollave shqipe në Grykë të Vogël, nga shkolla e Zogje, u ndie akoma më fuqishëm, në si motrën e saj, në Gjoricë. Edhe shkolla e Gjoricës, në ditët e bukura plot diell të kësaj vjeshte, më 20 nëntor 2015, festoi 90-vjetorin e saj.

Aktivitetet kulturore nisën që në orët e para të mëngjesit e deri në mbrëmje. Njësia Administrative dhe Drejtoria e Shkollës, kishin shumë kohë përpara që merreshin me përgatitjen. Mësuesit Esmeralda Miftari, Edlira Miftari, Elona Domazeti, Basri Muha, Ana Cami, Liljana Xheka e Mavlina Lika, kishin rifreskuar klasat-kabinet dhe ambientet e shkollës . Gjithçka shëndriste nga rregulli e pastërtia. Pëllumb Cami, Shukri Hajdari, Yllka Çela, Ervin Miftari, me drejtorin Fatos Muha, kishin bërë një punë të kujdesëshme për të mbledhur kujtime e fotografi nga veteranë të arsimit e punës. Një stendë, në hyrje të shkollës, tregonte historinë e saj në vite; një kujtim i paharruar për punën e qindra mësuesve që punuan në Gjoricë. Ata jo vetëm lanë gjurmë në fushën e arsimit në Grykën e Vogël, por nuk i shkëputën asnjëherë lidhjet, miqësitë e shoqërinë me gjoricarët, duke marrë reciprokisht, mirënjohje, rrespekt e dashuri të pakufishme. Në kuadër të 90-vjetorit të shkollës, u bë rikonstruksioni i plotë i godinës ku bën mësim 9-vjeçarja, u ndërtua një palestër e re bashkëkohore, duke bërë të mundur realizimin në sasi e cilësi të orëve të mësimit të edukimit fizik. Ajo do të kthehet në një qendër sportive ku do të përgatiten sportistë cilësor në lojrat me dorë e veprimtari tjera, ku Gjorica është shquar në bazë rrethi e ato kombëtare. Festa u shoqërua me disa veprimtari që e zbukuruan dhe hijeshuan atë. Në Çerenec të Poshtëm, shkollës i u dha emri "Zenepe Gjata (Miftari)", për të përjetësuaruar emrin e kësaj mësueseje nga Elbasani, që dha gjithçka për shkollën dhe banorët e fshatit. Me këtë rast fëmijët e saj erdhën dhe falenderuan organet e pushtetit lokal të Gjoricës, për nderin e madh që i bëhej nënës së tyre dhe familjes. Në vazhdim, në qendër të Gjoricës, u organizua një sesion Jubilar. Kishin ardhur mësues veteranë , ish-nxënës e mësues të shkollës, mësues-drejtorë të shkollave 9-vjeçare të Grykës së Vogël, Grykës së Madhe dhe të ftuar të tjerë. Erdhën për të festuar këtu : Prefektja e Dibrës në detyrë Znj. Donika Hyseni, Kryetari i Bashkisë Bulqizë Z.Milaim Damzi, Drejtore e Zyrës Arsimore Znj. Bedrie Manjani, ish Ministre e Arsimit, bijë e kësaj zone, Tefta Cami, etj. Në Sesionin Jubilar, pjesëmarësit i uroi për mirësardhjen Z. Vehbi Xheka, Kryetar i Njësisë Administrative Gjoricë , ndërsa Dretjoresha e Z.A. Bulqizë, Znj. Bedrie Manjani, në fjalën e saj, evidentoi punën plot pasion të mësuesve: Haxhi Ademi, Shyrete Sharku, Zenel Çela, Xhelal Manjani, Latif Dema, Mendu Dema, Riza Manjani, Elez Xheka, Bukurie kaja, Mehdi Dema, Sashenka Kotherja, Emin Ruçi, Sulejman Çuku, Sali Fejza , për edukimin e brezit të ri; si dhe shumë të tjerë që i shkrinë aftësitë e tyre në gjallërimin e jetës kulturore, si : Adivie Miftari, Osman Patria, Hajri Alimani, Shukri Hajdari, Redife Lleshi, Naslie Mulia, Xhevdet Daci, etj.

Trajtesën: Lufta e patriotëve dibranë për hapjen e shkollës në Gjoricë, e mbajti Z. Zabit Lleshi. Z. Shukri Hajdari foli për kontributin e klerikut patriot, Sheh Latifi. Z. Pëllumb Cami mbajti trajtesën: Mësuesit e ardhur në Gjoricë dhe ndihma e tyre për konsolidimin e shkollës.

Drejtori i shkollës Z. Fatos Muha, u ndal në arritjet e shkollës së Gjoricës në 90-vjetorin e saj. Mes tjerash ai theksoi se : Kemi një kolektiv mësuesish të mirarsimuar e të kualifikuar për të kryer një detyrë të rëndësishme, por plotësisht të realizueshme; atë të edukimit të brezit të ri. Janë të gjitha mundësitë që shkolla e Gjoricës , si kurdoherë, të jetë në ballë të shkollave të Qarkut Dibër.

Të pranishmëve, mësues, nxënës e banorë, i u uroi festën edhe Znj. Tefta cami; mësuesve mbarësi e profesionalizëm në punën e përditëshme.

Në mbyllje, Kryetari i Bashkisë Z. Melaim Damzi, vlerësoi patriotizmin, brez pas brezi, të popullit dhe të mësuesit të parë të shkollës, Haxhi Ademi (Skëndreri). Ai falenderoi drejtorin dhe kolektivin e shkollës për punën shembullore në edukimin e brezit të ri; vlerësoi kontributin e humanizmin e banorëve të gjoricës , sidomos të Shpëtim Camit, për ndimën që ka dhënë për infrastrukturën e shkollës.

Grupi artistik i shkollës, i dalluar në veprimtaritë kulturore e artistike, në nivel lokal e kombëtarë, dha një program të pasur dhe të bukur, me këngë patriotike, këngë për mësuesin e parë të shkollës, Haxhi Ademi, recitime, etj. Falenderime për këto përgatitje, shkojnë për mësuesit Naslie Mulia, Hajri Alimani, për punën plot pasion e profesionalizëm, në pregatitjen shumëvjeçare të djemve dhe vajzave të Gjoricës. Në saj të punës së tyre Gjorica ka përfaqësuar shpeshherë me dinjitet rrethin në festivale lokale e ato kombëtare.

Duke përcjellë lumturinë e këtyre ditëve, festa përkujtimesh, duke parë portretet, punën, pasionin, optimizmin e vajzave dhe djemëve të rinjë, për të ecur paralel me zhvillimet e shpejta të këtij fillimshekulli; nga zemra na buron urimi: Gëzuar festën, ju mësues e nxënës! Përpiquni të avanconi sa më shumë misionin fisnik e historik të shkollës, të frymëzuar nga dashuria për punën, njerëzit, Kombin!



*Një foto, nga mësuesit e pranishëm, në 90-vjetorin e shkollës së Gjoricës*



*Grupet artistike të shkollës Gjoricë*

veprimtari

# Bujar Kapexhiu nderohet me medaljen "Shqiponja e Artë"

*Nga* **GJERGJI MIMA** / ATSH

Në mjediset e Pallatit të Kongreseve, në kuadër të Panairit të "Klik Ekspo Group" nën moton Biznes-Kulturë-Bashkëjetesë, më 24 nëntor u zhvillua ceremonia e prezantimit të Ekspozitës së Karikaturave të Artistit të Meritur Bujar Kapexhiu.

Henri Çili, drejtues i Universitetit Europian të Tiranës dhe botimeve MAPO, të cilat prezantohen me stendën e tyre në ketë panair, u shpreh se, "në vitin e 10-të botimeve MAPO do të realizoje një botim kushtuar Bujar Kapexhiut me të gjitha karkikaturat e artistit.

Ndërsa Artur Dauti u shpreh në fjalën e tij se, "tek Bujari gjen atë buzëqeshjen që dhe kur je në vështirësi të mëdha qoftë profesionale Bujari të rikthen buzëqeshjen. Tek Bujari ka qenë gjihmonë një shembull dhe udhërrëfyes për ne. Filmat e Bujarit kanë tërhequr vëmendjen e publikut të gjerë".

Më pas Presidenti i "Klik Ekspo Group z. Luan Muhametaj i dhuroi z. Kapexhiu medaljen "Shqiponja e artë" me motivacionin "Bujar Kapexhiu, mjeshtër i artit të humorit, përcjellës i mesazheve të forta për shoqërinë përmes artit të tij shumëpërmasor, me karikaturë dhe humor të zgjuar e progresist. Një mendje e mprehtë për mendje të mprehta".

Artisti Kapexhiu vlerësoi këtë çmim si një çast emocionant. Ai ironizoi sëmundjen që e ka prekur kohët e fundit. "Ju kërkoj ndjesë që kam shtuar kapelen apo shallin në aksesorët e mi këtë mbrëmje. Arsyeja është ajo që shumë miq e dinë se jam në fund të kalimit të një paralize faciale. Dhe nëse dikush do të qeshe nuk do ta marr për ters. Por mesa duket dikush më ka mallkuar duke qenë se ka thënë që ky çdo ditë shtrembëron polikanët, pandaj të shtrembërohet një herë edhe ky. Tre javë më parë isha i shtrembëruar, por u kënaqa me një gjë se më kapi në anën e djathtë dhe u kënaqa se mendoj që në anën e djathtë dhimbjet kalojnë ë shpejt", tha Kapexhiu.

Më tej ai falenderoi stafin e "Klik Ekspo Group" që i dha një çmim të madh, dhe tha ai, "kjo s'është vetëm meritë e imja, por edhe e stafit që punon me mua".

Kapexhiu falenderoi Presidentin e "Klik Ekspo Group" z. Luan Muhametaj që theksoi ai, "ka qenë gjithmonë pranë krijimtarisë time".




**"Bujar Kapexhiu, mjeshtër i artit të humorit, përcjellës i mesazheve të forta për shoqërinë përmes artit të tij shumëpërmasor, me karikaturë dhe humor të zgjuar e progresist. Një mendje e mprehtë për mendje të mprehta".**

Ndërsa Elona Agolli, vajza e shkrimtarit Dritëro Agolli, i përcolli z. Kapexhiu një mezash falenderimi nga babai i saj shkrimtari Dritëro Agolli, për portretizimin e shkrimtarit të madh në pikturat e tij.

"Ndjehem e nderuar dhe e emocionuar njëherësh që të përcjell një falenderim e mirënjohje nga ana e babait tim Dritëro Agolli, për mjeshtrin e madh të karikaturës, Bujar Kapexhiu. Po citoj babain tim i cili thotë që Artistët që lëvrojnë zhanrin e karikaturës janë nga me të mençurit e te vleresuarit edhe nga vete ata qe behen objekt karikature. De Goli i madh zgjohej çdo mëngjes i ethshëm për të parë e për t'u kënaqur me karikaturat e tij në faqet e shtypit francez. E njëjta gjë i ndodhte Andreotit apo dhe Ajnshtajnit që ekzaltoheshin nga karikaturat e tyre. Karikatura dhe poezia janë si teshtima, jo çdokush mundet të jetë poet apo karikaturist dhe jo vetëm kaq, varen shumë nga momenti i frymëzimit. Dhe motivacioni i vlerësimit "Një mendje e mprehtë për mendjet e mprehta", përmbledh shumë bukur Artin e madh të Mjeshtrit Bujar Kapexhiu.", u shpreh Elona Agolli.

Ndërsa mjeshtri Kapexhiu në falenderimin e tij u shpreh se, "padyshim e kam vënë këtë medalje në gjoks, por mund të them që shumë më tepër vlerë ka kjo letër nga i madhi Dritëro Agolli. Dritëroit thotë për karikaturistët duhet të jenë të mencur dhe unë e them këtë në përgjithësi që arti i humorit është privilegj i të mençurve dhe për të kuptuar këtë mençuri edhe lexuesi duhet të jetë i mençur. Prandaj sa i mençur është Dritëroi që ma ka dedikuar mua. Pranda jetë të gjatë Dritëroit".

Më pas mbrëmja u mbyll me disa vargje të recituar nga shkrimtari Dritëro Agolli.

# Një njeri që shikimi i vinte nga shpirti

## *Shënime në respekt të Xhelal Roçit...*

Ai hyri në sallë i shoqëruar nga një zonjë. E mbante përkrahu ndërsa Ai, kavak i drejtë, kontrollonte rrugën duke trokitur me shkop mbi pllakat e mermerta të Pallatit të Kulturës. Kisha kohë që nuk e kisha takuar, shumë vite, rreth njëzet, që kur ika për të mbetur si në vajtimin... "Mbeçë more shokë, mbeçë...", larg vendlindjes e njerëzve që i desha dhe i dua. Emrin nuk ia kisha harruar sepse pena e tij nuk më ka lënë as atëherë e as sot ta harroj, thjesht sepse ai është i pranishëm faqeve të shkruara të shtypit, atëherë dhe sot...

- Erdha, më tha i mallëngjyer. Më kish marrë malli. Nuk shoh por dëgjoj mirë...

Unë kisha mbledhur "Njerëzit që i dua" në gjashtë libra për t'ua paraqitur miqve të qytetit tim të jetës, Peshkopisë. Kisha emocione kur i takoja, kur flisja me ta, kur thashë pak fjalë i ngushur deri në lot...

Ai u ul në radhë të parë. Mbështetur mbi shkop, gjymtyrën e re të jetës së tij. Sytë ia fshihnin një palë syze të errëta.

E fiksova kur "shihte" tepër i përqendruar dokumentarin "Vera-mësuese në dy ishuj të Egjeut". Ka ulur kokën ndërsa të gjithë të tjerët e kanë përqendruar shikimin në pamjet e bukura që shfletoheshin në film. Është i përqendruar tek fjalët që vinin larg, shumë larg, dallgëve të detit, dallgë midis dy ishujve një orë e gjysmë larg, ishujve të Tinosit dhe Sirosit. Mes fjalëve, tingujve të muzikës e këngëve që përcilleshin Ai shikonte.

Po, po.

Shikonte me shpirt...

Kur përfunduan fjalët e të pranishmëve për librat dhe filmin Ai u ngrit dhe me një zë emocionues më kërkoi të bënim një fotografi së bashku.

Një çast i bukur, një kujtim që ngjitet përtej së bukurës së zakonshme.




Kjo ndodhi më 31 tetor 2015.

Xhelal Roçin e kam me vete njëmijë kilometra larg vendlindjes. E kam me zë, me figurë, me dashurinë e tij.

Xhelal Roçi është një njeri i veçantë në radhët e "NJERËZVE QË I DUA"...

**Abdurahim Ashiku,** *Athinë, 10 tetor 2015*



# "Mërmëritja e Antigonës" shfaqet në Dibër

Në sajë të bashkëpunimit të dy komunave të binjakëzuara, Komunës së Dibrës dhe Komus If të Normandisë së Francës, në Qytetin e Dibrës dhe atë të Strugës u mbajt shfaqja teatrore "Mërmëritja e Antigonës", e aktruar nga të rinjë të të dy qyteteve.

Tragjedia e Sofokliut vazhdon të shprehet për ruajtjen dhe nderimin e ligjeve të shkruara shtetërore, por në atë kufi sa të mos cënojnë ligjet e pashkruara morale e zakonore. Këtu zë fill konfliki ndërmjet Antigonës, që mbron ligjet e pashkruara të ndërgjegjjes, të lidhjes së gjakut me të vëllanë, dhe Kreontit, që mbron ligjet e shkruara të shtetit.

E veçantë e kësaj drame është sepse aktorët flasin në gjuhën e tyre në atë Frenge, shqipe dhe maqedone.

Bashkëpunimi kulturor mes dy komunave është në dukje e sipër. Drama "Mërmëritja e Antigonës" vitin e ardhshëm, gjatë muajit prill, do të marrë pjesë ne festivalin e taetrit që do të mbahet në Kan të Normandisë së Francës.



# Mbahet në Dibër portiku poetik "Lutfi Turkeshi"

Në organizim të Klubit Letrar "Art Klub", para dashamirësve të fjalës së shkruar në qendrën për kulturë u mbajt Portiku Poetik "Lutfi Turkeshi", ku me fjalën e tyre poetike poetë nga hapsira gjithshqiptare mikluan ambientin kulturor dibran, me mesazhin se fjala e bukur e shkruar është ajo që afron meridianët, shëron dhe bashkon zemra. Ndërkaq kryetari i komunës së Dibrës, Ruzhdi Lata, gjatë hapjes së portikut poetik tha se "rilindësit ngritën frymën e moralin patriotik, edhe sot vargu i poetëve të rinj duhet të ketë karakter e frymë patriotike".

Në edicionin e 13 të portikut poetik mernin pjesë poetë nga Shqipëria Kosova dhe Maqedonia, dhe atë poetët Xhelal Luca, Adem Abdullahu, Rahim Ganiu, Flora Brovina, Nehas Sopaj, Rami Kamberi, Nuhi Vinca, Erina çoku, Abdulla Troshupa, Mustafa Spahiu, Nuri Koleci, Arbëresha Turkeshi, Rudina Batku, Sërmet Sulejmani, Irfan Ushtelenca, Kela Bilbili, Kalosh Çeliku dhe Nebi Samarxhiu, të cilët përmes fjalës së shkruar të tyre paraqitën muzat poetike. Nga ora letrare në restorant "Uraniku" poetët vazhduan në natën pa kufi.

Në frymën e motivimit të poetëve të rinj që nga ky vit Portiku Poetik "Lutfi Turkeshi" begatohet edhe me konkurs letrar të titulluar "Ajri Begu" ku familja Begu ndan mirënjohjet dhe tre çmimet e para fituese marrin shpërblime nga familja e Ajri Begut. Fituese e konkursit letrar këtë vit ishte poetja Adisa Cëroi. Shpërblimet i ndau Kryetarja e lidhjes se Shkrimtarëve të Kosovës, bashkëshortja e Ajri Begut, Flora Brovina.

A.Dema

Një studim nga Mentor Hoxha për Nderin e Kombit
dhe Vendlindjen e Heroit Kombëtar

# **Blliçja, Çidhna** dhe **Dibra** në një studim shkencor

*Nga Dr.* **HAJRI MANDRI**

Pas botimit të librit "Figura e femrës në letërsinë shqipe" (Stërmilli - Kokalari - Migjeni -Koliqi), studiuesi, poeti dhe gazetari i njohur Mentor Hoxha rishfaqet me një tjetër studim të mirëfilltë shkencor me titull "Blliçja, Çidhna dhe Dibra në historiografinë shqiptare dhe botërore".

Ky studim është një udhërrëfyes historik jo vetëm për dibranët, blliçjanët, çidhnakët, por për mbarë shqiptarët dhe studiuesit brenda dhe jashtë Shqipërisë, pasi njihen me një prej trevave më të spikatura të historiografisë shqiptare e botërore. Një trevë plot ngjarje të rëndësishme historike dhe vendlindja e dhjetrave figurave të shquara kombëtare e botërore. Akademiku dhe historiani i njohur Kristo Frashëri dhe mjaft historianë të tjerë të spikatur e kanë përcaktuar Dibrën dhe Çidhnën si vendlindjen e Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, kurse Prof. Dr. Shaban Sinani gjatë një interviste që i ka dhënë autorit të këtij libri thotë se "Dibra, është qarku më pjesmarrës më 28 nëntor 1912. Po ashtu thotë se "Ndoka i parë" del në fillimet e këngës historike (para se të kishte këngë për Ali pashën)".

Për qëndresën ndaj pushtuesit dhe sidomos ndaj regjimit komunist, fshatit Blliçe gjatë një cermonie të zhvilluar më 30 prill 2015, iu dhurua Urdhëri i Lartë "Nderi i Kombit" nga presidenti i Republikës z. Bujar Nishani në shenjë vlerësimi të lartë dhe respekti të thellë për qëndresën e pamposhtur ndaj diktaturës mizore gati 50 vjeçare komuniste...". Të gjitha këto dhe shumë ngjarje e figura të rëndësishme në Dibër, Blliçe dhe në Çidhën janë pasqyruar gjerësisht në këtë libër. Libri hapet me intervistën që autori Mentor Hoxha i ka marrë studiuesit të njohur Prof. Dr. Shaban Sinani, i cili jep një panoramë të shkurtër historike mbi ngjarjet dhe figurat më të spikatura të trevës dibrane. Në këtë intervistë, ndër të tjera ai thotë:

*"Historia e Dibrës nuk bëhet më me tregime alegorike dhe me fjalë "nën mutaf". Në shoqëritë e hapura këto janë ligjërime paraurbane. Historia e Dibrës nuk bëhet më as me çifteli, as me lahutë, sepse e vërteta e saj gjendet në arkiva, në kujtesën e shkruar. Aty shihet dhe si na kanë vlerësuar të tjerët, dhe kjo, pikëpamja e tjetrit, e bën të vërtetën bindëse. Parimi i sotëm i dijes është ta shohësh veten "between the mirrors of others": përmes pasqyrave të tjetrit".*

Nga ky postulat i studiuesit të nderuar është frymëzuar dhe bazuar autori në sendërtimin e lëndës historike të këtij libri me parametra të admirueshëm shkencor. Për ta bërë sa më të saktë dhe sa më të besueshëm këtë studim, autori ka gërmuar për tre vite radhazi në Arkivin Qendror të Shtetit Shqiptar dhe në atë të Bibliotekës Kombëtare. Ka shfletuar të gjitha gazetat e periudhave kur janë zhvilluar ngjarjet historike, si dhe të gjitha studimet historike të historianëve elitarë brenda dhe jashtë Shqipërisë që kanë shkruar për trevën dibrane. Autori flet me gjuhën e dokumentave historike, por njëkohësisht mban edhe qëndrim kritik ndaj disa figurave dhe ngjarjeve të pakëndshme që kanë ndodhur në trevën dibrane përgjatë gjithë historisë njerëzore. Në libër ka dokumente historikë që bëhen të njohur për herë të parë.

Ky libër përshkruan historinë e trevës dibrane nga parahistoria deri në vitin 1944 kur Shqipëria u çlirua nga nazifashistët dhe drejtimin e saj morën komunistët shqiptarë të drejtuar nga Enver Hoxha. Libri na njeh me banorët e parë të trevës dibrane, të cilët kanë banuar në Kronëza të fshatit Blliçe dhe në Burim të Maqellarës. Na njeh me të gjitha epokat e Gurit dhe të Periudhës së metaleve në trevë, me të gjitha epokat historike dhe figurat më të ndritura të tyre deri më 1944. Po ashtu jep emrat e të gjithë martirëve të rënë në mbrojtje të trojeve dibrane dhe atyre shqiptare.

Gjithë lëndën historike të këtij studimi e përshkon objektiviteti historik dhe korrektësia në pasqyrimin e ngjarjeve dhe përshkrimin e figurave historike nga Blliçja, Çidhna dhe Dibra.




**"Ky është vetëm një gur në themelin historik të vendlindjes sime, të cilët kanë filluar ta ndërtojnë historianë të tjerë para meje dhe të tjerë do vazhdojnë t'i lartësojnë dhe përjetësojnë muret e saj të ngjizur nga gjaku i martirëve dibranë, të forcuar nga tallazhet dhe rrebeshet e shekujve, të djegur nga baruti i armëve, të shpuar nga tehu i shpatave dhe i plumbave të shumtë të derdhur mbi të.**

Pjesën më të madhe të këtij libri e zë historia e Blliçes dhe e Çidhnës (fshati dhe zona ku lindi dhe u rrit autori), por edhe si ndër më të njohurit dhe më të spikaturit në historinë mijravjeçare të trevës dibrane.

Libri është ndarë në shtatë kapituj: Kapitulli I: "Blliçja, Nderi i Kombit Shqiptar"; Kapitulli II: "Blliçja, Çidhna dhe Dibra në histori"; Kapitulli III: "Parahistoria dhe qytetërimet e para në Blliçe dhe në Çidhën"; Kapitulli IV: "Çidhna, Vendlindja e Principatës së Kastriotëve dhe e Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu"; Kapitulli V: "Çidhna dhe Dibra nga vdekja e Skënderbeut deri në në Shpalljen e Pavarësisë"; Kapitulli V: "Nga Pavarësia e Shqipërisë deri në çlirimin përfundimtar nga serbët"; Kapitulli VII: "Çidhna dhe Dibra nga çlirimi nga serbët deri në pushtimin nazifashist dhe kapitulli VIII: Çidhna në Luftën Antifashiste Nacional-Çlirimtare.

"Kapitulli VIII ka qenë dhe pjesa më e vështirë, - thotë autori, pasi është një periudhë tepër e ndjeshme, por edhe mjaft kontradiktore. Dy nga ngjarjet më të rëndësishme historike të kësaj periudhe janë dy betejat më të ashpra luftarake që u zhvilluan në Fushë-Alije midis forcave partizane dhe atyre nacionaliste të komanduar nga Halila Alia. Në këtë luftë pati shumë të vrarë nga të dyja palët. Triumfi i komunistëve dhe qëndrimi i gjatë i tyre në pushtet u shoqërua me reprezalje në zonë dhe manipulim dhe denigrim të pjesmarrësve nacionalistë në këto beteja. Për të qenë sa më korrekt me historinë, autori i ka parë këto ngjarje nga tre burime të pavarura nga njëri-tjetri.

Ndonëse ky studim i mirëfilltë shkencor ngërthen në linja kryesore gjithë historinë e Dibrës, të Çidhnës dhe të Blliçes në të gjitha epokat e historisë njerëzore, autori Hoxha nuk pretendon se me këtë libër përmbyllet historia e tyre, ndaj ai shprehet:

"Ky është vetëm një gur në themelin historik të vendlindjes sime, të cilët kanë filluar ta ndërtojnë historianë të tjerë para meje dhe të tjerë do vazhdojnë t'i lartësojnë dhe përjetësojnë muret e saj të ngjizur nga gjaku i martirëve dibranë, të forcuar nga tallazhet dhe rrebeshet e shekujve, të djegur nga baruti i armëve, të shpuar nga tehu i shpatave dhe i plumbave të shumtë të derdhur mbi të. Kjo është një dhuratë për të gjithë blliçjanët, çidhnakët dhe dibranët, një dhuratë e përgatitur me shumë kujdes, mund dhe netë të tëra pa gjumë. Një dhuratë që mu deshën plot tre vite për ta përgatitur dhe shumë para për ta deshifruar. Këtë dhuratë ua kisha borxh paraardhësve të mi, brezave të sotëm dhe atyre atyre që do vijnë. Duke mos patur aq para sa t'u ndërtoja atyre sheshe, shkolla, parqe apo monumente kulti, duke mos patur post qeveritar apo mandat deputeti tu hap vende pune për të mos u larguar në emigrim, zgjodha këtë dhuratë që ta kenë pranë në çdo kohë dhe në çdo vend brenda dhe jashtë Shqipërisë. Mua, Zoti nuk më dha para dhe poste qeveritare, por më dha mendjen dhe penën, të cilën këtë herë e vura me shumë dëshirë në shërbim të historisë së vendlindjes sime që ajo të ngelet përjetësisht në memorien e historiografisë shqiptare, që brezat e sotëm dhe të nesërm të njihen me historinë dhe figurat e ndritura, por edhe të urryera të trevës së tyre. Padyshim, që këtë kështjellë te ngritur me aq mund e sakrifica do mundohen ta rrënojnë dhe ta basardojnë njerëz të lig, por të gjithë ne duhet ta ruajmë me shumë kujdes dhe t'ua mëkojmë me shumë dashuri brezave të sotëm dhe të nesërm. Gjatë një intervistë me mua Prof. Dr. Shaban Sinani u shpreh: *"Ajo që dua të them është se Dibra, ku shpesh thuhet se "ka pushuar mendja"; Dibra dhe dibranët pra, duke qenë më konvergjentë dhe më kalorësiakë me njëri-tjetrin, siç kanë qenë në histori, që i janë përgjigjur nderit me nder dhe jo inatit me inat, kanë mundësi të bëjnë shumë më tepër për njëri-tjetrin, duke e bërë mendjen më të lirë".*

Redaktor i këtij libri është Agron Tufa, kurse recenca është bërë nga Flori Sllatina, gazetar. Libri është mjaft cilësor, përmban 520 faqe dhe mbi 1000 referenca nga Arkivi Qendror i Shtetit Shqiptar dhe nga historianët dhe studiuesit më elitarë nga Dibra, Çidhna dhe Shqipëria

"Në vëllimin e dytë që do të publikohet pas pak kohësh, thotë Mentori, vendin kryesor do ta zërë historia e Blliçes, Çidhnës dhe e Dibrës dhe figurat e spikatura të saj nga vendosja e regjimit komunist më 1944 deri më sot. Këto libra janë botuar me shpenzimet e mia. Megjithëse Blliçja, Çidhna dhe Dibra ka me dhjetra biznesmenë të spikatur, askush nuk është afruar për të sponsorizuar historinë dhe figurat më të spikatura të vendlindjes së tyre, ndërkohë që kanë sponsorizuar plot libra fisesh dhe monografi të zonave të tjera pas patur asnjë lidhje me ta. Le të shërbejë pra kjo monografi historike si pasaporta e lavdishme për të gjithë blliçjanët, çidhnakët dhe dibranët e ndershëm kudo që ndodhen, por edhe si një ftesë reflektimi për të biznesmenët e kësaj treve sa të lavdishme aq dhe të nëpërkëmbur dhe të përbuzur".

Mentor Hoxha është autor i 11 librave të gjinive të ndryshme letrare. (poezi, studime, intervista). Gazetar dhe redaktor në disa media të rëndësishme shqiptare. Diplomuar për Gjuhë -Letërsi në Universitetin Shtetëror të Tiranës. Mban titullin mësues i gjuhës dhe i letërsisë shqipe për shkollat e mesme. Ka mbaruar shkëlqyeshëm Masterin Shkencor për "Studime letrare". Ka kryer edhe disa kualifikime pasuniversitare në Angli për mësuesi dhe gazetari.




## Jehona e Shpirtit

*Pas botimeve të herëpashershme në shtypin periodik, fitues e çmimit të dytë në konkursin poetik të personave me aftësi të kufizuar në Durrës 2015, poeti Përparim Luca vjen me vëllimin poetik "Jehona e Shpirtit", me redaktor Ilmi Dervishi dhe me një parathënie të poetes Adivie Hoxha.*

### *Fati im*

E ndoqa nga pas fatin tim,
Nëpër dëshirat e mia derdhur
E sot dua t'ju them,
Ende, ende s'i kam mbledhur...

Fati im kaq i vogël,
Fati im i madh shumë,
Kam familjen mbushur plot,
S'e ndërroj me krejt botën.

Me shpirtin të mbushur
I gëzohem dhe këtij fati,
I lumtur në vendlindje,
Këmbët te Drini, koka te Prati...

### *Biri i Dardhës Rasim Shira*

E ku je, more biri i Dardhës,
Ti ma çove zemrën peshë,
Ti ke rrjedhjen nga Korabi,
Përballë teje unë s'po hesht...

Në këto shpate ballë-përballë
Bën kuvend dhe shpirti im
"Qytetar nderi" në Zalldardhë
Madhështor ai takim.

Nuk peshohet mirësia jote,
Kur vlerës i jep krahë,
Je, në thellësitë e shpirtit im,
Ty, të kam shtatë herë vëlla.

Kuvend bëjnë bijt' e Dardhës,
E mes tyre je dhe ti,
Krenarohemi për njerëz të mirë,
Ndaj të shkrova këtë poezi.

### *E dua botën...*

Krejt hapësira me brenga e gëzime
Kanë vend në shpirtin tim
Në më sjelltë ndonjëherë hidhërime
Përsëri jam në kuvendim...

E dua botën që më rrethon,
Siç dua dhe botën time,
Brenda saj lumturi kërkoj,
Siç kërkoj dhe frymëzime.

E dua gjithçka në botë, vërtet,
Siç jam dhe unë pjesë e saj,
Mes baticave e zbaticave,
Rriten ditët e jetës sime, pastaj...

portret

Agim Lleshi është një anëtar i komunitetit dibran në Amerikë, ku me sjelljen dhe punën e tij nuk nderon vetëm familjen dhe Dibrën, por gjithë shqiptarët.

# Agim Lleshi - rruga e vështirë e kurbetit

*Nga* **BEQIR SINA** – *New York*



**Një numër i madh i ndërtesave në Nju Jork, në të 5 qytetet (Five Borough) sot mbajnë vulën e një ndërtimi të suksesshëm nga kompani shqiptare.**

**Agim Lleshi ka dëshmuar se shqiptarët e Amerikës, me punë, ndershmëri dhe përkushtim punojnë për të pasur sukses, edhe në fushat që shumë njerëz mendojnë që janë të paarritshme e të vështira.**

Agim Lleshi - veprimtar dhe biznesmen nga Dibra e Madhe në SHBA- tregon se si erdhi në Amerikë dhe se si kishte vendosur të hyjë në industrinë e ndërtimit dhe rregullimit të çative për të arritur të krijojë një biznes të suksesshëm me pasuri të mirë.

Tre dekada më parë - ai pasi kishte lënë vendlindjen në kohën më të vështirë - kur shqiptarët nën të ashtuquajturën "Jugosllavi", përndiqeshin, keqtrajtoheshin dhe shikoheshin nga regjimi titist si njerëz të "dorës së dytë apo të tretë", vetëm e vetëm se kishin bërë një "faj" sepse ishin shqiptarë, si shumë të tjerë, edhe Agimi mori rrugën e kurbetit - për të gjetur ëndrrën Amerikane.

Megjithëse, si çdo shqiptar që e ka marrë këtë rrugë, ai kaloi në vështirësi duke e gjetur veten në një udhëkryq, por ai nuk u dekurajua, as u bë pishman, si i themi ne shqiptarët, sepse duke punuar Agimi dhe me ndihmën e njerëzve të tij në Amerikë, ai mbas disa viteve punë - do të kishte edhe një biznes të tij. E cila, siç duket, ishte zgjedhja më e mirë për jetën e tij dhe të familjes duke i sjell rrugën drejt suksesit dhe pasurisë.

Agim Lleshi ka sot një kompani të fortë, All - Roofing, të cilën ai e administron së bashku me dy djemtë e tij, Xhevdetin dhe Valonin, kompani kjo ku ka të punësuar me dhjetëra punëtorë dhe që të gjithë janë shqiptarë.

Rruga e karrierës së Agimit natyrisht që ka qenë vështirë, por ndihma e të afërmeve të tij që kishin ardhur para tij në Amerikë - dhe merreshin me këtë lloj biznesi ia bënë pak më të lehtë atë...

Agim Lleshi - nuk është i vetmi shqiptar i suksesshëm në industrinë e ndërtimit dhe rregullimit të çative, sidomos, te dibranët e Amerikës, që janë "mbretërit" e ndërtimeve dhe rregullimit të çative në Nju Jork dhe që shquhen në këtë lloj biznesi me pasuri që arrin miliona dollarë dhe mjaft të suksesshëm.

Një numër i madh i ndërtesave në Nju Jork, në të 5 qytetet (Five Borough) sot mbajnë vulën e një ndërtimi të suksesshëm nga kompani shqiptare me pronarë shqiptar nga Shqipëria, Kosova dhe viset shqiptare, përfshirë këtu edhe kompaninë All - Roofing të Agim Lleshit.

Ato me krenari shfaqin arritjet e shqiptarëve të Amerikës, të cilët e kanë arritur këtë sukses vetëm me punën e tyre.

"Ndershmëria dhe përkushtimi në punë gjithmonë shpaguhen", thotë ai duke provuar të kujtojë fillet e suksesit të tij. "Shqiptarët e Amerikës, shton ai, vetëm me këtë kanë arritur majat e suksesit. Ata, jo më kot zgjodhën Amerikën, u "gjendën këtu në kohën dhe vendin e duhur për të bërë gjëra të suksesshme, pra për të bërë një jetë më të lumtur dhe histori suksesi ", rrëfen Agimi.

Agimi me dy djemtë drejton kompaninë All - Roofing në mënyrë efikase dhe është i lumtur që ka arritur deri këtu, duke u bërë i dobishëm për vete dhe familjen, por edhe për komunitetin shqiptar.

Ai vazhdon të kontribuojë me kompaninë e tij dhe në ndihmat që jepen për Kosovën dhe shqiptarët në Maqedoni, Luginën e Preshevës, dhe Mal të Zi, fushatat elektorale për në kongres, senat dhe president të SHBA, dhe ndihma humanitare. Gjithmonë është parë si një njeri që dëshiron të tregojë veten si familjar dhe atdhetar.

Agimi ka dëshmuar se shqiptarët e Amerikës - komuniteti shqiptar, me punë, ndershmëri dhe përkushtim - punojnë për të pasur sukses, edhe në fushat që shumë njerëz mendojnë që janë të paarritshme më parë, dhe shumë të vështira.


"Mbas ngjarjeve të 1981 - demonstratat e para, që tronditën nga rrënjët "perandorinë komuniste" në Ballkan, atë sllavo - komuniste, të asaj kohe - nis rrëfimin mbi jetën e tij, për gazetën tonë.

Agim Lleshi, thotë se ka kryer ushtrinë - dhe, i detyruar nga shkaqe politike dhe ekonomike të asaj kohe, arratiset nga ish Jugosllavia, e cila mbas shpërbërjes së saj, nuk egziton më, dhe, doli në Itali në botën e lirë, ku qëndroi 9 muaj dhe më pas erdhi në SHBA".

"Mbas nëntë muajve, në mesvitin e 1983-shit, deri sa u përgatiten edhe dokumentet e emigracionit , erdha në SHBA, së bashku me djalin e xhaxhait tim Ylber Lleshin.

Agimi rrëfen sot mbas 32 vjetëve edhe shkaqet të cilat e shtynë atë të marrë largohet nga vendlindja, Dibra e Madhe, vendin për të cilin të parët e tij luftuan dhe sakrifikuan, duke i mbrojtur nga sllavët, serbët dhe maqedonasit

"Kur ne ikëm - ishte gjendja e trubullt në Jugosllavi. Unë isha 21 vjeç, ish student i përndjekur - sidomos, për shkak të demonstratave të 1981 - ku të gjithë shqiptarët filluan të ndiqeshin dhe maltrajtoheshin brutalisht nga policia dhe forcat militare. Jeta ishte në rrezik dhe aspak e sigurt për çdo shqiptar, si në Kosovë, por e njëjtë edhe në vendbanimet e tjera shqiptare, si në Maqedoni, Mal të Zi dhe Luginën e Preshevës, dhe natyrisht edhe në Dibër të Madhe.



Në kohën, që dola në Itali, u takova me dajën tim Fiqiriun, i cili më ndihmojë sadopak, si fillestar në kampet e emigrantëve në Latina, dhe me shqiptarë të tjerë, edhe ata të larguar politikisht nga Kosova, Shqipëria dhe trojet shqiptare.

Katër vjet mbasi erdha në Shtetet e Bashkuara - në moshën 25 vjeçare, fati e solli që edhe të martohem. Mbasi fitova statusin e emigrantit politik - shkova në Dibër dhe u fejova me Gonxhe Markun gruan me të cilën kemi pasur një jetë të lumtur . Tani kemi dy fëmijë, thotë, ai, Valonin 27 vjeç dhe Xhevdetin 25 vjeç - që të dy të mrekullueshëm - të edukuar, dhe të zgjuar, të dashur dhe atdhetar pa asnjë ves të keq deri tani. Megjithëse kanë lindur në Amerikë dhe shkolluar këtu ata flasin shumë bukur gjuhën shqipe".

Për ardhjen në Amerikë, Agimi, tregon se jeta e tij këtu, nuk ka qenë shumë e lehtë - ashtu si dhe çdo emigrantë, i cili duhet të punojë madje shumë për të ndërtuar një jetë të mirë.

"Kam punuar në ndërtimtari dhe rregullimin e çative - Roofing - nisë e tregon Agimi, isha shofer në një kompani shqiptare me pronar Turan Rusin - deri sa fitova eksperiencën dhe mblodha para për të hapur një biznes, të cilin e kam edhe sot e kësaj dite. E nisa në 1994 me disa mijëra dollar, por tani 2015 ka vlerën e disa milionave dollarëve dhe është biznes i suksesshëm", tregon Agim Lleshi. Mirëpo, thotë ai gjatë bisedës, gjej rastin që t'i falënderoj me këtë rast për suksesin tim në biznes, familjen e njohur Rusi, e cila më dha "dorën" dhe më bëri të hedh hapat e parë në punë dhe përvojë, për tu bërë më pas edhe një biznesmen i suksesshëm në Amerikë. Por, edhe xhaxhait tim Ejupit dhe djemve të xhaxhait Gazmendit, dhe Zimi Lleshit.

Gjatë 32 vjetëve në SHBA- Nju Jork Agimi ka qenë aktiv në shoqatat dhe organizatat atdhetare, deri sa u krijua Shoqata Atdhetare Dibrane, dhe ka marrë pjesë në aktivitetet dhe veprimtarit kombëtare në Nju Jork e Ëashington si dhe ka dhënë donacione për luftën në Kosovë dhe atë në Maqedoni sa herë i është kërkuar. Gjithashtu, ka dhënë donacione në fushatat për President, senator dhe kongresmenë dhe donacione të tjera humanitare.

Agim Lleshi është një anëtar i komunitetit dibran në Amerikë, ku me sjelljen dhe punën e tij nuk nderon vetëm familjen dhe Dibrën, por gjithë shqiptarët.

...është koha për t'u pajtuar...

KONTRIBUO PER GAZETEN
merr kopjen tende
email: rrugaearberit@gmail.com

vetëm 600 lekë në vit

Rruga e Arbërit nr. 115

Shkëputur nga libri i Naim Plakut
"Krojet e zanave"

traditë

# **Dasma** dibrane një **spektakël** i mrekullueshëm

*(Vijon nga numri i kaluar)*

*7. Grishja*. Grishja e dasmorëve është bërë me fjalëtorë, me të dërguar të posaçëm, të cilët quheshin *grishtarë, grishës, thirrmorë*. Grishja bëhej dy ditë para dasmës, pra, të premten ose të hënën, ndryshe ajo nuk merrej parasysh, quhej *fjalë rruge*. Kjo bëhej për njerëzit që kishin marrëdhënie gjaku ose miqësie me të zotin e dasmës. Ishte zakon që në dasmë të thirrej gjithë fshati, si fqinj të një komuniteti, por këta thirreshin ndryshe, jo me grishtarë. Në çdo oborr shtëpie dërgoheshin ustallarët, pra lodra e cula, që, pasi u binin veglave muzikore e dariteshin diçka, largoheshin. Kjo ftesë ishte e pranueshme, *sepse i ishin rrahur lodrat te dera*. Grishja duhej kuptuar familjarisht. E tillë ishte dhe pjesëmarrja, pra, burra e gra, të rinj e të reja dhe fëmijë. Dasma e kujtdo ishte një festë masive në katund. I madh e i vogël merrte pjesë lirshëm në valle, në këngë e lodra. Mënyra e grishjes ishte shumë origjinale: *Ke të fala nga N! Veni drynin shtëpisë! Mbylle avllinë e hajde në dasëm!* Këto grishje tregonin se nuk kufizonin pjesëmarrjen. *Ke të fala nga N! Të vish me shkop në dorë!* Kjo nënkuptonte se i ftuari nuk kishte asnjë detyrim për ftesën, por shpërblimet dhe dhuratat e ndryshme janë praktikuar gjithmonë. Nuk grisheshin në dasmë ata bashkëfshatarë me të cilët kishte hasmëri ose ndonjë mosmarrëveshje serioze. Mosgrishja konsiderohej jo vetëm një fyerje, por edhe një gjendje e acaruar. "*Jemi nda për dasëm e mort*"- thuhej për një mospajtim serioz, që kishte një shkak të fortë dhe si i tillë vlerësohej e peshohej mirë.

*8. Nata e dajave.* Ishte e shtuna ose e mërkura në mbrëmje. Është quajtur kështu, sepse këtë natë grumbulloheshin dajat, me ardhjen e të cilëve dasma kulmonte dhe merrte një karakter tepër festiv. Por këtë natë nuk vinin veç dajallarët, por dhe miqtë e të ftuarit e veçantë, si edhe farefisi. Dajat sillnin *dhantinë e tyre,* deshë, cjepë, por edhe mëzetë e qé, kur ishte fjala për një dasmë të rëndësishme. Katundi i tëri mblidhej e festonte. Dajat hynin në katund solemnisht, me kuaj shale, me dhantinë përpara e me të shtëna pushke. Ata priteshin me nderime të veçanta nga farefisi e familjarët e dhëndërit. Grupe grash e vajzash dilnin në kodrina dhe këndonin këngët e përshëndetjes. Në oborr ose në një vend afër shtëpisë dajat e hallat, nisnin vallet e këngët e tyre. Por edhe të tjerët kërcenin e këndonin bashkë me to. Pasi pinin kafen ose sherbetin, hynin në konaqet që ishin rezervuar posaçërisht për ta, burrat veç e gratë veç.

*9. Këngët e Bajrakut. Nisja e krushqve për të marrë nusen.* Është një moment tjetër i rëndësishëm i ceremonialit të dasmës dibrane. Krushqit, sipas marrëveshjes që është bërë me mikun, ose shkonin *me të numëruar,* ose shkonin sipas dëshirës, *pa numërim*. Por ata që hynin në konakun e mikut, qoftë për bukë, qoftë për kafe, ishin të numëruar 7,9,11, etj. Kur nusja ishte brenda katundit ose në një katund të afërt, shkonin krushq të gjithë ata që kishin dëshirë. Krushqit merrnin me vete dhe kuaj të zbukuruar me sexhade, shami e lule që hijeshonin shalën ose samarin e kalit dhe shoqëroheshin nga ahengxhinjtë, të cilët quheshin dhe *ustallarë*. Lodra e cula ishin të domosdoshme gjatë gjithë rrugës. Cula e Dibrës dallohej prej të tjerave, sepse kishte zë më kumbues e dëgjohej pesë km larg. Siç më ka dëshmuar një nga culaxhinjtë më virtuozë, Halil Kurtashi, culat ai i porosiste posaçërisht në Izmir të Turqisë, sepse vetëm ata i kandisnin siç duhet dasmorët. Ata pushonin vetëm në afërsi të varrezave dhe, kur hynin në katund, vepronin sipas porosive të mikut. Zakonisht bëhej aheng në një lëndinë jo shumë afër shtëpisë së nuses. Melodité i kishin të radhitura sipas një programi të detyruar: melodi në udhëtim, melodi në të gjitha ritualet e dasmës, që mbylleshin me atë të nxjerrjes së dhëndërit nga kuri dhe të përcjelljes së dajallarëve, që ishte dhe prologu i dasmës.

*10. Dhëndëria e nusëria*. E shohim të nevojshme për të dhënë diçka nga ky moment. Djali bëhej dhëndër në momentin që krushqit niseshin për të marrë nusen, ndërsa nusja bëhej gati që në mëngjesin e ditës së martesës. Dhëndëri



© *Dasma dibrane, pikturë nga Zaim Elezi, (Zaya)*

nuk shkonte të marrë nusen, por e priste në shtëpinë e tij. Në këtë kohë ai vishej me rrobat e dhëndërisë, që ishin zakonisht kostumi tradicional i burrave: tirq të bardhë me gajtanë të zinj, jelek i qëndisur me fije ari, kuparane, çorapë mjediskame, të leshtë e të qëndisur në mes me penj të ngjyrosur, kundra (këpucë) të mira, kësulë të bardhë, këmishë të bardhë e të qëndisur. Nusja kishte veshjen e traditës sipas krahinave, sepse Dibra ka pasë rreth 13 lloje veshjesh grash, por që mund të përmendim xhupin, poshterkën, jelekun, xhurdinën, përparëset, rizat me ojna, vathët, parzmoret, brezin, etj. Djali hiqte flokët, lahej, vishej e dilte në mejdan i shoqëruar nga këngët e vajzave, të cilat kishin dhe nota melankolike, sepse shprehnin ndarjen përgjithmonë nga beqaria. Ai do të niste jetën e re me bashkëshorten.

*11. Marrja e nuses. Dalja nga shtëpia prindërore*. Edhe ky është një moment i veçantë që përcillet nga rite e këngë. Nusja del e shoqëruar nga gra ose vajza që janë të një gjaku me të. Fillimisht ato qëndrojnë te pragu i shtëpisë dhe njëra prej tyre që qëndron në krah të saj, merr peshqeshet në të holla ose *që quhet hyrja në dorë,* ku marrin pjesë ata që dëshirojnë t'i japin vajzës. Ky zakon tani është zbehur e praktikohet rrallë. Vajza-nuse përshëndetet me të afërmit e saj dhe vëllezërit ose kushërinjtë e vendosin në kalë ose e në makinë. Më parë, ajo mbulohej me duvakun e kuq, pastaj me një vello e sot me fustanin e bardhë të nusërisë, por kur udhëton me makinë. Kalin e tërhiqte i vëllai ose një nga më të afërtit e saj, i shoqëruar edhe me të tjerë, zakonisht djem të rinj. Krushqit qëndronin diku larg dhe bënin aheng me masë që të mos i irritojnë miqtë, që po nxjerrin nga shtëpia një pjestar të familjes. Dikur përcjellësit e dërgonin vajzën gjer në shtëpinë e dhëndërit, e futnin në dhomën e saj, e mbështetnin për muri dhe ia dorëzonin vjehrrës, e cila bënte që në hyrje, sa të shkelte në shtëpi, ritet e saj.

*12. Ardhja e nuses, mbërritja në shtëpinë e dhëndërit*. Është një moment shumë gazmor dhe shoqërohet me këngë e valle, që kur duket karvani i krushqve që po sjell nusen. Vajzat grumbullohen grupe-grupe, këndojnë e vallëzojnë horas, burrat e moshuar dalin e presin krushqit, dhe, ndër ta, më të nderuar janë përcjellësit e nuses. Dhëndëri e shikonte nga një vend i fshehur, sa dukej nusja, duke ardhur nga larg. E vendoste syrin në rrethin e një unaze. Këngët *janë me karar, d.m.th. të matura që të mos preknin sadopak në sedër përcjellësit e familjen e nuses*. Ka ndodhur që në raste të tilla të pakontrolluara kanë ngjarë dhe mosmarrëveshje, zënka, deri në tragjedi. Nusja futej në oborrin e shtëpisë hipur në kalë. Njerëzit e tjerë largoheshin dhe mbeteshin vetëm përcjellësit dhe njerëzit më të afërm të familjes së dhëndërit, që në momentin e zbritjes e rrethonin nusen me çarçafë e sexhade, që të mos dukej derisa të futej në konakun e saj e t'i bëheshin *adetet*. Vjehrra dëshironte që t'i kapte frerin kalit e t'ia shkelte me këmbë, që shprehte mendimin e bindjes e nënshtrimit të nuses. Ndërsa i vëllai që mbante frerin, kërkonte me çdo mënyrë ta shmangte këtë, sipas porosisë që i ishte dhënë nga nëna e tij. Duke qëndruar në shalë të kalit *nuses i bëheshin disa adete*. I vendosej në prehër një djalë *(që të lindte djem*), tre kuleçë gruri të mbështjellë në bohçe të bardhë *(simbol i pjellorisë e bardhësisë në jetë)* dhe tri lakra të shkulura me rrënjë nga kopshti *(si simbol i vazhdimësisë së jetës dhe i pjellorisë)*. Rrugën gjer në ngjitje e spërkatnin më raki (*simbol e djegies së xhindëve e magjive të mundshme që i kishin bërë nuses).*

*13. Palesa ose Këngët e Divanit. Qëndrimi i nuses mbështetur për muri.* Kjo bëhej se shumica e dasmorëve, bile dhe dhëndri vetë, e njerëzit e afërt të familjes nuk e kishin parë e as e njihnin fare nusen. Edhe nëse e njihnin, donin ta shihnin, ta përshëndesnin e t'i vlerësonin bukurinë,

**Dalja nga shtëpia prindërore.** **Edhe ky është një moment i veçantë që përcillet nga rite e këngë. Nusja del e shoqëruar nga gra ose vajza që janë të një gjaku me të. Fillimisht ato qëndrojnë te pragu i shtëpisë dhe njëra prej tyre që qëndron në krah të saj, merr peshqeshet në të holla ose që quhet hyrja në dorë, ku marrin pjesë ata që dëshirojnë t'i japin vajzës.**

nusërinë, pajën, etj. Nusja rrinte mbështetur në mur, në një kënd sa më dukshëm, e rrethuar nga gra e vajza, por dhe nga farefis e miq të dhëndërit. Fillimisht ishte nën duvak ose ndën vello. Hynte dhëndëri dhe i shqepte duvakun me tytën e pushkës. Nusja shpaloste bukurinë e saj duke qëndruar symbyllur e me duar të lidhura në mes, para të pranishmëve. Këtu merrnin hov këngët, horet e vallet duke filluar nga ato të mbushura me lëvdata e hire gjer tek ato që e shpotitnin dhe e përqeshnin nusen e re, por që nuk ishin dashakeqëse, e bëheshin më tepër për humor.

*14. Mbyllja e dhëndërit me nusen në kur. Nata e kurit ose e Gjerdekut*. Mbyllja e dhëndërit bëhet në mbrëmje vonë. Nusja është në dhomën e saj të fjetjes e shoqëruar zakonisht nga motrat dhe vjehrra ose një grua tjetër e afërt që i bën "*adetet*", ritet. Në shtrat rrokullis tri herë një djalë, pastaj një kungull tri herë *(simbol i shëndetit),* e uron me zë të ulët, etj. Dhëndëri futet me kujdes në kur, sepse moshatarët e tij e kanë zakon ta godasin me shuplaka e grushta. Hyn dhëndëri dhe, ndërkohë, dalin motra e nëna duke e uruar. Ishte zakon më parë që dhëndëri i kërkonte nuses me një ton të rreptë t'i ndizte cigaren, t'i jepte ujë, t'i lante këmbët, t'i bënte shërbime të tjera për të treguar se ky është "burrë" dhe ajo grua që do të ishte në shërbim të tij tërë jetën.

*15. Zgjimi i dhëndërit*. Bëhej sa të dilte drita. Këtë e lajmëronin "*ustallarët*" (ahenxhinjtë), lodërtari e culaxhiu, të cilët merrnin meloditë karakteristike të zgjimit. Këto melodi i përsëritnin derisa dhëndëri të dilte dhe t'i dariste me ndonjë peshqesh ose të holla. Niste kënga e të rinjve dhe të rejave. Kishte dhe tallje e intimitete, përse ishte vonuar djali, mos e kishte fajin nusja që e joshte, mos ishte vetë fajtori, mos ishin të dy të plogët, etj. Pas kësaj vinte momenti i petullave. Më të afërmit e dhëndërit hynin në dhomën e nuses dhe e zonja e shtëpisë i gostiste me petulla e mjaltë. Ky ishte dhe një detyrim, sepse secili prej tyre do të vinte një sasi të hollash në tepsi. Këtë e shprehin dhe këngët.

16. *Përcjellja e dajave. Shpërndarja e dasmës*. Dajat nuk dalin nga konaku pa ngrënë mëngjes e pa u përshëndetur me ceremoni e këngë "që ta merrte vesh hallku, se dajat e kryen me sukses detyrën e tyre". Ashtu siç erdhën, ashtu dalin, burra e gra, të shoqëruar nga uatallarët, me lodër e cule. Mund të qëndronte në shtëpi ndonjë grua e vjetër, që merrte pjesë në ritet e nusërimit.


17. Nusërimi. Palesa ose Dita e Temenasë. Bëhej të hënën ose të premten. Pasi ishte shpërndarë dasma, nusja vendosej në këmbë diku në odën e saj mes pajës që kishte sjellë, një pjesë e së cilës varej në mur. Vinin ta vizitonin nuset e reja të fisit, por edhe të katundit, që kishin ardhur dy vitet e fundit të shoqëruara nga vjehrrat e tyre. Secilën që hynte nusja e re e përshëndeste me temena dhe njëra nga të familjes tregonte pajën. Nuset e reja, të veshura me rrobat më të bukura që kishin, radhiteshin në të majtë e në të djathtë të saj dhe bënin të njëjtën gjë. Ishte si një lloj konkurrimi. Vajzat i shoqëronin me këngë. Disa herë këngët kishin dhe humor e vargje tallëse.

histori

Kjo betejë (14 - 17 Nëntor 1912) pengoi të dilnin forcat serbe në Adriatik para shpalljes së Pavarësisë

# Beteja e Lumës - "Kaçaniku i dytë"

*Nga* **BEQIR SHEHU***




Në kohën kur kryengritja e përgjithshme shqipëtare e vitit 1912 po i jepte grushtet e fundit sundimit shekullor Osman dhe populli priste çlirimin dhe formimin e shtetit të pavarur shqipëtar, qarqet shoviniste të monarkive ballkanike, të ndihmuara dhe nxitura nga aleatët e tyre, sidomos nga Rusia, e cila synonte krijimin e një perandorie të madhe sllave, me dalje dhe në detin Adriatik, projektuan coptimin e tokave shqiptare dhe synonin të mos lejonin formimin e një shteti të pavarur shqipëtar. Për realizimin e këtij qëllimi, Sërbia, Mali i Zi, Greqia dhe Bullgaria në një marrëveshje të fshehtë midis tyre, nën kujdesin e Rusisë, formuan Lidhjen Ballkanike si instrument lufte për të realizuar pushtimin e tokave shqiptare që po i lëshonte Perandoria turke e mundur.

Në fillimet e muajt tetor 1912 filloi edhe Lufta Ballkanike: Mali i Zi, Serbia, Bullgaria dhe Greqia i shpallën luftë Turqisë. Veprimet luftarake qenë të menjëhershme. Më e uritura më e nxituara dhe më e ndihmuara nga Rusia ishte Sërbia. Në ditët e para të nëntorit, kryeministri sërb Pashiq i telegrafonte Komandës Përgjithshme të forcave serbe se: "Situata ndërkombtare është e favorshme për ne.....Sa më parë të dalim në Adriatik, meqenëse së shpejti do të filloi aksioni i përgjithshëm i fuqive europiane për ndërprerjen e luftës dhe fillimin e bisedimeve".

Në zbatim të planit strategjik të marrshimit drejt Adriatikut, Armata e Parë dh e Tretë e ushtrisë serbe të paisura me armët më moderne të kohës filluan marrshimin për pushtimin e tokave shqiptare e për të dalur në Detin Adriatik. Pasi pushtuan Prishtinën, Kumanovën e hynë në Shkup, me 30 tetor 1912 morën urdhërin për të pushtuar viset e tjera të Shqipërisë.

Kjo situatë tepër shqetësuese, vinte në një kohë kur akoma ishin të nxehta tytat e armëve të luftës sfilitëse tre vjeçare të popullit shqipëtar kundër pashallarëve turq, për të fituar lirinë e pavarsinë kombëtare. Tani, duhej të përballohej një luftë më e vështirë dhe me një armik më barbar, të armatosur mirë, e më të vendosur për realizimin e synimeve shoviniste që pretendonte. Në përgjigje të kësaj situate, në krye të forcave dalzotëse të kombit, në mbarë trevat shqiptare u vu Komiteti i Shpëtimit Kombëtar, ku bënin pjesë Hasan Prishtina, Mehmet Pashë Deralla, Bajram Curri, Sali Gjuka, Isa Buletini, Nexhip Draga, Ramadan Zaskoci etj., kryesishtë ushtarak shqiptar, së bashku me Organizatën Shoqëria e Zezë për shpëtim, të vendosur për mbrojtjen me çdo kusht të tokave shqiptare nga rreziku i pushtimit serb. Në zbatim të kushtrimit që doli nga mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit "Shpëtimi" në Shkup, me 14 tetor 1912, u organizuan kuvende dhe u përcaktuan detyra konkrete, për çdo krahinë. U ngritën besëlidhje për kushtrim e ndihmë midis krerëve e krahinave për të vepruar si një trup i vetëm në përballimin e rrezikut që po i kanosej vendit. Më 21 tetor 4000 burra lumjanë ku shquheshin bajraqet e Kalasë Dodës, të Topojanit e të Rrafshes Lumës u nisën për në verilindje të Kosovës. Drejt frontit të luftës marrshuan edhe bajraqet e Përdrinit, të Ostrozupit, të Hasit e Opojës. Mbi 10000 burra zunë pozicione në vijën mbrojtëse: Gryka e Carralevës, -Qafa e Dules –Lipushë. Luftimet ishin tepër të ashpra, por qëndresën heroike të shqiptarve e thyen armët moderne me të cilat ishte paisur ushtria sërbe sidomos artileria e lehtë dhe largimi i forcave turke të komanduara nga Baftjar Pasha, të cilat i lanë vetëm shqiptarët. Me 3 nëntor forcat e divizionit Shumadia hynë në Przren dhe me 5 nëntor në qytet u vendos komanda e Armatës Tretë serbe.

Me pushtimin e Prizrenit, komandanti i Divizionit Tretë serb, gjenerali Jankoviç, nisi rigrupimin e forcave për operacionin drejt bregdetit shqiptar. U krijua Divizioni Shumadia me 7 regjimente, me këmbsori, kavaleri, artileri, reparte vullnetare dhe reparte të komitës serbe. Këto forca do të pushtonin Lumën dhe, pasi të bashkoheshin me forcat e divizionit Morava që do të vinte nga Dibra do të vazhdonin operacionin drejt luginës së Fanit, të Matit e Shkumbinit për të dalur në Adriatik.

Fronti i qëndresës shqiptare i përqëndruar në Has, Lumë, Gorë e Opojë po punonte në të gjitha drejtimet për ti thënë ndal marrshimit të mëtejshëm të forcave serbe. Pas tërheqjes nga Gjakova, Rahoveci e Prizreni forcat shqiptare u ngjeshën në zonën e Opojës dhe të Lumës. Me forcat e Lumës u bashkuan edhe Isa Boletini e Bajram Curri të cilët u vendosën në zonën e Hasit për të mbrojtur Qafën e Prushit. Bajraqet e Lumës, me prijsit popullor Ramadan Zaskoci, Islam Spahia, Ramadan Çajku,Osman Lita, Qazim Lika, Sheh Sali Çaja së bashku me të gjithë bajraktarët formuan Këshillin e Luftës me qendër në Kolosian. Këtu do të vihej postëblloku i pakalueshëm për forcat serbe. Mbi 25000 luftëtar të forcave shqiptare ishin përqëndruar në pjerrësitë e maleve të Koritnikut e Pashtrikut, si dhe në malet e Sharrit e Korabit për të siguruar një vijë mbroitje sa më rezistente, dhe me objektiv edhe për të kundërsulmuar. Në kujtimet e Tafil Boletinit jepet një pasqyrë e qartë e përgatitjeve që po bënin krerët e Lumës për të pëballuar agresionin serb i cili kishte arritur në portat veriore të krahinës. Në beslidhjen mbarëkrahinore në Bicaj dhe në tubimet e fshatrave Kolosian, Ujmisht e Vasije mori pjesë edhe Isa Boletini i cili këshilloi për lënjen menjëanë të hasmërive, për shmagjen e mosmarrëveshjeve, për lidhje mes katundeve e krahinave, se vetëm duke qenë të bashkuar mundë të përballohet kjo " mortajë e zezë" që po rrezikonte vendin dhe jetën e fëmijve tonë.

Me 10 nëntor, Luma, sulmohet frontalisht nga 16 mijë forca serbe të paisura me armët më moderne të kohës, me artileri e kavaleri, kryesisht armatim francez. Beteja e parë e përgjakshme u zhvillua në Qafën e Zhurit dhe në grykën e Morinit, ku armiku pati humbje serioze, por arriti të futet në Rrafshen e Lumës dhe 12 batalione arritën deri në Bicaj.

Me 14 nëntor,kur forcat serbe do të marrëshonin drejt Qafës Kolosianit për të dalur në Kala të Dodës, komanda serbe u informua "Se rreth 2000 shqiptar të armatosur ishin pozicionuar në formë patkoi duke harkuar mbi pozicionet serbe poshtë Qafës Kolosianit, nga lindja e perendimi" Ky informacion për forcat armike ishte vetëm një pjesë e së vërtetës, pasi Këshilli i Luftës i vendosur në Kolosian kishte përgatitur një vijë mbrojtje të pakalueshme për forcat serbe.

Duke u nisur nga pëvoja e luftës me Xhavit Pashën në vitin 1909 ku pozicioni më i përshtatshëm strategjik për mbrojtje ishte Qafa e Kolosianit, dhe sulmin e Dervish Pashës në tre drejtime për të hy në Lumë, në vitin 1910, krerët e Lumës morën masa për të siguruar Grykën e Vanave, Shkallën e Keqe e Lakun e Darzës nga lindja si dhe tër gjatësinë e Ujit të Lapave, nga jugu. Forcat kryesore që do të hynin në betejë, rreth 3000 luftëtarë, u vendosën në dy skaione: Skalioni i parë u vendos duke filluar në faqen perendimore të Gjalicës, në Theth, në Lakun e Darzës, në Qafën e Kolosianit, në Kodrat e Gabricës e në Dri të Zi. Në një thellësi 2-3 km u pozicionuan luftëtarët e skalionit të dytë, në gjatësinë që shkonte nga Mali i Limthit - Qafa e Reskut - Qafa e Drajes – e në Dri të Zi. Qendra e prapavijës së skalionit parë u vendos te Gurra e Kolosianit. Shtabi kryesor i luftës u vendos në Qafë të Kolosianit, në majën e quajtur Tabe, nga ku shikoheshin pothuaj të gjitha vendet ku ishin vendosur në mbrojtje luftëtarët lumjanë dhe e gjith Rrafshi i Lumës që do të kthehej në arenë luftimesh. Forcat kryesore mbrojtëse e goditëse në Qafën e Kolosianit përbëheshin nga malësorët e gjashtë Bajraqeve të Lumës. Me 13 nëntor arriti në Kolosjan edhe legjendari Elez Isufi me malësorët e Reçit e Dardhës, icili i'u bashkua Këshillit drejtues të luftës. Me Elez Isufin erdhi edhe oficeri i artilerisë Cen Daci i cili me dy topat që solli, të cilët i'a kishin mbajtur në Kala të Dodës ushtrisë turke,do të bëhej tmerri i artilerisë serbe.

Duke menduar për një sulm të mundshëm në front të gjërë të forcave serbe,krerët e Lumës në marrëveshtje me krerët e Hasit e të Opojës, vendosën për një vijë mbrojtje, që do të fillonte nga pjerrësitë perendimore të Malit Sharrit në Grykën e Llapushnikut, e cila do të mbrohej nga Opojas, Goranë e Topojanas, nën drejtimin e Qazim Likës, dhe nga Drini i Bardhë e deri në Qafën e Prushit që do të mbrohej nga Hasianë me kryeprijës Rexh Ali Bajraktarin.

Komanda e përgjithshme e grupimit, tanimë me Lumjanë e Dibranë, me Ramadan Zaskocin, Elez Isufin, Islam Spahin e Ramadan Çajkun u vendos në Kolosian.

Mëngjesi i 15 nëntorit i gjeti luftëtarët Lumjanë e Dibranë në prita e llogore. Çastet e ankthit që përjetoheshin ato orë mëngjesi, para fillimit të betejës, i përshkruajnë më se realisht, vargjet e këngës që populli ka thurur për këtë betëjë:

*"Kolosjani shtatëdhjet shtëpi,*
*mbanin hutat bitim në sy".*

Të dy palët synonin befasinë. Armët ishin të mbushura. Llogoret si mbanin më luftëtarët. Pritej vetëm sinjali i sulmit. Ramadan Zaskoci, komandant dhe luftëtar në dhjetra beteja, nga Tabja ku ishte vendosur Shtabi i Luftës, hodhi sinjalin e goditjes mbi forcat e aradhës serbe që po ngjiteshin drejtë Qafës Kolosjanit. Ibrahim Zeqir Gjorgji, Bajraktari i Radomirës, i pari u hodh në sulm dhe mori nderin e pavdekshmërisë si dëshmor i parë i kësaj beteje legjendare. Pushkë e flakë nga Qafa e Kolosjanit deri në Kullën e Lumës. Tabe në tabe, gurë në gurë, lagje në lagje, shtëpi në shtëpi, kudo thirrje: - A besa besë burra për Vatan!...

Në ballin e sulmit ishin vendosur mbi 3000 luftëtarë Lumjanë e Dibranë në krye të cilëve qëndronin Ramadan Çajku, Sali Spahia, Suf Xhelili, Xhafer Doda, Osman Lita, Bajram Gjana, Cen Daci, Mer Sufa, Dervish e Nezir Bajraktari, Sul Elezi, Alush Aga e të gjithë bajraktarët trima të Topojanit, Radomirës, Qafë-Kalasë, Çajës, Kalisit, Rrafshes Lumës, e të Tejdrinit. Sulmi i luftëtarve malësorë ishte i rreptë, por edhe qëndresa e armikut ishte dëshpruese dhe shumë këmbëngulse. Por ortekun e këtyre trimave që luftonin për mbrojtjen e Vatanit tanimë nuk e ndalte gjë. Trimëritë pasonin, nxitnin e plotësonin njëra tjetrën. Ranë edhe dëshmorët e parë: Haxhi Ibrahim Gjorgji nga Radomira, Nexhip Dull Visha nga Bicet, Rexhep Jonuz Taçi e Selman Asllan Nerguti, të cilët populli i Lumës i përjetësoi në këngë për të mos u harruar në jëtë të jetëve.

Lufta vazhdoi gjithë ditën. Shembuj të pa përshkruar heroizmi treguan luftëtarët Lumjanë e Dibranë. Merreshin veprime personale dhe në grup nga më të pabesueshmet deri në përleshje trup me trup.

Serbët nuk e mbajtën dot as vijën mbrojtëse të parapregatitur. Tentativat e tyre për rigrupim të forcave të shpartalluara pothuajse dështuan. Disa sulme që ndërmuarën forcat më të zgjedhura të reparteve serbe me gjithë ashpërsinë e këmbënguljen e tyre, u thyen keqas nga veprimet e shkathta e të guximshme të malësorve trima. E gjithë përpjekja e komandës serbe për të vënë në veprim bateritë e mortajave, tek të cilat mbanin shumë shpresa dështoi. Dy topat me qitje të ngadaltë që drejtoi oficeri artilier Cen Daci nga Kalisi, goditën me saktësinë më të madhe duke nxjerrë jashta luftimit çdo vendvendosje të tyre.

Në këto kushte, Komanda serbe urdhëroi tërheqjen drejtë Kullës Lumës, por kjo ishte e pamundur tanimë. Një rrebesh shiu e breshëri i paparë ndonjëherë, u derdh mbi Rrafshen e Lumës. Lumi i Shejës që kalon nga Bicet u kthye në Dri e Drini në Det, tregonin pjesmarrësit në këtë betejë. Në përpjekjen për të kaluar Shejën u mbytën më shumë serbë se sa u vranë në përleshje.

Mëngjesi i 16 nëntorit i gjeti forcat sebe të mbërthyera në darën midis Lumit Sheja e Drinit të Zi. Lajmëtarët trima të Ramadan Zaskocit, gjatë gjithë natës, përhapën lajmin e fitores, në ditën e parë të luftimeve në të gjitha grupimet e luftëtarve, lagje më lagjë e shtëpi në shtëpi duke filluar nga Kolesjani e deri në Prizren.

Dita e 16 nëntorit ishte ditë krismash në të gjthë Rrafshen e Lumës. Drejt Kullës së Lumës!.. ishte dhënë komanda....Malsorët, tanimë, ishin paisur me mauzer e xhephane që i'a rrëmbyen hasmit dhe nuk mbaheshin më. Një burim turk theksonte se: "brenda 24 orëve, sërbët qenë thyer keqas dhe ishin kapur mbi 1000 mauzer". Ndërkohë rapsodi popullor këndonte:

*Nëpër flakë lëshohen batare, poshtë te Canet*
*Brenda sahatit i zaptuan istikamet*
*Morën mauzere, morën topa e xhephanet.*

Unaza e rrethimit afrohej drejt Kullës së Lumës dhe armikut po i shtërngohej laku në fyt. Forcat serbe të nisura për ndihmë nga Prizreni, megjithë insistimin e tyre, u bllokuan në Opojë e Gorë. Drejt Kullës së Lumës u vunë në veprim pjesët më të zgjedhura të luftëtarve shqiptar. Sulmues, çeta dhe prita vepronin në çdo vend ku armiku mundohej të krijonte rezistencë.

Një grup luftëtarësh bllokuen edhe mjetet e transportit që po tentonin të tërhiqeshin drejt Prizrenit. Veprimet dëshpruese të komandës serbe për të çarë rrethimin duke hedhur në veprim repartet më të zgjedhura të forcave serbe, u neutralizuan e asgjesuan nga luftëtarët shqipëtar. Kjo gjendje e forcave serbe pasqyrohet edhe në raportin shpjegues, për shkaqet e humbjes, nga komandanti i trupave serbe në këtë betejë "Sulmi që ndërmori nënreparti special në krahun e djathtë të Drinit të Zi, nuk arriti t'i dëboje formacionet shqiptare të cilat me zjarr nga krahët na shkaktonin humbje të rënda. Nënreparti i artilerisë malore nuk arriti të zinte pozicionet e zjarrit.....Armiku na qëllonte nga të gjitha fshatrat, nga çdo shtëpi".

Në fund të ditës, nëpër errësirë një pjesë e forcave serbe që mundi ti shpëtonte vdekjes, la pas Kullën e Lumës dhe një "kullë të stërmadhe kufomash armatimesh e municioni bashkë me malin e madhë të urrejtjes kundër murtajës serbe".

Kështu përfundoi kjo betejë e lavdishme e triumfit të forcave shqiptare mbi ato serbe, të cilën historiani Shaban Braha, e quan "Termopilen shqiptare" ose "Kaçanikun e dytë".

Beteja e Lumës meriton vemendjen e duhur nga historiografia jonë kombëtare, pasi ajo pengoi direkt forcat e Armatës Tretë serbe, duke i gjakosur, rraskapitur e vonuar në realizimin e qëllimit serb për të dalur në Adriatik e për të bërë fakt të kryer pushtimin e Shqipërisë para shpalljes së Pavarsisë sonë Kombtare.

Vargjet lapidare të këngës:

*"Djemt e Lumës, hiç' s'kan dert,*
*ka një luftë e bëjnë përvjet,*
*për vatan s'tremben me vdekë"*

transmetojnë në breza, bëmat e Betejës së Lumës, që bashkoi luftëtarët shqipëtarë me një besim të patundur në mbrojtje të trojeve shqiptare.

Përmes betejash, si kjo e Lumës, anë e mbanë Vilajeteve Shqiptare u bë e mundur shpallja e Pavarsisë Kombtare dhe formimi i shtetit të parë shqiptarë më 28 nëntor 1912.

**Studiues, historian*




# Korabi, i sigurt drejt majave

Korabi ka arritur një fitore të rëndësishme ne Pëshkopi fundjavën e fundit të nëntorit, duke mundur Beslidhjen me rezultatin 2-0 dhe duke e zbritur ekipin lezhjan në vendin e dytë. Tashmë, Korabi është vetëm 2 pikë larg vendit të parë, të cilin e mban Kastrioti me 23 pikë.

Pas fitores me Beslidhjen, ekipit i rriten shanset për te luajtur vitin e ardhshëm ne superiore, gjithmonë nëse ekipi e ruan formën aktuale.

Në një stadium të mbushur plot me tifozë, që mbanin në duar flamuj kuq e zi e kanë mbështetur ekipin për 90 min në shi.

Në pjesën e parë, pavarësisht rasteve, nuk arritën që të zhbllokojnë rezultatin, ndërsa pjesa e dyta ishte dhe më e bukur, pasi rastet nuk munguan nga të dyja ekipet, por vetëm në të 70-tën minutë, është kapiteni Mziu,që merr një top nga mesi i fushës, duke parakaluar krejt mbrojtjen lezhjane, gjuan por portieri e ka larguar për momentin, por Guri që ndoqi aksionin nuk e pati të vështirë që ta dërgonte topin në rrjetë.

Ndërsa goli i dytë do të vinte në të minutën e 89-të me autor Shazivarin, dhe me këtë rezultat mbyllet krejt takimi, i cili e ngjit Korabin në kuotën e21 pikëve.

Javën tjetër Korabi do të udhëtojë drejt Velipojës, ku do të zhvillojë ndeshjen e radhës kundër Velipojës.

**FATMIR ZHUZHI**

# **Rikthehet volejbolli**, vajzat e **Korabit** synojnë **vendin e parë**

Ekipi volejbollit të Korabit për femra po i rikthehet traditës, Ekipi që luan në grupin A 2, po përfaqësohet denjësisht. Ndonëse ka të regjistruar një humbje ndaj Apolonisë së Fierit në transfertë me rezultatin 3-2, ka arritur që të fitojë në Pallatin e Sportit "Bashkim Lala", ndaj Minatorit me rezultatin 3-0. Më pas një tjetër fitore në Tiranë ndaj Studentit po 3-0 si dhe ndaj Vlorës në Peshkopi 3-1, duke mbajtur vendin e dytë në këtë grup.

Ndërkohë, trajneri Fehmi Bulku, shprehet që "kemi një ekip të mirë të udhëhequr nga kapitenia Kovaçi. Vajzat po luajnë mjaft mirë, për të kthyer Korabin atje ku ka qenë, në elitën e volejbollit shqiptar.

Por, na mungon sponsori, pasi kemi nevojë për financim.

Të shtunën e parë të dhjetorit ekipi do të luajë kundër Lushnjes, e cila është në vendin e parë në grup, dhe në një rast të fitores, Korabi do të zërë vendin e parë. Ndeshja zhvillohet në Krutje, kështu që tifozët e volejbollit mund ta mbështesin ekipin.

*F.Zhuzhi*



# Monografia **"Ploshtani"**, një kontribut i veçantë në gjeografinë e shkrimeve për Kalanë e Dodës

*Nga* **JAHE DELIA SELMANI**

Ismen Brika prezantoi më mes të tetorit në mjediset e Muzeut Historik në Tiranë librin e tij të fundit, "Ploshtani - Qoshtet", kushtuar vendlindjes së tij.

Metush Skeja, i cili e moderoi takimin, tha në fjalën hyrëse se ky libër që nuk do të jetë i fundit, po e plotëson më mirë gjeografinë e botimeve të monografive për fshatrat e Kalasë së Dosës.

Më pas, redaktori i librit, dr.Fejzullah Gjabri, vuri në dukje ato të veçanta që e kanë përcjellë historinë e fshatit Ploshtan në shekuj. Ai përmend cilësitë e spikatura të banorëve të Ploshtanit që u përballën me luftëra të përhershme me hasmin dhe dhanë shumë dëshmorë në luftën kundër turqve, serbëve e deri në LANÇ. Vuri në dukje dhe ato figura që e ngritën lart emrin e Kalasë e të Ploshtanit në periudha të ndryshme historike, si: Riza Pashë Ajvazi, bashkëpunëtor i Qemal Ataturkut, bajraktarin Flisi, Met Doda, ushtarakun e lartë Ismail Skeja (i parë) që siguronte Lidhjen e Prizrenit e shumë të tjerë që bënë emër si drejtues feje, botues në Stamboll, avokatë, ministra etj. Duke iu referuar librit, ai përmend ato tradita të shkëlqyera të Ploshtanit në fushën e arsimit ku u hap e para shkollë shqipe për 16 fshatrat e Kalasë së Dodës në vitin 1922. Ploshtani ishte për shumë kohë dhe qendra e Kazasë së Lumës deri kur u zhvendos në Bicaj etj. Duke përfunduar, dr. Gjabri nënvizon: "Libri është një pasqyrë e gjallë e fshatit Ploshtan dhe kontribut në historiografinë shqiptare, që, së bashku me shkrimet për katundet rretheqark, shpalos atë që duhet për të bërë studiuesit e tjerë në të ardhmen."

Bashkëpunëtori i vjetër shkencor, Beqir Shehu, thekson se libri i I.Brikës është kontribut në historishkruarjen që, me korrektësi shkencore, ka ndjekur hap pas hapi jetën e zhvillimin e Ploshtanit në të gjitha periudhat. Ismeni tregohet i saktë në ato që merr përsipër të thotë dhe ia ka arritur më së miri. Është i qartë në mendimet që shpreh dhe përdor një gjuhë të kuptueshme për të gjithë.-Me gjenealogjinë e fiseve,-thekson Beqiri,- Ismeni tregohet njohës i thellë i vendlidjes së tij duke u bazuar në dëshmi të shumta të mbledhura me shumë përkushtim . . .Ai vlerëson dhe atë




korrektësi e durim të autorit pët të pasqyruar ato lëvizje të shumta të popullsisë së Ploshtanit në qindvjeçarin e fundit, sidumos të çerekshekullit të fundit që do të mbetet dokument për brezat. Zoti Shehu, duke e parë librin si një vepër shumë të vlefshme jo vetëm për Ploshtanin, thekson dhe kujdesin që duhet treguar në vlerësimin e historishkruarjes si proces i bazuar mbi realitetin, mbi arkivat e jo mbi besimet, se biem në subjektivitet. Vlerësimi objektiv i realitetit historik është treguesi më i mirë i rëndësisë së një vepre.

Prof.dr.Shefqet Hoxha vlerëson fillimisht autorin, i cili "edhe pse i larguar në dhe të huaj,nuk na ka harruar as ne, as vendin e lindjes, për më tepër është rrekur dhe, jo pa sukses, për t'i blatuar Ploshtanit një tubë përshkrimesh rreth historisë, traditave e kulturës së banorëve të tij të hershm dhe të sotëm." Profesori është i bindur se, ploshtanasit, këta banorë "të vnjeshëm" do ta presin me dashuri këtë dhuratë të autorit e bashkëfshatarit të tyre, se me shumë dashuri e respekt Ismeni ka pasqyruar vendin e tij të lindjes. Libri shkruhet për Ploshtanin, por ai pasuron gjeografinë e botimeve enciklopedike për Lumën, sidomos të visit të Kalasë së Dodës. Kjo kolanë botimesh për këtë Nahije që fillon me Vilën, Kalisin, Radomirën, Cerenin, së shpejti do të vijojë me Grykën e Çajës nga Muharrem Mezini etj. Të dhënat e këtyre monografive, dhe pse kanë karakter përshkrues, janë me shumë vlera e tregojnë se "...vetëm sa kemi shkërputhë në të kaluarën dhe në pasurinë e atij visi të vlerësuar dhe në shkrime të udhëtarëve dhe studiuesve të huaj, si: Hahn, Jastrebov, Nopça etj. Të dhënat e këtyre monografive janë një bazë e mirë për të hartuar "Enciklopedinë e Lumës" si dhe për të shkruar studime me tematikë të caktuar në fushat e historisë, etnologjisë, folklorit, gjeografisë, ekonomisë etj."

Studiuesi,shkrimtari e gazetari Izet Duraku u ndal,veçanërisht, te kompozicioni i librit. Ai vlerësoi pozitivisht ndërtimin e tij nga Ismeni duke e bërë tërheqës e të qartë për lexuesin, shtresëzimet historike e bëjnë të vlefshëm për këdo që mund t'u hyjë temave që trajtohen në këtë libër.

Në takim dha konsideratat më të mira ploshtanasi Shaban Përzhilla, që për meritat e tij për fshatin, Kalanë e Dodës e më gjërë, është i vlerësuar kudo ka punuar. Intelektuali e historiani Sali Onuzi përshëndeti takimin dhe, duke vlerësuar punën plot pasion që ka treguar autori në këtë libër, nuk lë pa përmendur që Ploshtani e Kalaja e Dodës qe për shumë kohë qendër e Lumës, për vetë ato vlera të shumanshme që kishte ky fshat shpreh mendimin se "ishte një qytezë me vlera për atë kohë."

Një nip Ploshtani e ish koleg me autorin ngjitet në podium dhe prezantohet si Bajram Cara, thotë fjalë zemre për librin dhe Ismenin si njeri me vlera njerëzore e intelektuale. –E ndjej veten krenar që jam nip i asaj ane, që ka shkëlqyer gjithmonë,- përfundon.

Fjalën e merr dhe kryetari i Shoqatës "Luma", prof.dr. Dritan Spahiu. Ai vlerëson lart autorin për monografinë që i dha jo vetëm fshatit të tij, por dhe Kalasë e Lumës.-Puna e bërë nga Ismen Brika dhe të tjerë autorë nga gjithë Luma, po ia ngrenë lart ato vlera që ka pasë kjo krahinë. Kjo punë nuk duhet të reshtë, se çdo fshat ka historinë e vet, ajo u duhet transmetuar brezave,- thekson profesori.

Përshëndet me fjalë të thjeshta e plot mall për fshatin e lindjes dhe Idriz Gjorllaku, pasardhës i një familje shumë të nderuar e plot tradita. Disa herë në libër përmend përkthyesin e iranologun më të shquar që njohim, Vexhi Buharanë, që autori e ka takuar në rininë e vet në Berat e ka pasë nderin t'ia lexojë ndonjë vepër. Ai ka vite që nuk rron, por nipat e të ndjerit nuk kanë përtuar të jenë mysafirë të nderuar të takimit. Vëllezërit Shkëlqim e Isak Hoxha kanë ardhur nga Berati, ata janë njëkohësisht dhe djemtë e biznesmenit më të madh në kohën e Italisë në Berat, Demir Hoxha. Në koktejlin e shtruar plot të mira e bujari nga kushëriri i Ismenit, biznesmeni i ndershëm Agron Brika, jo vetëm shkëmbejmë fjalë respekti me vëllezërit beratas,nipat e Buharasë, por dhe me të tjerë. Në libër, mes të tjerash, flitet dhe për ato shpërngulje të shumta pas vitit 1912 jo vetëm nga fisi Brika, por dhe nga gjithë Ploshtani. Përmendet mes të shpërngulurve edhe Imer Hajdar Brika, që u vendos në Prizren në kohën e Nemces (Austrisë). Ai ndërton jetën atje duke u marrë me tregti, sot pasardhësit e tij kanë dyqane e hotele. Dhe pse ka kaluar një shekull, lidhjet janë ruajtur se-"nuk bëhet gjaku ujë,-thotë populli. Dhe mes të pranishmëve shohim dy motrat Brika që kanë ardhur apostafat për këtë ngjarje nga Prizreni. Kamera e kushëririt të Ismenit,Shpëtim Brika, që ka ardhur nga Kalaja për këtë rast, fokusohet pak më gjatë të motrat Sehare e Sabihate. Atyre u shkëlqejnë sytë e u gëzon zemra që ndodhen mes vëllezërve të një gjaku. Ndjehen si në shtëpinë e vet, se,në fakt, aty janë, një shekull ndarje nuk i ka ndarë zemrat.

Rruzhdi Brika, në emër të autorit, dhuron librin duke falënderuar secilin. Kjo dhuratë e rrit dhe më shumë respektin për Ismenin, jo për vlerën monetare, për të cilën ai falënderon fëmijët e tij, por për atë dashuri që ruan për fshatin ku lindi e u rrit. Kjo dashuri për Ploshtanin iu kthye në një "detyrim" shpirtëror për ta përjetësuar atë.

Duhet vlerësuar dhe kujdesi i treguar nga redaktori, z.Fejzullah Gjabri si dhe botimet M&B për përgatitjen cilësore të librit. Ky botim është një pasuri e paçmuar për brezat e ardhshëm.

nderim

# Ndërron jetë Tisi i Camit

***Tisi i Camit (Shpëtim Cami), intelektual, veprimtarë dhe ish Kryetar i shoqatës qytetare "Votra Dibrane" prej themelimit të saj.***

*Nga* **BEQIR SINA**



Në moshën 73 vjeçare, ka ndërruar jetë, në Dibër të Madhe, Shpëtim Cami, i thirrur nga dibranët si Tisi i Camit, intelektual, veprimtar, dhe ish Kryetarë i shoqatës qytetare "Votra Dibrane" prej themelimit të saj.

Tisi - lindi në Shqipëri ,fshatin Miresh, në vitin 1942, data 15 korrik, si djali i Rifat dhe Kadrie Camit. Babai i tij ishte kryetar i Galicnikut, deri në vitin 1943.

Ai, fatkeqësisht, në vitin 1948, bashkë me motrën Libade, mbet në Maqedoni tek xhaxhai, kohën kur u mbyllën kufijtë ndërshtetrorë, dhe prindërit e tij, bashkë me dy motrat dhe vëllain e madh - qëndruan në Shqipëri.

Nënën e pa në vitin 1991, kurse babain, kur mbaroi gjimnazin në Tetovë.

Fakultetin e drejtësisë e kreu në Shkup. Në vitin 1968, u emërua drejtor i ndërmarrjes komunale STANDARD. Kurse, në vitin 1976 ishte themelues i fabrikës për prodhime plastike 'DEPLAST' në Dibër, një fabrikë, kjo, e cila nën drejtimin e tij u ngritë si e dyta në ish-Jugosllavinë.

Për arsye politike, u burgos në vitin 1985, u lirua si i pafajshëm pas gjashtë muaj hetuesi. Doli në pension në vitin 1992.

Ka qenë një ndër themeluesit dhe kryetar i Shoqatës Votra Dibrane, ku u angazhua si iniciator për botimin e librit Kongresi i Manastirit.

Ne vitin 1996, Tisi i Camit - Shpëtim Cami, ka qenë kandidat për deputet në kuadër të PDSH-së Maqedoni.

Ishte babai i tre fëmijeve, Blerimi, Bleta, Gerta e cila merret me kërkime shkencore në Angli.

Si aktivist dhe veprimtar i dalluar në Dibër, ai ka qenë i angazhuar, edhe në shumë shoqata dhe organizata jo politike dhe jo përfituese në Dibër të Madhe, Peshkopi, Tiranë, Shkup, Tetovë, Strug dhe Gostivar.

Si ish-Kryetar i Shoqatës Qytetare "Votra Dibrane", në Dibër e Madhe, Shpëtim Cami, duke i uruar punë të mbarë Kuvendit Tekniko-Shkencor për "Rrugën e Arbërit", vite më parë, është shprehur se :"Aktivitetet dhe angazhimet e shumë subjekteve deri më tani, na bëjnë të besojmë fuqishëm, se ka ardhur koha dhe, se janë plotësuar kushtet për ndërtimin edhe të kësaj rruge me rëndësi jetike për banorët dhe zhvillimin e gjithëmbarshëm edhe të këtij rajoni të vendit dhe me gjerë. Çdo vonesë e ndërtimit të kësaj rruge, qe shprehur Shpëtim Cami, shton agoninë e të ardhmes sonë".

Zenel Anxhaku në shkrimin e tij: "Camët e Viçishtit të shtatë Maleve të Dibrës", shkruan se: "Shumëkush, që ka takuar në rrjedhat e jetës Camët e Viçishtit të Shtatë Maleve të Dibrës, ka vënë re karakterin e tyre të heshtur, dëshirën për të qenë të padukshëm në zhurmën e përgjithshme, karakterin e bletës të një pune të pabujë, por edhe këmbënguljen e një shkëmbi të ngulur thellë në truallin e vet. Në një radhë librash mund të lexosh për historinë e fisit të Camëve dhe vë re se këto bij dhe bija të Dibrës, kanë ditur mirë dhe bukur të thonë fjalën e tyre në radhë të parë për shkollën shqipe dhe pastaj natyrshëm edhe në radhën e Lirisë" shkruan Anxhaku - për familjen Cami, pinjoll i të cilës është edhe i ndjeri Shpëtim Cami - Tisi i Camit.

Me rastin e vdekjes së intelektualit të shquar dibran, zoti Musa Paçuku - Kryetari i Shoqatës Atdhetare Dibra në Nju Jork, ka ngushëlluar familjen Cami.

"Me pikëllim morëm lajmin për vdekjen e intelektualit të shquar dibran,Tisi i Camit. Vdekja e Tij, është humbje për familjen tuaj, për Dibrën, së cilës i dha një kontribut të shquar, si intelektual, drejtor, veprimtarë dhe kryetar i shoqatës qytetare "Votra Dibrane".

Në emër të Shoqatës Atdhetare Dibra në Nju Jork, dhe në emrin tim, Ju shpreh ngushëllimet më të thella", thuhet në mesazhin e ngushëllimit të të kryetarit të shoqatës atdhetare Dibra zotit Musa Paçuku.

Veprimtari i komunitetit dibran Ylber Pilku, në mesazhin e tij ngushëllues, shkruan në statusin e tij në Facebook: "E nderuara familje e Tisit, farefis, miq, bashkëudhtar të veprimtarisë së përkushtuar dhe të ndritshme të Tij, si një intelektual i shquar dibranë, me lejoni që n'emër timin, familjës Pilku, t'u shprehi ngushëllimet më të sinqerta për vdekjen e anëtarit më të dashur të familjes tuaj. "Ishte kënaqësi të jetoje në Dibër, kur atë e drejtonin burra si këta - për të qenë krenar - sot se kësi burash, nuk do harrohen kurrë nga ne dhe ju pasardhësit e tyre krenar ".

Një e mbesa e tij, e cila na ndihmojë edhe me fotografitë dhe kronologjinë - Doruntina Klenja, na shkuan me ketë rast se: "Në shtëpinë e gjyshit dhe gjyshes, ku u rrita , kujdesi i gjyshit ishte i veçantë, sidomos për mua si mbesa e parë. Ai më mësonte mbi gjithçka t'a dua kombin.

Historia e tij dhe motrës së tij Libade, është histori prekese që e dëgjon nën tingujt e këngës së fisit të Cameve të Viçishtës. Gjyshi im Shpetimi,- thotë Doruntina, - më tregonte, si ai kishte kaluar fëmijërinë e tij nën mëshirë të kryefamiljarëve larg gjirit të prindërve.

Dikur, kjo më dukej si një përrallë e fëmijëve që besojnë në gjithçka, por duke u rritur u binda në një realitet të hidhur. Ato të dy pas moshës 5 vjeçare nuk e kishin parë kurrë të Atin, atë që politika e asaj kohe vinte në depresion intelektualitetin dhe forcat shtytëse ndanin dashurinë".



*Hilmi Cani, Drita Agolli, Selim Pira, Zeqi Agolli e Hajri Hoxha*

# Zeqi Agollit i jepet titulli "Anëtar nderi i Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it Dibër"

*Nga* **ZABIT LLESHI**

Komiteti i Veteranëve të LANÇ-it Dibër i jep zotit Zeqi Agolli titullin "Anëtar nderi i organizatës së veteranëve të rrethit Dibër" me këtë motivacion : "Për kontributin e dhënë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare për çlirimin e Atdheut, rindërtimin e ndërtimin e Shqipërisë së re demokratike popullore, besnikëri të palëkundur ndaj idealeve dhe vlerave të LANÇ-it. Vepra juaj do të mbetet e nderuar në breza."

Në pamundësi për t'a marrë këtë titull nderi në Dibër, ceremonia u organizua më 14 tetor 2015 në shtëpinë e tij në Tiranë. Në këtë takim të ngrohtë morën pjesë veteranët e LANÇ-it Hajri Hoxha e Selim Pira, kryetari i Komitetit të Veteranëve të LANÇ-it Dibër Hilmi Cani dhe pasardhësit e veteranëve Bashkim Lleshi e Bajram Çekiçi. Mysafirët e ardhur në këtë familje i pritën Zeqi Agolli, bashkëshortja e tij Drita Agolli (Strazimiri) dhe dy vajzat.

Bashkëshortët Agolli falënderuan mysafirët e mirëseardhur nga Organizata e Veteranëve të LANÇ-it Dibër. Kryetari i Komitetit të Veteranëve të LANÇ-it Dibër i dorëzoi zotit Zeqi Agolli titullin e nderit. Në këtë takim mbresëlënës e mjedis shumë të ngrohtë familjar veteranët Zeqi Agolli, Hajri Hoxha e Selim Pira sollën kujtimet nga lufta për çlirimin e vendit nga okupatorët nazifashistë. Pritja u bë mbresëlënëse e më e gëzueshme për faktin se Drita Strazimiri (Agolli) me vajzat ishin iniciatorë të këngëve partizane e patriotike që u kënduan bashkërisht.

Zeqi Agolli lindi në Tiranë më 1923, me origjinë nga Dibra e Madhe. I ati Rexhep Agolli një financier i aftë e burrë i respektuar mbështeti lëvizjen për pavarësinë e Shqipërisë së bashku me vëllanë Vehbi Agolli (Dibra), Kryetar i Senatit të Qeverisë së Vlorës të Ismail Qemalit.

Arsimin fillor e të mesëm e kreu në Tiranë, studimet e larta në degën Histori Gjeografi, njohës i gjuhëve të hueja italisht, frëngjisht, rumanisht, rusisht e anglisht. Mori pjesë aktive në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare që në fillim deri në çlirimin e vendit. Shtëpia e tij ka qenë një nga bazat më të fuqishme të njësiteve guerile të Tiranës. Është ndër themeluesit e Rinisë antifashiste dhe anëtar i forumeve udhëheqëse të saj.

Zeqi Agolli ishte shok ideali, luftëtar e mik i Qemal Stafës, Nako Spiros, Ramiz Alisë, Gogo Nushit, Alqi Kondit, Vojo Kushit, Nexhmie Xhuglinit, Naxhie Dumës, Sefulla Malëshovës, Misto Mames, Skënder Kosturit, Jovan Andonit, etj.

Pas çlirimit menjëherë filloi punë si shef kabineti i Kryeministrit Enver Hoxha, pas dy vjetësh punoi në Ministrinë e Punëve të Jashtme në funksione të ndryshme, si zyrtar i lartë drejtues dhe diplomat karriere në krye të ambasadave shqiptare në Rumani, ish Bashkimin Sovjetik, Kinë, Egjypt, anëtar i shumë delegacioneve qeveritare në Kombet e Bashkuara në Nju Jork e Gjenevë, në Algjeri, Iran, Vietnam, Laos, Kamboxhia, etj.

Bashkëshortja e tij Drita Agolli është vajza e patriotit dhe dëshmorit partizan Ismail Strazimiri. Ajo është e para grua regjisore shqiptare, aktore, shkrimtare e dekoruar me titullin e lartë "Mjeshtre e Madhe".

Pas 44 vjetësh karriere të gjatë diplomatike Zeqi Agolli doli në pension në moshën 65 vjeçare në vitin 1988. Ai i ka dhënë dhe jep një ndihmë të madhe Organizatës së Veteranëve që nga qendra në Tiranë dhe në rrethe, sidomos organizatës ë së veteranëve të Dibrës. Eksperienca dhe përvoja e veteranëve si Zeqi Agolli me shokë janë një thesar i pasur që duhet ruajtur e transmetuar brez pas brezi duke marrë prej tyre vetëm dashuri e mirënjohje.

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >




# *Rruga e Arbërit*
## *aty ku fjalët nuk i merr era...*

**Pajtohu në gazetën *RRUGA E ARBËRIT***

***Merr versionin* PDF ose kopjen print**
**duke kontribuar vetëm me 50 lekë/muaj**

**Gazeta ofron faqet e saj për REKLAMA apo NJOFTIME të ndryshme për biznese dhe individë.**

Kontribuo për vendlindjen duke u pajtuar ose dhuruar donacione në gazetën RRUGA E ARBËRIT

*Për informacion shkruaj:* rrugaearberit@gmail.com

Websiti i gazetës **www.rrugaearberit.com** është kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit" dhe lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër nga z. Agim Deva.

*Bëj pajtimin tënd me*
PayPal
*përmes emailit*
**<rrugaearberit@gmail.com>**

Një kontribut vjetor kushton:
**Në Shqipëri: 600 lekë.**
**Në Europë: 10 Euro.**
**Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD**.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

## Kërkohen korrespondentë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

Gazeta "Rruga e Arbërit" kërkon korrespondentë zyrtarë për **PESHKOPINË** dhe **DIBRËN E MADHE**.
Të interesuarit duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email në adresën
**<rrugaearberit@gmail.com>** ose të telefonojnë në numrin **069 20 68 603.**

*Redaksia*